



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

**T R A N S K R I P T**

**I MBLEDHJES SË JASHTËZAKONSHME TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS  
SË KOSOVËS, E MBAJTUR MË 27 QERSHOR 2019, në orën 11:00**

**SA VANREDNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,  
ODRŽANE 27. JUNA 2019. GODINE, u 11:00 sati**

**QERSHOR - JUN  
2019**

## **Rendi i ditës**

1. Gjendja në arsim dhe vendimet e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në Republikën e Kosovës

## **Dnevni red**

1. Stanje u orazovanje i odluke Ministarstva za obrazovanje, nauku i tehnologiju u Republici Kosovo

## **Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.**

KRYETARI: Të nderuar deputetë,  
I nderuar ministër i Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe ministër i Arsimit,

Në sallë janë të pranishëm 85 deputetë. Para se t'i vendosim pikat e rendit të ditës, ka ardhur edhe një propozim. Unë e vendos formalisht në votim. Dëshironi mocion procedural. Kryetarja e komisionit, zonja Duda Balje, e ka sjellë një projektligj për fëmijët.

Projektligji nr. 06/L-084 për mbrojtjen e fëmijës. A dëshironi ta vëni në votim? Ju lutem, mocion procedural. Kush është që ta fusim si pikë të rendit të ditës? Projektligji nr. 06/L-084 për mbrojtjen e fëmijës, mocioni procedural. Votojmë tash!

Ju lutem me dorë. Kush është për? Shumica janë për.

Zonja Duda Balje, ju lutem, raporto si komision dhe pastaj e vëmë në votim.

DUDA BALJE: Faleminderit!

KRYETARI: Zonja kryetare, na e trego edhe propozimin, ju lutem! Deputetë, ju lutem për vëmendje!

DUDA BALJE: Faleminderit shumë për përkrahje. Ligji për mbrojtjen e fëmijës është një prej ligjeve më të rëndësishëm te ne. Jemi duke e pritur këtë ligj që shumë kohë, gati katër vjet.

Ne kemi biseduar edhe me pozitën dhe opozitën. Kemi dritën e gjelbër dhe ju lutem ta votoni sot, sepse është një prej ligjeve shumë të rëndësishme për neve. Ne e kemi përfunduar. Sot është leximi i dytë. Faleminderit!

### **- Miratimi i Ligjin nr. 06/L-084 për mbrojtjen e fëmijës**

KRYETARI: Atëherë, shkojmë dhe i votojmë amendamentet. Sa deputetë janë në sallë? Sa amendamente janë?

76 deputetë janë në sallë. Në pako do t'i vendos. Janë gjithsej 25 amendamente. I votojmë të gjitha në pako. Ka kuorum. Janë 35 amendamente.

A është dikush kundër? Me përkrahje të Komisionit FunkSIONAL. A ka abstenim? Të gjithë janë për.

Shkojmë në votimin e tekstit të projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara.

Me elektronikë, votojmë tash! Kush nuk ka kartelë, nënkryetari është këtu do të votojë me dorë.  
Votojmë tash!

72 deputetë, 72 për dhe 1 me dorë, 73 Hajdar Beqa për. Pastaj edhe 3 të tjerë me dorë. Janë 76 vota për.

Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 06/L-084 për mbrojtjen e fëmijës.

Vazhdojmë me pikën e vetme të rendit të ditës:

### **1. Gjendja në arsim dhe vendimet e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në Republikën e Kosovës**

Të nderuar deputetë,

43 deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës kanë parashtruar kërkesë për seancë të jashtëzakonshme për të diskutuar për gjendjen në arsim dhe vendimit të ministrit të Arsimit.

Ftoj deputetin Ismajl Kurteshi që në emër të iniciuesit të kësaj seanca ta paraqesë dhe ta arsyetojë çështjen, për të cilën është kërkuar mbajtja e seancës së jashtëzakonshme.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Pas më shumë se katër muajve përpjekjeje që në rend dite ta fusim debatin për arsimin, fushën që ky Kuvend e ka shpallur prioritet nacional, më në fund u detyruam që këtë ta bëjmë nëpërmjet një seance të jashtëzakonshme. Madje, edhe si pikë të 3-të sot.

Arsimi në Kosovë është në gjendje të rëndë sa për shkak të mungesës së mjeteve të mjaftueshme financiare, po aq edhe për shkak të mungesës së organizimit të mirë dhe sidomos për shkak të ndërhyrjeve politike.

Si është gjendja në Kosovë, po thirremi edhe në një studim të UNICEF-it që e ka bërë vitin e kaluar, ku përveç tjerash thuhet se, vetëm rreth 5% e fëmijëve janë të përfshirë në çerdhet publike. Ndërkaq, 95% e fëmijëve janë të përfshirë në arsimin e obligueshëm. 84% janë të përfshirë në arsimin e mesëm.

Ndërkaq, në Kosovë 5,4% e qytetarëve janë analfabetë, derisa në vitin 2008 analfabetë funksionalë kanë qenë 62%, ndërsa në vitin 2015 rreth 78%, që do të thotë se numri i atyre që janë analfabetë funksionalë po rritet.

Bazuar në një raport tjetër, ka mospërputhje të korrikulës së arsimit të lartë me arsimin dhe aftësimin profesional, si dhe me nevojat e tregut të punës.

Mungesa e laboratorëve dhe mjeteve të tjera të punës është sëmundje kronike e shumë shkollave tona. Aktivitetet e lira, mbledhjet me prindër, mbledhjet me kujdestarë të klasës rrallëherë organizohen në shkollat tona. Ndërsa, tekstet shkollore ose nuk janë të përshtatshme ose mungojnë, e sidomos mungojnë në arsimin profesional.

Kur jemi te tekstet, duhet thënë se dy muaj para fillimit të vitit të ri shkollor, ende nuk dihet se me cilat tekste do të fillojë viti i ri shkollor. Me të vjetrat që nuk janë në harmoni me korrikulën e re, apo me të reja, për të cilat ka shumë vërejtje.

Madje, edhe Ministria e Arsimit nuk e përjashton mundësinë që ato të ndryshojnë pas një viti, edhe pse është e vetëdijshme që pilotimi i tillë është antikushtetues.

Ndërsa për procesin e përzgjedhjes së teksteve të reja ka shumë vërejtje nga të gjitha anët, nuk janë të pakta as kërkesat për anulimin e këtij procesi, e ka thirrje edhe për dorëheqjen e ministrit.

Sa i përket mësimin parashkollor duhet thënë se Kosova zë vendin e fundit në Evropë me përfshirjen e fëmijëve në edukimin parashkollor dhe kur kësaj ia shtojmë mungesën e kurrikulës për këtë nivel të shkollimit dhe mungesën e kontrollit të shtetit në çerdhe private që veprojnë herë me licenca, herë pa to, atëherë shihet se në çfarë gjendje është edukimi parashkollor.

Edhe gjendja e hapjes së shkollave në diasporë është për t'u dëshiruar, pasi që shteti nuk e kryen obligimin ndaj qindra-mijëra nxënësve shqiptarë në diasporë.

Sa i përket idesë së riorganizimit të shkollave duhet thënë se në Kosovë kemi shkolla që punojnë me tri ndërrime, me nga 40 nxënës në klasë dhe kemi shkolla që punojnë me një ndërrim dhe kanë numër jashtëzakonisht të vogël të nxënësve nëpër klasë.

Ministria në këtë situatë duhet t'i prijë procesit të riorganizimit të shkollave, duke i pasur parasysh në rend të parë interesat e nxënësve, duke mos lënë anash angazhimin e të gjithë mësimdhënësve dhe shfrytëzimin racional të objekteve për nevoja të nxënësve dhe të mos presë nga komunat që t'i hyjnë kësaj pune, për të cilat nuk kanë kapacitete.

Fëmijët me nevoja të veçantë në Kosovë, nuk dihet numri i tyre, as nuk dihet se a janë të gjithë të përfshirë nëpër shkolla të rregullta dhe ato burimore, por dihet se një numër jo shumë i madh i tyre janë të përfshirë në shkolla, ndërsa të tjerët mbesin jashtë sistemit arsimor.

Mungon infrastruktura për qasjen e objekteve shkollore, mungon stafi i trajnuar profesional dhe asistent, mungon transporti dhe mungojnë mjetet e punës, e kështu me radhë.

Sa u përket shkollave profesionale, rreth 50% e nxënësve në shkollat e mesme të Kosovës mësimin e ndjekin në shkolla profesionale.

Kosova është vendi i vetëm në Evropë ku në shkollat profesionale mbisundon mësimi teorik, por edhe për këtë mungon literatura e nevojshme.

Mësimi praktik nuk është i organizuar mirë, shumica e nxënësve mbeten të paaftësuar në nivelin e duhur për profesionin që e zgjedhin.

Sa i përket arsimit të lartë, Kosova zë vendin e parë në Evropë për nga numri i studentëve. Derisa në Evropë katër mijë studentë janë në 100 mijë banorë, në Kosovë ky numër arrin në shtatë mijë.

Sipas një projekti të financuar nga Bashkimi Evropian, ndër të tjera konstatohet se asnjëri nga universitetet rajonale publike në momentin e akreditimit nuk i kanë plotësuar standardet e parapara për akreditim.

Kurse Grupi i Punës i MASHT-it për studim të fizibilitetit të universiteteve rajonale, përveç tjerash ka konstatuar se mungon harmonizimi i programeve me tregun e punës, programet identike përsëriten në shumë universitete, ekzistojnë probleme në infrastrukturë, ekzistojnë dobësi në sferën e organizimeve të brendshme, mungojnë kërkimet shkencore, mungon mekanizmi për sigurimin e cilësisë dhe mungojnë të dhënat për performansën e pedagogëve dhe stafit të universiteteve.

Kurse në kolegjet private gjendja është edhe më e rëndë. Aty shpesh pranojnë studentë në programe të paakredituara, pranojnë studentë më shumë se sa u lejohet me ligj, nuk i respektojnë afatet e regjistrimit, shpesh ndodh të mos regjistrojnë studentët në librat e amzës.

Angazhojnë profesorë të fushave, në të cilat nuk kanë kompetenca ose që janë të angazhuar në më shumë institucione të arsimit të lartë.

Sa i përket Këshillit Shtetëror të Cilësisë, edhe ky gjatë punës së tij përballet me presione nga jashtë, por merret shumë edhe me organizime e riorganizime të brendshme që, natyrisht ndikon në cilësinë e punës së tyre.

Sa i përket decentralizimit në fushën e arsimit, decentralizimi i cili ka filluar në bartjen e kompetencave në komunë asnjëherë nuk ka arritur në shkolla dhe kjo bën që ministria të shndërrohet në ‘seherxhi’, kurse shkollat të mos i kenë kompetencat e duhura.

Siguria në shkolla është po ashtu një problem jashtëzakonisht i madh dhe përdorimi i lëndëve narkotike, me të cilët nuk merret askush, po bëhet për çdo ditë problem shumë i madh në shkollat tona.

Po ashtu duhet të flasim edhe për respektimin e ligjeve që po shkelen përherë. Shkelja e ligjeve është bërë dukuri, kur bëhet fjalë për shkelje të ligjeve nuk mund të mos e përmend këtu skandalin që ndodhi në shkurt të këtij viti, kur zyrtares Gagica iu ndërrua vendi i punës për shkak se ajo raportoi për shkelje ligjore në disa kolegje private, të cilat nuk i kanë regjistruar studentët në librat e amzës.

Zonja Gagica deklaroi se për rastin kanë qenë të informuar ish-drejtori i Arsimit, ish-sekretari i përgjithshëm, Kabineti i ministrit dhe Departamenti i Inspektoratit, i cili nuk ka ndërmarrë asnjë masë të përcaktuar me ligj.

Përkundrazi, sipas zonjës Gagica, ka pasur raste ku inspektorët pa lejen e NARIC-ut kanë bërë inspektime individuale dhe janë angazhuar që diplomat e studentëve të vulosen, edhe pse nuk kanë qenë të evidentuara në librat e amzës.

Me qëllim të heshtjes së skandalit, MASHT-i e ka kthyer zonjën Gagica në vendin e saj të punës, në lidhje me rastin unë i kam shkruar sekretarit të MASHT-it dhe nga ai kam kërkuar një kopje të raportit të zonjës Gagica.

Sekretari i MASHT-it, zoti Kastrati, përmes përgjigjes me shkrim refuzoi ta përcjellë raportin, me këtë rast ai e ka shkelur rëndë Ligjin për transparencë. Për refuzimin e sekretarit në lidhje me raportin është njoftuar edhe ministri Bytyqi, i cili nuk ka ndërmarrë asgjë në këtë drejtim.

Nëse shkeljet e lartpërmendura ligjore dhe shumë të tjera që nuk janë përmendur në kolegje cilësohen si krim i organizuar, atëherë fshehja e shkeljeve nga zyrtarët e lartë të MASHT-it nuk ka si të cilësohet ndryshe. Për këto shkelje përgjegjësit të cilët janë të identifikuar duhet të japin llogari. Kjo duhet të fillojë me dorëheqjen e ministrit të Arsimit dhe Prokuroria duhet të merret me raste të tilla, të cilat arsimin po e shndërrojnë në një biznes të pistë. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Tani është radha e kryetarëve ose përfaqësuesve të grupeve parlamentare. Grupi Parlamentar i LDK-së, kush e do fjalën, deputetja Valentina Bunjaku-Rexhepi, në emër të grupit.

**VALENTINA BUNJAKU-REXHEPI:** I nderuar nënkryetar,  
I nderuar ministër,  
Të nderuar ju kolegë deputetë dhe ju deputete,  
Shumë të respektuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Sot po flasim për një temë shumë të rëndësishme, një temë që kjo shoqëri ka nevojë të debatojë dhe të funksionalizojë shumë më shumë arsimin, pa arsim cilësor s'ka as zhvillim ekonomik, as mirëqenie sociale.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjikë ka dështuar në shumë çështje, të cilat do të mundohem t'i numëroj në këta minuta që i kam në emër të Grupit të Lidhjes Demokratike të Kosovës.

Arsimi po vazhdon me cilësi jashtëzakonisht të dobët, në të gjitha nivelet, për këtë pajtohem i gjithë, besoj.

Arsimi po vazhdon me sasi sa që s'mbeti askush pa fakultet. Është mirë në njërin anë që të gjithë po dalin me diploma, po bëhet në pyetje se me çfarë diploma dhe çfarë kuadro po nxjerrin këto universitete në Republikën tonë.

Arsimi nuk përputhet aspak me tregun e punës. Shpesh mungojnë kuadrat profesionale në fusha të ndryshme të specializuara, ndërsa kemi kuadro tepricë, s'ka logjikë kur s'përputhet arsimi me tregun e punës.

Nuk ka zë brenda dhe jashtë vendit, përfshirë këtu edhe Komisionin Evropian që nuk thotë se arsimi është uzurpuar nga partia në pushtet.

Madje le të kujtojmë skandalin e pafajshëm kur partitë në pushtet ndërhyjnë në politikat dhe shkarkuan Këshillin Shtetëror të Cilësisë dhe kjo ndikoi që të përjashtohemi nga EQA.

Vetëm në raportin e fundit të Komisionit Evropian nuk ka akuzë më të madhe se sa të thuhet se arsimi, veçanërisht arsimi i lartë mbetet një sektor me rrezik të lartë për korrupsion dhe ndikim politik.

Ministria ka dështuar edhe në premtimet e saj, të cilat premtime kanë qenë që kjo ministri do të zhvillojë politika të reja.

Kjo ministri ka dështuar edhe në organizimin e organogramit profesional, racional, duke larguar profesionistë nga pozitat të cilat i kanë pasur dhe duke sjellë militantë partiakë.

Profilizimi i mësuesve në mësimin fillor edhe këtu ka dështuar.

Arsimi profesional nuk është aspak në nivelin e duhur.



Tentimi për mbylljen e universiteteve publike ka qenë herë pas here, edhe deklarimi i vetë ministrit se do të mbylljen universitet publike për cilësinë e dobët në arsim.

Është korruptuar vlerësimi i dukurive të studentëve, është korruptuar arsimit dhe kushtëzuar për blerjen e librave të profesorëve të caktuar nga studentët.

Korrupsion është edhe kur Ministria e Arsimit mbushen me militantë partiakë në pushtet.

Në arsim ende në shekullin XXI kemi probleme me infrastrukturë të çerdheve. Sa janë nevojat për to, ekziston edhe numër i vogël i tyre. Ndërsa pushteti ka premtuar rritjen e numrit të tyre.

Në nivel parauniversitar ende nuk zbatohet mësimi tërëditor, edhe ky ka qenë një premtim i ministrit.

Në arsimin fillor e të mesëm ende ka teste skandaloze dhe kur dalin testet e reja, përsëriten gabime. Për takimin e recensentëve të teksteve shkollore shpenzohen mijëra euro, duke u takuar kod në hotele luksoze, në Shqipëri dhe, në këtë mënyrë kanë mundësi të shfrytëzohen hapësirat e ministrisë, po pse edhe hapësirat apo sallat e universiteteve.

Ende kemi tekste shkollore jocilësore, ende vlen raporti i BIRN-it në vitin 2013, ku shkruhet se tekstet shkollore kanë ngarkesa dhe fakte të pasakta, apo edhe të shtrembëruara, të dhëna dhe fakte kundërthënëse, të dhëna dhe fakte të prezantuara keq, të dhëna të paqarta e të palogjikshme, ngarkesa me fakte e informacione jo të sakta, ngarkesa me fjalë e shprehje me numër të madh të faqesh, ngarkesa fletore pune, mospërputhje e teksteve me moshën e zhvillimin e fëmijëve.

Ende në Kosovë disa shkolla punojnë në përfundimin e vitit, ndërsa disa vazhdojnë të punojnë deri të premtën, deri në fundjavë. Këtu automatikisht ka dështuar autoriteti i ministrisë, sepse kjo parregullsi, domethënë disa nxënës të vijnë në mësimin dhe disa ta ndërprejnë mësimin dhe të shkojnë nëpër pushime, është totalisht dështim i Ministrisë së Arsimit.

Ende ka institucion si ministria që njerëzit pa punuar fare paguhen me paranë publike.

Ministria ka shpenzuar rreth 150 mijë euro për 32 punonjës të saj që nuk shkojnë në punë.

Ministria ka dështuar të përfitojë projekte nga institucione të rëndësishme ndërkombëtare.

Është dështuar edhe në zbatimin e kurrikulës së re, është dështuar në numrin minimal të angazhimit të psikologëve dhe pedagogëve nëpër shkolla. Janë bërë ndërhyrje politike në përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit drejtues të universiteteve e profesorëve të rregullt e të rektorëve, si për shembull, në rastin e Prizrenit.

Ministria ka përgjegjësi për skandalin dhe shpenzimet marramendëse nga koordinatori i ashtuquajtur, koordinatori i PDK-së për rini, i cili ka organizuar garë të diturisë në nivel kombëtar. Ndërsa kjo duhej të organizohej në kuadër të Ministrisë së Arsimit.

Janë shoqëruar parregullsi të mëdha me pagesa që dëmtojnë buxhetin e rregullt të Kosovës edhe për anëtarët e Komisionit për zgjedhjen e kontesteve dhe ankesave të ministrisë, të cilët kinse kanë punuar në orë shtesë e takimet janë mbajtur gjatë orarit të rregullt të punës. Këtë e ka thënë edhe raporti i fundit i Zyrës Kombëtare të Auditimit.

Ende një test të maturës nuk keni qenë në gjendje të organizoni siç duhet, ku kopjet e teksteve janë shpërndarë në të gjitha rrjetet sociale dhe në këtë rast më së shumti janë dëmtuar nxënësit shembullorë.

Edhe sot ministria ka dështuar të pajis shkollat me kabinete dhe mundësi për punë praktike. Mungojnë edhe laboratorë e kushte teknike.

Ende ministria ka dështuar në rritjen e numrit të inspektorëve nëpër komuna, të cilët janë të domosdoshëm.

T'i numërosh të gjitha këto probleme të arsimit është e pamundur gjatë kësaj kohe.

Por, ne si LDK do të japim kontribut dhe do të ofrojmë një zgjidhje konkrete përmes një rezolute, ku besoj se të gjitha grupet do të dakordohemi që të votohet një rezolutë këtu, nga të gjithë deputetët dhe kjo rezolutë të gjejë zbatim dhe jo vetëm të mbetet letër sikur rezolutat e tjera. Dhe, në fund, në emër të Grupit të Lidhjes Demokratike të Kosovës propozoj një komision hetimor të dalë nga ky Kuvend, i cili komision duhet të hulumtojë të gjitha parregullsitë që janë bërë në Ministrinë e Arsimit dhe në sektorin e arsimit në përgjithësi, dhe ky komision është mirë që të bartë barrën kryesore. Komisioni i Arsimit dhe kryetari i këtij Komisioni hetimor të jetë kryetari i Komisionit për Arsim, zoti Kurteshi dhe ne të jemi anëtarë të cilët do të kontribuojmë dhe do të hetojmë të gjitha parregullsitë në Ministrinë e Arsimit. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, kush e do fjalën? Deputetja Luljeta Veselaj-Gutaj! Luljetë, një minutë, regjia, ju lutem, t'i jepni fjalën!

**LULJETA VESELAJ-GUTAJ:** I nderuar nënkryetar i Kuvendit!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Pa dyshim arsimit është një nga fushat më të rëndësishme të çdo shoqërie dhe vetëm përmes një arsimit cilësor shoqëria mund të ecë përpara. Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike arsimin

e ka pasur prioritet dhe e ka në vazhdimësi prioritet kombëtar. Kemi ndjekur në vazhdimësi dhe jo pa shqetësim zhvillimet dhe vendimet e fundit të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

Shqetësimi ynë ka qenë dhe mbetet i lidhur me mungesën e vizionit nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për reforma të qëndrueshme afatgjata dhe efektive.

Kosova me të vërtetë ka nevoja të ndryshme emergjente, duke u nisur nga nevoja e ujit të pijshëm, nevoja e mbrojtjes për ambient e shumë nevoja të tjera, por të gjitha këto mund të realizohen dikur, kurse për të përgatitur një brez të arsimuar duhen dekada të tëra dhe duhet të kemi shumë kujdes.

Sistemi arsimor në Kosovë aktualisht po ballafaqohet me një varg të problematikave, duke filluar nga sistemi i arsimit parauniversitar e deri tek ai universitar.

Shqetësuese është reduktimi i projektit të Bankës Botërore për përmirësim të sistemit arsimor të Kosovës, projekti ESIF. Kjo ka ndodhur për shkak të shkallës së ulët të realizimit nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë që kishte marrë vite më parë nga Banka Botërore.

Ky projekt tanimë është reduktuar në 3.5 milionë euro dhe kjo ka ndodhur vetëm për shkak të mosecjes apo të mospunës së mirë që është dashur të bëhej nga MASHT.

Në muajin shkurt të vitit 2018 Banka Botërore, përmes një raporti e njofton ministrinë për gjendjen e projektit ESIF dhe në pikën 10 thotë: “Nëse projekti nuk fillon të ketë përparime, mjetet që kanë mbetur do të tërhiqen”. Banka pret 10 muaj që projekti të përmirësohet, por nuk sheh përmirësime dhe tani këto mjete tërhiqen.

Ju, zoti ministër, duhet të jepni përgjegjësi për këtë, apo të paktën të merrni masa në këtë drejtim.

Keni deklaruar se Banka Botërore do të sigurojë zhurmuesit për tekstin e maturës. Kjo nuk ka ndodhur. Ne nuk kemi ndonjë informacion, pos deklarimit të bankës në një nga televizionet që është deklaruar se faji nuk është nga banka.

Të gjeturat faktike që ka ndodhur në MASHT, si largimi i drejtorëve, pagesat e dy personave për një pozitë, kontratat mbi vepër brenda ministrisë, nuk japin optimizëm për siguri të cilësisë në arsim.

Largimi i zotit Idrizi nga pozita e drejtorit për shkak se nuk e ka nënshkruar një dokument, i cili e shkelte ligjin, jashtëligjor, do të thotë suspendohet nga vendi i punës.

Lëshohet një opinion ligjor për Komisionin e Ankesave në kuadër të Agjencisë së Akreditimit nga kabineti juaj, zoti ministër.

A mund të na thoni se kush e lëshoi atë opinion ligjor, këshilltarët tuaj politikë, të cilët nuk janë as me drejtim në fushën e juridikut apo ky dokument është nënshkruar nga Zyra ligjore e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

Ministër, nën ombrellën e MASHT-it është edhe Instituti Pedagogjik, i cili është duke e implementuar një projekt shumë të rëndësishëm, së bashku me Caritas-in zviceran. A mund të na tregoni se a e keni përkrahur ju si ministër dhe si institucion që Instituti Pedagogjik është nën ombrellën e institucionit tuaj dhe deri ku ka shkuar, a mund të na tregoni se deri ku ka shkuar ky projekt.

Sa i përket ofrimit të shërbimeve dhe standardet për zhvillim të hershëm për rritjen e fëmijëve dhe përkujdesjen e fëmijëve, ne konsiderojmë si Grup Parlamentar i Partisë Demokratike se nuk është në nivel të kënaqshëm dhe ky proces nuk është duke ecur mirë. Ka shumë sfida dhe problematika, të cilat po hasen gjatë këtij procesi.

Në arsimin e kurrikulës bërthamë ka pasur shumë vërejtje kritika për mungesën e cilësisë. Bile, bile në grupin punues janë larguar përgjegjësitë e Divizionit për edukim parashkollor, të cilët kanë qenë pjesë e grupit punues paraprakisht.

Problematikë tjetër mbetet ngritja profesionale e personelit në përputhje me kurrikulat shkollore deri te përgatitja e nxënësve për tregun e punë, në mënyrë që ndryshimet të jetë të pranueshme dhe lehtë të zbatuara.

Në muajin qershor të vitit 2018, 120 persona iu kanë nënshtruar testit për trajner nacional për t'u trajnuar në shtetin e Ajovës.

Janë bërë gati një vit, rezultatet nuk janë publikuar dhe këta persona që iu kanë nënshtruar testit ende nuk e dinë se çfarë ka ndodhur me procesin. A mund të na tregoni se ku është ky proces dhe kur do të publikohen këto rezultate.

Problem i veçantë dhe shqetësues nga shumica prej nesh ka qenë në vazhdimësi mbingarkesat e çantat e nxënësve. Na është premtuar që nga fillimi i mandatit tuaj se do të kemi mësim tërëditor, por ende nuk kemi parë ndonjë lëvizje konkrete apo ndonjë rezultat konkret. A mund të na thoni se çka e keni ndërmend ose cilët janë hapat e mëtejshëm, të cilët ju po i bëni.

Sa u përket teksteve shkollore, mangësitë e evidentuar në proces e kanë shthurur qëllimin parësor të ministrisë për një proces transparent dhe tekste të mirëfillta. Sikurse që këto mangësi tashmë

kanë dëmtuar legjitimitetin e gjithë procesit, kjo besojmë që do të përshkallëzohet nëse këto tekste miratohen për botim.

Do të jetë e patolerueshme për të gjithë aktorët e përfshirë në arsim parauniversitar dhe në veçanti për komunitetin e mësimit dhe prindërve që tekstet e shumëpritura të mos dallojnë nga ato të cilët i kishin, të mëparshmet apo që i kishin më herët.

Në situatën që jemi në arsimin parauniversitar çdo neglizhencë që kontribuon tutje në moscilësinë në arsim është e papranueshme për Grupin Parlamentar të Partisë Demokratike.

Infrastruktura shkollore ende ka mungesë të theksuar të pajisjeve shkollore. Shumica e klasave, kabinetet profesionale nuk po i plotësojnë standardet e nevojshme për qëndrim dhe punë normale të nxënësve në procesin mësimor.

Ka shumë mungesë të pajisjeve dhe orendive shkollore didaktike, gjë që po ndikon negativisht në cilësinë e mësimit dhe mësimnxënies.

Mungesa e një stafi profesional për një trajtim dhe edukim më të mirë nëpër shkolla, siç është pedagogu, psikologu, sociologu, po reflekton negativisht në cilësinë e procesit mësimor dhe konsiderojmë se është nevojë imediate përfshirja dhe funksionalizimi i tyre sa më parë në shkolla.

Pastaj, një ndër parimet me të cilat mbështetet sistemi i ri arsimor është parimi i orientimit profesional, i cili ka të bëjë me zhvillimin dhe përdorimin efikas të aftësive, shprehive dhe sjellje të individit.

Për aktivizim të potencialeve intelektuale dhe fizike të njeriut është e nevojshme të zbulohen dhe të kultivohen nga çerdhja, kopshtet e deri te orientimi shkollor që është klasa e nëntë dhe arsimi profesional.

Ç'po ndodh sot me të rinj lidhur me orientimin e tyre profesional dhe me tregun e punës, zoti ministër?

Si pasojë e gjithë këtyre faktorëve të lartcekur, shumë të rinj në kohë transicioni po përballen me shumë të papritura në krizë ekonomike dhe sociale. Thjesht, ua lënë rrethanave të fatit dhe rastësisë, pa dyshim se është duke munguar një orientim dhe informim i drejtë profesional institucional, kështu janë të prirë të udhëhiqen nga imagjinata.

Sistemi i arsimit ne e dimë që asnjëherë nuk guxon të jetë në nivel të njëjtë, pra çdoherë kërkon ndryshim, reformë dhe kërkon që t'i shërbejë dhe t'i përshtatet sa më mirë dhe sa më bindshëm

ndryshimit të shoqërisë në kuptimin pozitiv. Arsimi cilësor është impakt për zhvillimin e vendit, cilësia në arsim apo alternativa e arsimit në funksion të zhvillimit ekonomik e shoqëror do të jetë zgjidhje edhe për vendin, edhe për Kosovën. Ne jemi duke bërë eksperiment me një gjeneratë, kam kërkuar edhe në komision, kërkoj edhe tani të kemi kujdes me gjeneratën, të cilën po e përgatitim. Këta fëmijë do të jenë e ardhmja e vendit, e ardhmja e Kosovës dhe një ditë do ta udhëheqin Kosovën. Nuk guxojmë të bëjmë eksperimente me sistemin arsimor. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! tani në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje fjalën e ka deputeti Albin Kurti.

ALBIN KURTI: Deputetë të Kuvendit!

Qytetarë të Republikës,

Ministër i Arsimit,

Rezultatet e PISA-s te arritshmëria e nxënësve në lexim treguan që Kosova me 146 pikë nën mesataren e Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim ngelet në fund të ranglistës. Meqë 40 pikë janë sa një vit shkollimi, i bie që maturanti ynë është i nivelit të semimaturantit. Nxënësit nga Kosova treguan rezultate të dobëta në testin e kaluar të PISA-s, krahasuar me pothuajse të gjitha vendet e tjera. Nuk kemi edhe një test të PISA-s për arsimtarët dhe mësimitdhënësit e profesorët, sepse kushedi se si do të rangoheshim aty.

Vetëm 13% e buxhetit për arsim në Kosovë ndahet për shpenzime operative, ndërkohë që mesatarja e OBEZH-it është 22% me buxhete shumë më të larta sesa yni. Arsimi në Kosovë është për arsimtarët, jo për nxënësit. Pjesa më e madhe e buxhetit shkon në paga. Shkollimi në Kosovë kurrë nuk ka qenë më i shtrenjtë dhe kurrë nuk ka qenë më i dobët. Raporti i kaluar i PISA-s, sepse këtij të fundit ende nuk ia dimë rezultatit, thotë se në shkolla me klimë më të mirë disiplinore, nxënësit priren të arrijnë arritshmëri më të lartë, të tregojnë rezultate më të mira. Mirëpo, ky është përjashtim i rregullit tek ne, i gjendjes në të cilën nuk mund të thuhet se ka rregulla.

68% e nxënësve të Kosovës nuk arrijnë nivelin 2 në shkallën e përgjithshme të shkencës, 77% në atë të leximit, e 78% në atë të matematikës. Pra, përafërsisht 3/4 nuk i kanë njohuritë themelore. Kosova i ka gjysmë milioni banorë nën 15 vjeç, duhet të brengosemi shumë për ta, kur i kemi parasysh rezultatet e fundit të PISA-s për 15-vjeçarët.

Besoj që në frymën e eseve të një filozofi gjerman, Adornos, "shkollat duhet t'i mësojnë jo vetëm aftësitë, por edhe vlerat", sepse kur nuk i mësojmë vlerat, pastaj nuk arrijmë t'i mësojmë as aftësitë. Thomas Jeffersoni thoshte se "asnjë komb nuk ka qenë e nuk do të jetë kurrë njëkohësisht edhe injorant, edhe i lirë". Rezultatet e testit PISA, gjendja jonë në arsim, tregojnë për një proces, i cili po e çon Kosovën drejt humbjes së lirisë. Përmes injorancës që po ndërtohet ne po e humbim lirinë dhe gjithnjë e më pak do të bëjmë zgjedhje cilësore e të duhura në jetën

individuale të qytetarëve tanë dhe në atë kolektive të shoqërisë sonë. Kësisoj të varfrit në Kosovë që janë shumica, për shkak të kushteve mbase nuk po arrijnë të mësojnë, kurse të pasurit janë të atillë që nuk po kanë nevojë të mësojnë. Paradoksalisht nuk është kërkesë objektive e shtetndërtimit demokratik, e zhvillimit socio-ekonomik, dija, sepse ka aq shumë shembuj ku përkundër mungesës së dijes, ka suksese në jetë e në karrierë. Dhe, është dëshirë jona subjektive dija për sukses, mirëpo rrethanat objektive tregojnë se ato nuk janë të lidhura, për shkak të korrupsionit endemik dhe posaçërisht nepotizmit në institucione.

Në vitet e '90-ta në Kosovë përfundimisht është shkëputur arsimit prej ekonomisë për shkak të aparteidit, mirëpo pas çlirimit ato nuk janë rilidhur për shkak të neoliberalizmit. Në vitin 1999-2000, me zbatimin e UNMIK-ut në Kosovë, është konsideruar që Kosova ka jo vetëm papunësi të lartë, por edhe popullsi të papunësueshme, meqenëse të papunët janë të pakualifikuar. Dhe nga kjo premisë, ashtu siç shumica nuk kishin diploma, shumica u bënë me disa diploma brenda vetëm pak viteve për shkak të universiteteve dhe kolegjeve private që kanë mbirë si kërpudha pas shiut. Kjo premisë bazohet në idenë që posa të kualifikohemi ne, pavarësisht se jemi të papunësuar, do të na vijnë investime prej jashtë dhe do na punësojnë, meqë tashmë jemi të kualifikuar me diplomat përkatëse.

Mirëpo, ajo çfarë ndodhi ishte ikja apo rrjedhja e trurit, siç quhet ndryshe. Më të diturit, më të mençurit shkuan. Kjo tregoi që ajo që vlen për jetën e individit, nuk vlen për jetën e një shoqërie. Nëse tek individi së pari vjen shkollimi, e pastaj punësimi, pra ka një raport diakronik, te shoqëria këto duhet të jenë në një raport sinkron, arsimimi dhe shkollimi në njërën anë dhe punësimi e zhvillimi shoqëror e ekonomik, në anën tjetër, duhet të mendohen në mënyrë të njëkohshme, pra sinkrone. Nuk mund të mendosh për arsimin në mënyrë të suksesshme, po nuk mendove njëkohësisht edhe për ekonominë dhe anasjelltas, nuk mund të mendosh për ekonominë pa menduar edhe për arsimin. Përderisa në jetën e një individi, pra, këto janë dy faza të ndryshme kohore, në jetën e një shoqërie ato nuk janë dy faza të ndryshme, duhet njëkohësisht të mendohen, të planifikohen, e më pas edhe të zbatohen. Prandaj edhe ndodhemi sot në atë që quhet 'hendeku i shkathtësive'.

Në Kosovë i kemi mbi 20 mijë të diplomuar dhe kemi më shumë gra sesa burra, më shumë vajza sesa djem, të cilat i kanë të përfunduara studimet, i kanë diplomat, por nuk kanë vende pune. Pastaj gjysma e të rinjve janë të papunë, një pjesë e madhe e tyre nuk janë as në ndonjë trajnim për t'u punësuar një ditë. Dhe, ata që janë të punësuar, 40% janë pa kontrata pune dhe në mënyrë të përgjithshme e kanë normalizuar dukurinë ku nuk punojnë në profesionin e tyre, që i bie se edhe vitet e studimit kanë qenë investime të kota. Sipas një studimi të Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë, te sektori i shërbimeve 72% punëtorëve të rinj u nevojitet më shumë se 3 muaj për t'i fituar shkathtësitë. Kjo është 63% në sektorin e prodhimit dhe 44% te sektori i tregtisë. As çdo i 20-ti biznes, apo më pak se 5% e bizneseve nuk thonë se punëtorët bëhen kompetentë brenda muajit të parë të punës. Mbifurnizimi me disa profile, apo profesione, dhe

mungesa e theksuar me disa të tjera, janë gjithashtu dukuri e normalizuar në këtë 'hendekun e shkathtësive'. P.sh., 52% e studentëve në arsimin e lartë studiojnë shkenca shoqërore, biznes ose juridik, e vetëm 2% bujqësi, ndonëse bujqësia përbën 10% të bruto produktit vendor në Republikën e Kosovës.

Studentët e RIT Kosova, apo siç njihet ndryshe Universiteti Amerikan, gjatë studimeve Bachelor janë të detyruar t'i kenë 2 programe me punë praktike, me nga 400 orë punë secili prej tyre, si parakusht për diplomim. Prandaj nuk është e çuditshme që mbi 90% të të diplomuarve në Universitetin Amerikan janë të punësuar ose madje kanë edhe bizneset e tyre. Në Austri dhe në Gjermani përafërsisht 2/3 e nxënësve shkojnë nëpër shkolla profesionale, ndërsa 1/3 në gjimnaze - është raporti 1 me 2. Ne nuk e bëjmë mbase përnjëherë, por ky duhet të synohet. E nëse nuk synohet, nuk ka se si të ndodhë. Ky duhet të jetë përafërsisht raporti, nëse duam ta lidhim ekonominë me arsimin, e unë besoj që kjo lidhje është vendimtare për suksesin e vendit tonë.

Më lejoni ta përfundoj, duke thënë që ka vetëm një gjë më të rëndësishme edhe se arsimi, edhe se ekonomia, e kjo është pikërisht ndërlidhja e ekonomisë me arsimin, ndërlidhja e arsimit me ekonominë. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, deputetja Teuta Haxhiu.

**TEUTA HAXHIU:** Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Që në fillim të fjalës sime po dua ta bëj një ndërhyrje për një seancë të jashtëzakonshme për arsimin në përgjithësi në Kosovë, se a është seancë e jashtëzakonshme dhe a është gjendja e jashtëzakonshme, kjo i ka dy përgjigje, sipas meje.

Seancat e jashtëzakonshme që shumicën e kohës së punës së deputetëve kanë qenë pra të thirrura sa për të thënë dhe mosmonitorimi i rekomandimeve prej seancave qysh vitin e kaluar që kemi thirrur edhe një seancë, e që sinqerisht po të ndalemi te ato rekomandime, jemi po në atë gjendje, të mos them në disa sektorë edhe më keq. A është gjendja për të ngritur shumë çështje, duke filluar prej arsimit para universitar, them po, por po e bëj edhe një ndërhyrje për shkak të një gare të koordinatorit nacional që bëri bujë në kohën kur nxënësit tanë për shkak të amullisë së dy vendimeve se kush është më i forti, Ministria apo SBASHK-u, ata mbetën nën hije, duke mos ditur kah t'ia mbajnë nxënësit, mësimdhënësit, po edhe vetë prindërit. Gara e organizuar nga koordinatori, edhe pse gjatë gjithë kohës shumica kishin vërejtje, por për çudinë time, ngase arsimi nuk është i një subjekti politik, nuk do të duhej, ngase arsimi nuk do të duhej të shihej si i një qeverie, nuk do të duhej dhe nga se secili subjekt politik, po bash secili në këtë Kuvend ka ndikuar që të jetë arsimi në këtë gjendje, pa përjashtim, mund të përjashtohen individë, por jo subjekte politike. Atëherë, a është problemi ynë si shoqëri? Po! Pse e përmenda garën, për të treguar se në kohën kur e kemi thirrur koordinatorin në komision, ajo që mua më ka habitur kanë



qenë shkresat e kryetarëve dhe fjalët miradije për organizimin e asaj gare, kryetarëve të komunave të gjitha subjekteve politike, të gjithave.

Në anën tjetër, ne merrnim shumë vërejtje prej mësimdhënësve për shkak të monitorimit të asaj gare që nuk kishin shkuar për ta monitoruar ekspertët e kësaj gare, por e kishin monitoruar vetë mësimdhënësit, por megjithatë në aspektin e përgjithshëm na dilnin fjalë miradije. Po e përmend një rast, në komunën e Pejës gjatë monitorimit të ligjit, drejtori i Arsimit në Pejë tha ka qenë e mirëseardhur, drejtori normalisht se është i LDK-së, por sinqerisht, për çudi tha “ka qenë në momentin e duhur”, po e citoj drejtorin, ngase në kohën kur nxënësit, për fat të mirë, Komuna e Pejës nuk e ka përfillur vendimin e SBASHK-ut, por e ka mbajtur mësimin, ngase janë thirrur vetë mësimdhënësit dhe për fat të mirë që ka edhe mësimdhënës të shumtë, të përgjegjshëm dhe të ndërgjegjshëm dhe thotë “kjo garë ka ardhur në kohën e duhur, ngase nuk i ka lënë nxënësit krejt të qetë, por është folur gjithë kohën për garën”. Pra, çka po dua të them? Thirrja e seancave të jashtëzakonshme, veprimet tona konkrete, detyrat tona dhe përgjegjësitë tona, në këtë vend mungon llogaridhënia prej A deri në Zh. Pra, arsimi fillor në radhë të parë duke parë tendencën për depolitizim, e në fakt, po e politizojmë. Duke i parë përgjegjësitë e niveleve lokale, secili subjekt politik, secila parti e ka të paktën një komunë, megjithatë në interesin e përgjithshëm të të mësuarit, të të nxënësve nuk e ka ngritur shqetësimin gjatë kohës kur nxënësit ishin jashtë bankave shkollore, jo në masën sa është dashur.

Pra, kemi shumë shqetësime për shkak të numrit të vogël të nxënësve çdo ditë e më shumë, çdo vit e më shumë, por çdo ditë, po them. Por, kemi edhe mbingarkesë të numrit të nxënësve në disa paralele, në disa komuna, atëherë a është shqetësim yni i përbashkët në komunat që kanë mbi 48 nxënës në një paralele dhe ato që i kanë një nxënës apo dy nxënës që mësuesi shkon me pesë ditare në një orë, çfarë mësimi mund të bëhet? Ky është shqetësim për të gjithë ne. Pra, nuk duhet të mendojmë në aspektin e fotografisë apo të votave tona në të ardhmen. Pra, duhet të merremi edhe me problemet, të cilat e atakojnë shoqërinë në përgjithësi dhe arsimin. Pra, Fushë-Kosova nuk e ka hapësirën për të ndërtuar një çerdhe, pra s’ka hapësirë publike. Çdo vit ballafaqohet me mbinorma dhe mësimdhënësit punojnë me vite për të ardhur në shprehje për të hyrë në listë të pagave.

Pra, unë konsideroj që në arsimin fillor duhet t’i largojmë sidomos punësimet joprofesionale dhe ky nuk është veç problem i ministrit, pa hequr përgjegjësinë, por përgjegjësinë secili që e ka duhet të japë llogari dhe llogari nuk jep askush. E kemi një Udhëzim administrativ që po presim që disa muaj, të mos them që disa vite, Udhëzimin administrativ për përzgjedhjen e drejtorëve, ministër, dhe mohimin e një të drejte elementare për të konkurruar kandidatët që kanë përfunduar “Udhëheqje arsimore” në institucionet publike në Fakultetin e Edukimit, i akredituar që 9 vjet nga Këshilli Shtetëror i Cilësisë. Dhe ata kandidatë asnjëherë nuk kanë ardhur në shprehje për t’u bërë drejtorë, pse? Për shkak të interesave edhe të individëve këtu, edhe të interesave në nivelet lokale për të çuar drejtorë të cilët kanë përfunduar një trajnim tregëtor që ka qenë ose i organizuar

nga SBASHK-u, e që i ka katër programe brenda ministrisë që vetë ministria ia ka aprovuar, por edhe nga organizatat e tjera profitabile dhe në fund i nxjerr në lajthitje vetë kandidatët për të vrapuar mbas trajnimeve dhe jo për të kryer punën për çka ata janë thirrur, e sinqerisht që shumica e tyre janë shumë të përgjegjshëm.

Pra, po presin përfundimin e një Udhëzimi administrativ, i cili po stërzgjetet. Nëse ndalemi te departamentet, ministër, ky është një problem, i cili nuk do të duhej të ishte, ushtrues detyre. Deri kur më me ushtrues detyre nëpër departamente. Ushtrues detyre është një detyrë që secili thotë që nuk e kam unë përgjegjësi dhe aty bëhen pazare. Duhet përfunduar çështja e cilitdo zyrtar që është ushtrues detyre me vite të tëra, ngase po e keqpërdorin detyrën. Po i përmend shqetësimet që më kanë ardhur prej disa kandidatëve në qendrat burimore, të cilët ankohen për punësime joprofesionale dhe ne kemi marrë disa shqetësime, edhe si anëtarë të komisioneve përkatëse ku jemi. Pra, po flas edhe për qendrat burimore, të cilat pra vetëpunësimet po bëhen duke pasur ndikim edhe nga vetë MASHT-i.

Një shqetësim shumë i madh është te Departamenti i Inspektoratit. Kemi punuar shumë si komision, meqë unë jam që tri mandate në të njëjtin komision, të gjithë deputetët e këtij komisioni për të nxjerrë një ligj për Inspektoratin, duke kërkuar që ndoshta është arsye e mosngritjes së cilësisë në arsim Ligji për inspektoratin. Pra, është miratuar ky ligj dhe kemi udhëzimet administrative, të cilat po stërzgjeten. Pra, detyrën që e kanë zyrtarët për të punuar, për të nxjerrë udhëzimet administrative, dikujt po i konvenon dhe sot kemi 32 pozita të lejuara, është buxheti, pra ke buxhet, i ke pozitat e lejuara, nuk hapen konkurset dhe njerëzit profesionistë presin. Do të duhej jo vetëm të hapen sa më parë konkurset, por të zgjedhim njerëz profesionistë, të cilët vërtet punojnë për ta ngritur cilësinë në arsim. Pra, për mua është shqetësuese pse të udhëhiqet ende ky departament me ushtrues detyre.

Tjetra, Ligji për arsimin e viteve të '90-ta, buxheti është ndarë me kohë, ligji ka hyrë në fuqi, janë udhëzimet administrative, të cilat po e pamundësojnë zbatimin ose thjesht kompensimin e këtyre mësimdhënësve të atyre viteve, pse po ndodh kjo? Buxhet ka, domethënë buxheti nuk po mungon. Kjo është për mua e papranueshme.

Kemi biseduar për tekste shkollore edhe në komision, ministër, krejt çka mua më intereson ankesat e disa kandidatëve, të cilët më kanë shkruar që kanë qenë si recensentë, në fakt, jo gjatë procesit, por iu ka pamundësuar, por janë ankuar në ministri, pse nuk kanë marrë përgjigje dhe kur marrin përgjigje? Dhe, në fund e keni përmendur edhe në komision, janë përgjegjës vetë recensentët nëse...

*(Ndërprerje nga regjia)*

**KRYESUESI:** Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të PSD-së, deputeti Driton Çaushti.

DRITON ÇAUSHI: Faleminderit!

Të nderuar qytetarë,

Kolegë deputetë,

Besoj që pajtohem të gjithë që sot po zhvillojmë ose po bëjmë përpjekje që të zhvillojmë një debat të padiskutueshëm për nga rëndësia, por besoj që gjithashtu duhet të pajtohem për vështirësinë që ka trajtimi sidomos i një çështjeje kaq të gjerë dhe pamundësinë që ky debat të jetë i mjaftueshëm për të arritur qëllimet që ne të gjithë synojmë edhe si Kuvend, shpresoj edhe si shoqëri në fushën e arsimit.

Natyrisht që tema të veçanta, çështjet aktuale janë të rëndësishme dhe secili prej nesh do të përmend disa nga to, por besoj që pajtohem që është e pamjaftueshme që në këtë mënyrë të trajtohet një problem kaq i gjerë, pra vetëm nga aktualiteti në zhvillimet e fundit, duke qenë të vetëdijshëm me atë që ka ndodhur për të paktën për 20-30 vjetët e fundit. Pra, mendoj që është përfundimisht koha që ne të fillojmë të trajtojmë këtë fushë si një tërësi të pandashme, siç edhe kërkon thirrja e këtij debati, pra duke e trajtuar në të gjitha hallkat e saj, në shumëdimensionalitetin dhe kompleksitetin e saj, pra në të gjitha nivelet, nga niveli parashkollor deri te ai universitar. Do të duhej të pajtohem të gjithë mbi një ide se si do të duhej të shihej arsimit në përgjithësi dhe do të thotë kjo jo vetëm si një përgatitje për punë, si zakonisht reduktohet, por një përgatitje për jetë. Gjendja e rëndë, sot e konstatojmë të gjithë, natyrisht se është produkt i një krize mbi 30-vjeçare, pra të pjesës së viteve të '90-ta, me krizën e arsimit në atë kohë dhe 20 vjetët e fundit, ku natyrisht janë bërë gabime të mëdha që mund të manifestohen e mund të interpretohen si me mungesën e prioritetit që ka marrë arsimit ose vendi që ka marrë arsimit si prioritet, mungesën e vizionit që shprehet edhe me mungesën e buxhetit, po edhe në gabime të mëdha në hapa drejt zhvillimit të kësaj fushe.

Arsimi parauniversitar, ku duhet fituar dija bazë, e cila i paraprin secilës dije që vjen më pastaj, gjendet në një moment tepër të vështirë. Ndërhyrja brutale e partive në pushtet në të gjitha pushtetet e pasluftës nëpërmjet punësimeve nepotiste, e në baza partiake, ka goditur dhe po vazhdon të godasë në bërthamë cilësinë në këtë nivel arsimor, duke prodhuar nxënës, të cilëve nuk u zhvillohen aftësitë elementare të kuptuarit. Kjo mund të tingëllojë e parëndësishme ose e paqartë në dëgjime të parë, po fakti që nuk ekziston një lidhje organike me atë se çka kanë në bankat e tyre fëmijët, moskuptimi i konceptit të shkronjës e numrit, përbën një problem të madh për të ardhmen e tyre dhe rezultati i PISA-së ishte dëshmia më e mirë për këtë, pra testi i fundit. 77% e nxënësve 15-vjeçar nuk kanë arritur nivelin minimal të aftësive në lexim, 78% të tyre në matematikë dhe 68% në shkencë. Mungesa e teksteve cilësore shkollore përgjatë gjithë këtyre viteve vetëm sa ka rënduar gjendjen në arsimin parauniversitar, e me sa duket me të njëjtën problematikë do të vazhdojmë të merremi edhe më tutje. Pra, mësimdhënësit e kanë edhe më të qartë se pas një procesi dërrmues të përgatitjes e prezantimit të një kurrikule të re me shumë pikëpyetje, në mundësinë edhe të përvetësimit, edhe të implementimit të saj nga mësimdhënësit, përpilimi, përzgjedhja e botimi i teksteve tani shoqëruese të kësaj kurrikule, përballet me kritika

e vërejtje serioze nga të gjitha anët. Çfarëdo përpjekje kuptimplote për ta ndryshuar këtë realitet do të duhej gjithsesi ta përfshinte edhe një analizë serioze mbi rolin dhe atë që ofron Fakulteti i Edukimit në cilësinë e arsimit parauniversitar. Pra, nga cilësia e kuadrove që nxjerr ky fakultet, kriteret për të vijuar nivelin master, e deri te cilësia e atyre që e fitojnë të drejtën të studiojnë aty. Pra, nëse pajtohemi për rëndësinë e këtij institucioni duhet gjithashtu të shtrojmë pyetjen se cili është kriteri ose cila është mundësia, kush mund të fitojë të drejtën të studiojë në këtë fakultet.

Me siguri e dini shumica prej jush, por sipas Projektligjit për arsimin e lartë kushti për t'u pranuar këtu është nota mesatare 4,5 edhe kalimi i testit të maturës. Pra, çfarë sigurie na jep kjo duke ditur se çfarë ka ndodhur me pragun e kalueshmërisë së këtij testi. Edhe me këtë test në përgjithësi, që s'duhet ta pranojmë, ka qenë një prej dështimeve të mëdha prej nga fillimi i implementimi i tij e deri më sot.

Kur jemi te testet e vlen besoj të përmendet për shkak se në mënyrë tragjike tregon realitetin e arsimit, garën që sapo kaluam, të ashtuquajturën garë e diturisë. Pra, e rikujtoj për ata që nuk e kanë të qartë, se flasim për një test i pabazuar, ose të pabazuar në asnjë hulumtim, që do të arsyetonte nevojën për të, që mund të ketë pasoja të ndryshme negative për nxënësit, që shpenzojmë qindra e mijëra euro të Buxhetit të Kosovës e që mbi të gjitha, organizohet nga një institucion i shpikur që anashkalon plotësisht institucionin që bartë përgjegjësinë mbi cilësinë e arsimit e që është Ministria e Arsimit.

Pra, koordinatori për arsim dhe kulturë është një gjetje e re e qeverisjes aktuale, organizon test të cilin edhe para komisionit nuk ka pasur asnjë arsyetim ta bazojë mbajtjen e tij, duke e anashkaluar dhe injoruar Ministrinë e Arsimit.

Do të ishte naive me gjithë këto që përmenda, që të pretendonim se kësaj krize në procesin arsimor t'i shpëtojë sistemi i arsimit të lartë. Këto janë të lidhur dhe nuk mund të trajtohen veç e veç. Ndërhyrje po aq brutale partiake e klanore rrënim i autonomisë së Universitetit, hapja e universiteteve publike për interesa puro elektorale, proliferimi i universiteteve private, të gjitha këto me dëme të paimagjinueshme në institucionin e Universitetit, në shkencën dhe në mbarë shoqërinë. Do të mund të vazhdonim më tutje duke konstatuar probleme të shumta, me të cilat ballafaqohet sistemi arsimor në Kosovë, por preferoj të flas shumë shkurtimisht edhe për dy zhvillime, të cilat do të duhej t'i marrim seriozisht.

E para ka të bëjë me punën e muajve të fundit të Agjencisë Kosovare për Akreditim, e cila edhe me shqetësimin që kemi pasur të gjithë për cilësinë e universiteteve publike, ka filluar të hapë më në fund këtë diskutim të pashmangshëm publik, si pasojë e gjetjeve të këtij institucioni. Kjo është punë e papërfunduar, por besoj se hapja e këtij diskutimi është e dobishme dhe duhet të vazhdojë më tutje.

Zhvillimi i dytë është nisura e kryetarit të Komunës së Kamenicës për riorganizimin e shkollave fillore dhe të mesme në këtë komunë. Arsyeja pse unë besoj që kjo çështje meriton të diskutohet në këtë debat sot, është sepse prek një fenomen nacional për të cilin për vite me radhë jemi të vetëdijshëm të gjithë, por për të cilin ka munguar thjesht guximi politik për ta trajtuar. Pra, fjala është për rënien e madhe të numrit të nxënësve në klasa e shkolla për shkak të migrimit dhe rënies së natalitetit e arsyeve të tjera, që përveç të tjerave po e dëmton seriozisht cilësinë e procesit mësimor. Jam tashmë i bindur dhe besoj që kemi një pajtueshmëri këtu me këtë që kemi dëgjuar ditët e fundit, që një hulumtim në nivel vendi është i domosdoshëm, i pasuar me hapa të tjerë, me qëllim të përballjes me këtë problem serioz.

Me këtë rast propozoj që kjo duhet të jetë domosdoshmërisht një nga pikat e një rezolute që mund t'i pasojë diskutimit të sotëm.

Të nderuar qytetarë,

Kolegë deputetë,

Besoj që Kuvendi nuk është forumi ku mund t'i zgjidhim problemet e arsimit. Mund të nxjerrim konkluzione, mirëpo është momenti përfundimtar që duhet të ketë një angazhim mbarë shoqëror, përtej institucioneve aktuale të arsimit, duke përfshirë edhe Akademinë e Shkencave dhe Universitetin dhe i bindur që ky problem nuk mund të lihet si zgjidhje, ose si çështje e klasës politike.

KRYESUESI: Faleminderit, Driton! Tani, në emër të Nismës Socialdemokrate, deputetja Albulena Balaj-Halimaj.

ALBULENA BALAJ-HALIMAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Ndoshta seanca e sotme nuk ka qenë e nevojshme të jetë e jashtëzakonshme. Kemi mundur të debatojmë për arsimin edhe në seanca plenare, në seanca të rregullta, sepse të thërrasësh një seancë të jashtëzakonshme për ministrin në këtë mandat, zotin Bytyqi dhe për vendimet e tij, e të flasësh prej shekullit 2 para lindjes së Krishtit e deri më tash për dështimet në arsim, është e padrejtë. Pra, nuk është mirë t'i huqim vitet, as testet. Nëse flisni për testin PISA do të duhej ta dinit që nuk ka qenë në mandatin e ministrit Bytyqi. Unë e di që është dështim. Sigurisht, ka dështuar Kosova në atë test.

Por, tani kemi pasur krejt një organizim tjetër për testin PISA dhe ne po presim rezultatet. Të mos ngutemi, po i presim rezultatet dhe të shohim pastaj nëse dalim njëjtë do ta kritikojmë sigurisht ministrin. Po ta kishin pasur kaq seriozisht kolegët që folën deri tash për arsimin, besoni që bash asnjë punë nuk do t'i kishte mbetur ministrit Bytyqi me e bë tash, ama bash. Qysh ka mundësi, për shembull, LDK-ja me PDK-në me bë pyetje, se pse nuk ka çerdhe publike? Qysh

ka mundësi VV-ja me e pyet Nismën, ose zotin Bytyqi pse fëmijët 0 - 5 vjet shkojnë në çerdhe private? Shkojnë në çerdhe private, se nuk ka çerdhe publike. Çerdhet publike kush nuk i ka bë? Nuk i ka bërë ministri Bytyqi. Unë po e marr vetëm një shembull, Prizrenin.

Për shembull, në Prizren ka qenë vetëm një çerdhe publike dhe atë e kanë privatizuar. Pra, Prizreni si një qytet i dytë nuk ka pasur asnjë çerdhe publike dhe normalisht, fëmijët detyrohen të shkojnë në çerdhe private. Pse nuk i ka bërë ministri Bytyqi çerdhet, apo nuk i ka bërë Qeveria Mustafa që ka qenë edhe PDK-ja aty. Vetëm tani në Prizren këtë vit po ndërtohen tri çerdhe publike. Kjo është pra nëse duam të jemi real, flasim në këtë formë, jo t'ia atribuojmë dështimet e Qeverisë së kaluar ministrit Bytyqi dhe kësaj Qeverie.

Nëse ndalemi te kritikën të cilat i mori ministri Bytyqi, fare lehtë shohim se janë të pabaza në këtë mandat dyvjeçar që e ka ministri, por që kanë të kaluar më të gjatë dhe sigurisht ne e shohim fajtorin e mëparshëm. Nuk mund të thotë, për shembull, PDK-ja që e ka pasur prioritet kombëtar arsimin, kur nuk ka ndarë buxhet për të. Nuk po them se tash buxheti për arsim është në nivel, në asnjë mënyrë. Nëse duam ne si deputetë të mos e votojmë, për shembull, një buxhet i cili nuk e ka prioritet arsimin, asnjë qeveri nuk mund të na detyrojë. Ne vet e kemi votuar Buxhetin duke e ditur që arsimi nuk është prioritet, madje sipas meje, prioritet do të ishte edhe shëndetësia. Për shembull, në arsim në shkollë nuk ka laboratorë, nuk ka kabinete, në spital nuk ka shiringa e ne dalim e flasim e kritikojmë këtu për diçka që ne vet kemi marrë vendim. Pra, nuk na ka detyruar askush, të bëhemi real, se aty ku duam ta dërgojmë arsimin, aty ku ne po kërkojmë, atëherë ne për atë edhe mund të vendosim.

Nëse bëhemi, prapë po them realë, përveç kritikave do të duhej ta shihnim, ose të flisnim edhe për të arriturat e Ministrisë së Arsimit. Nuk po flas, as nuk dua të flas për të arriturat e mëhershme të qeverive të kaluara. Dua t'jua kujtoj juve dhe qytetarëve të arriturat e kësaj ministrie, ministrit Bytyqi dhe nën udhëheqjen e Nismës Socialdemokrate.

Ju e dini, ose ju keni folur shumë për depolitizimin e shkollave, në fakt deri më tash nuk ka bërë askush asgjë. Pra, 20 vjet nuk ka ndërmarrë asnjë subjekt politik që ka qenë në Qeveri për t'i depolitizuar shkollat. Për herë të parë ministri Bytyqi pasnesër besoj do ta nënshkruajë Udhëzimin Administrativ për zgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve nëpër shkollë, sepse ata nesër do të jenë menaxherë të shkollave dhe këtu është depolitizimi. Pra, ne jemi për një depolitizim dhe nëpërmjet këtij udhëzimi administrativ do të fillojmë t'i depolitizojmë shkollat dhe kjo është sigurisht e arritur. Pastaj, ju e dini që për Projektligjin e viteve '90/'99 kemi debatuar gjatë, madje kanë debatuar vite dhe kanë kërkuar mësimdhënësit me vite të tëra nga deputetët, që ta votojnë, por që asnjëherë nuk ka ardhur në Kuvend. Ta dini që për herë të parë ministri Bytyqi e ka sjellë në Kuvend Projektligjin për vitet '90/'99, ne e kemi votuar dhe tashmë po e presin mësimdhënësit t'i realizojnë ato që ne ua kemi mundësuar. Pra, është meritë ekskluzive e ministrit Bytyqi.

Ajo që ka qenë shumë e rëndësishme dhe është, tek studentët ne kemi parë që ka pasur studentë që kanë pritur 3 - 5 vjet për një nostrifikim të diplomës. Sot për ta nostrifikuar një diplomë presin dy javë, e më së gjati presin një muaj. Kjo sigurisht se është një e arritur dhe nuk do të duhej të bëhemi se nuk po e shohim.

Tepër e rëndësishme për studentët sigurisht janë edhe bursat. Për herë të parë një student i është kthyer dinjiteti me bursë. Një student për doktoraturë sot i merr 7500 euro jashtë vendit nëse doktoron. Sa ka qenë në qeveritë e kaluara, ose në qeverinë e kaluar? Kjo shumë ka qenë vetëm 2 500 euro, sot e kemi 7 500 euro, pra 5000 euro më shumë për studentë të doktoraturës. Për herë të parë, për herë të parë në Kosovë jepet bursë studentit me nevoja të veçanta. Për herë të parë këta studentë me nevoja të veçanta marrin bursë nga Ministria e Arsimit dhe kjo është e arritur. Nga 190 sa ka qenë për studentët e brendshëm bursa, sot është 880 euro. Edhe kjo është një e arritur. Pra, Ministria e Arsimit nuk është që është veç për kritika, duke u bazuar në ngritjen e bursave e të arriturave tjera, të cilat edhe i thashë, edhe i them.

U fol këtu edhe për Këshillin Shtetëror të Cilësisë dhe u kritikua për herë të parë ju e dini që ne kemi votuar këtu për atë këshill dhe për herë të parë është shpallë konkurs për ata, të cilët duan të jen në atë këshill. Pra, me konkurs janë përzgjedhur, është formuar komisioni dhe për çfarë ndërhyrje po flasim? Nëse flasim për ndërhyrje atëherë do të duhej të thoni se cilat janë ndërhyrjet dhe kush i ka bërë ato ndërhyrje. Vendimi tjetër për celularët, për ndalimin e celularëve nëpër shkolla ka qenë venim i ministrit, të cilin ndoshta më vonë do të hiqet, por tani për tani ka qenë tepër i nevojshëm dhe është një e arritur e ministrit Bytyqi.

Këto janë disa vendime. Sigurisht, se ministri do t'i përmend edhe shumë vendime të tjera të mira për arsimin, por që edhe një herë po them, arsimit nuk ka filluar me ministrin Bytyqi, as nuk do të përfundojë me ministrin Bytyqi. Prandaj, të bëhemi realë dhe dështimet e qeverive të kaluara të mos, ose të mos kërkojmë llogari nga ky ministër për dështimet e qeverive të kaluara. Nëse qeveritë e kaluara do ta kryenin punën e vet ashtu siç po thonë, asnjë punë nuk do t'ia linim ministrit Bytyqi. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Duhet të marrim qëndrimet e grupeve parlamentare, të përfaqësuesit të Qeverisë, pastaj mund të replikoni. Grupi Parlamentar 6+, kush e do fjalën? Deputetja Mufëra Shinik, urdhëro!

**MUFËRA SERBICA-ŞINIK:** Faleminderit, kryesues!

Ju përshëndes!

Përshëndetje për ministrin!

Faleminderit kryesues, ju përshëndes, përshëndetje për ministrin

Kosova Meclisinde eğitimini tertışıldığı bu oturumda, bugüne kadar uyarı ve önerilerimizden çoğunun kabul edilmesinden memnuniyet duyduğumuzu beriltmek isterim. Nice ki iki yıldan

beri bu Mecliste pedagog ve psikologların işe alınma konusunu vurgularken, bu günlerde duyurunun yayınlanması bizleri memnun etmektedir. Bir toplumun atar damarı olan eğitimdeki ders kitapları ve araçlarının en düzeye ulaşması gerekir. Kitap Yayınlama Duyuru başvurularından sonra seçici kurulun daha dikkatli çalışacağına eminiz. Aynı zamanda bir öğretmen olmamla birlikte bu günlerde 2018/2019 Eğitim Öğretim yılının sona erip ermediğinin belirsizliği öğrencilerimizde negatif etki yaratmaktadır. Yapılan grevler eğitim çalışanlarının katsayısı düzenlenmesi dışında sendikanın böyle bir organizasyonu düzenlemelerinde keşke grevleri, okul donanımları, laboratuvar, ders kitapları, araç ve gereçleri dışında ders yapılması için donanımları ve okullardaki temizlik ihtiyaçları için aynı zamanda öğretmenlerin kalifiyesinin artırılması için çaba sunulması konusunda yapsalardı. Kosova Eğitim Bilim ve Teknoloji Bakanlığı aracılığıyla öğretmenlerin istihdamı için konkurun yayınlanmasıyla iki bakanlıkla çalışarak Prizrendeki anaokulları, öğretmenleri ve ihtiyaç olan diğer boş yerler için konkurun yayınlanması sağlanması gerekmektedir. Eğitimde çok büyük önem taşıyan eğitimcilerin yani öğretmenlerin hastalık, kaza veya başka sebeplerden çalışamaz hale gelmesi durumunda yüzde yüz maaşını alarak evinde dinlenerek, yerine çalışabilecek öğretmenlerin getirilmesini bakanlığın sağlanması gerekmektedir. Bu konuda eğitim sendikası da çok büyük destek beklemekteyiz.

6+ Parlamenter Grubu, topluluk milletvekillerinden oluştuğuna göre, her topluluğun eğitimde kendine göre farklı ihtiyaçları olduğu bilinmektedir. Öyleki Kosova Türk toplumu milletvekilleri olarak 2019 – 2010 eğitim öğretim yılının başlaması için hazırlıkların şimdiden tamamlanması gerektiğini vurgulamak istiyoruz. Kosova Eğitim, Bilim ve Teknoloji Bakanlığının müfredatıyla çalışan Kosova Türk toplumunda çoğunluk dilinde yapılan eğitim dilinde, yasal olarak aynı haklara sahiptir. Bundandır ders kitapları, araç gereçleri, yardımcı ders kitapları, dersliklerin kullanımı ve yönetimi de eşit olması gerekir. Özellikle çoğunluk ve çoğunluk olmayan topluluk öğrencilerinin aynı okullarda eğitim görmesinden dolayı, bu okulların bütçesinin de yasal olarak daha fazla olması, bu okullarda daha hassas ve kaliteli eğitimin yapılması gerektiğine inanmaktayız. Son zamanlarda eğitim bakanlığı dışında öğrencilerimize başka kurumların test yapması ve tercümelemlerin gecikmesiyle Türk öğrencilerinin test tarihinin ertelenmesini, öğrencilerimizde kaos yaratarak, psikolojilerini negatif etkilenmesinin tekrarlanmamasını istiyoruz. Çünkü bu hem çocuk haklarına, hem topluluk haklarına hem de aynı zamanda insan haklarına karşı olduğunu hepimiz bilmekteyiz.

Bugünkü konuşmamda en son olarak Kosova Eğitim, Bilim ve Teknoloji Bakanı Sayın Şuçri Bütüçi'ye Türkçe eğitimle ilgili özellikle bir sorum olacaktır: Aslında Türkçe eğitimdeki tüm konu ve sorunlarıyla ilgilenecek bir birimin olması gerektiğine inanmaktayız. Bunu da ivedilikle gerçekleştirilmesini bekliyoruz ve sorum şu: Kosova Eğitim, Bilim ve Teknoloji Bakanlığının öğretmenlere düzenlemiş olduğu Kapasite Geliştirme Seminerlerinin yapılmaya başladığı günden beri neden Türkçe eğitimdeki 250 öğretmene de yapılmıyor, yani bakanlık tarafından organize edilerek desteklenmiyor. Teşekkür ederim



KRYESUESI: Faleminderit! Para se t'ia jap fjalën ministrit, fjalën e ka kërkuar Luljeta Veselaj-Gutaj për replikë. Dy minuta!

LULJETA VESELAJ-GUTAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Desha t'i replikoj koleges. Iu referua fjalimit tim dhe tha që PDK-ja nuk e ka pasur prioritet arsimin. PDK-ja e ka pasur prioritet dhe do ta ketë gjithmonë arsimin. Desha t'i numëroj të arriturat të cilat janë bërë dhe mbeten historike gjatë qeverisjes së Partisë Demokratike në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

E nderuar kolege,

E para, në vitin 2007, kur PDK-ja e ka marrë qeverisjen në Ministrinë e Arsimit dhe mësimdhënësve u është kthyer dinjiteti me rritjen e pagave 100%.

E dyta, infrastruktura shkollore është përmirësuar pothuajse mbi 90%. Kemi pasur shkolla të reja. PDK-ja u ka ofruar mundësi studimi shumë studentëve të cilët e kanë ndërruar studimin, duke u nisur nga Prizreni dhe regjioni i Prizrenit, ku e di shumë mirë kolegja, që shumë studentë të suksesshëm nga Dragashi, Gjakova, Rahoveci dhe nga gjithë regjioni i Prizrenit, që s'kanë pasur mundësi studimi dhe t'i tregojnë aftësitë dhe inteligjencën e tyre, sot e kanë atë mundësi.

E treta është sigurimi i librave falas. PDK-ja dhe projektet, prioritetet e PDK-së kanë krijuar sigurimin e librave falas për të gjithë nxënësit deri në klasën e 9-të, që nuk ka qenë më parë.

Të gjitha këto janë bërë në qeverisjen e Partisë Demokratike. Sa i përket mungesës së çerdheve publike në vitin 2015 kam qenë unë, kam folur këtu në këtë foltore e kam ngritur shqetësimin e mungesës së çerdheve publike në qytetin e Prizrenit. Pse nuk është realizuar? Kërkesa ime dhe mbështetja e Qeverisë në vitin 2016 është ndarë një pjesë e fondit nga Ministria e Arsimit duke marrë parasysh që pjesa tjetër të mbështetet nga IPA fondi...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Faleminderit! Kundër-replikë, Albulena Balaj-Halimaj, një minutë!

ALBULENA BALAJ-HALIMAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Zonja Veselaj, një çerdhe ka qenë në Prizren, e dini. Nuk e di unë çka keni kërkuar më herët këtu në Kuvend. Një çerdhe ka qenë publike në Prizren dhe atë PDK-ja e ka privatizuar. Duhet ta pranoni! Këtë të gjithë e dinë. Edhe sot jepen librat falas në Ministrinë e Arsimit për nxënësit. Edhe sot i mundësohet studentëve të ndjekin studimet. Nuk kanë mundur studentët me 190 euro të ndjekin studimet ashtu siç PDK-ja i ka ndarë bursë. Sot nga 190 janë në 880 euro për studentë e kjo i mundëson një studim më të mirë studentëve dhe atyre me doktoraturë, të cilët nga 2500, i jepen 7500 euro.

KRYESUESI: Faleminderit! S'ke të drejtë Luljetë, jo s'ke të drejtë!

Tani fjalën e ka ministri Bytyqi. Do të ketë dhjetë minuta që të paraqesë qëndrimin e Qeverisë. Pas fjalës së ministrit, propozoj që të shkojmë në pauzë deri në orën 2 e gjysmë. Urdhëro!

MINISTRI SHYQIRI BYTYQI: I nderuar nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Kosovës,

Media,

Konsideroj që një debat i tillë që sot po mbahet për arsimin, vërtet e ka një vlerë të shtuar, sepse së pari na bën neve që të jemi shumë të kujdesshëm në planin dhe në kornizën ligjore, por po ashtu na bën që të kujdesemi edhe për objektivat tona të cilat janë vënë tashmë në programin tonë qeverisës.

Ajo çka nuk e bën të vlefshëm dhe që e bënë të dëmshëm në fakt debatin, nëse e orientojmë debatin për arsim për luftë politike dhe ta shigjetojmë arsimin me argumente e pa argumente ose me fraza politike. Pra nëse të gjithë jemi të interesuar që sistemin arsimor në Kosovë ta zhvillojmë dhe ta ngritim në një standard çfarë ka nevojë Kosova, nuk duhet të shigjetohet me polemika politike, po duhet ta largojmë polemikën politike. Dhe kjo ishte edhe një zotim i joni që ne e kemi bërë.

Se sa ka problematikë sistemi arsimor, se cila është gjendja e sistemit arsimor, nuk është që e dimë sot. Nisma Socialdemokrate e ka ditur që në ditën kur e ka marrë përgjegjësinë për ta udhëhequr Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Kemi qenë të vetëdijshëm që sistemi arsimor ka shumë probleme dhe që dojnë adresim për t'u zgjedhur. Kjo ka qenë që në ditën e parë përgjegjësia e lartë që t'i adresojmë problemet në sistemin arsimor. Le ta themi që përgjegjësinë e parë e kam marrë unë si ministër. Në ditën kur unë jam angazhuar si ministër, kam lënë të gjitha obligimet e tjera të cilat i kam pasur jashtë Ministrisë së Arsimit. Pra, nuk jam i angazhuar as si ligjërues siç kam qenë, asnjë angazhim tjetër. Me të vetmen arsye, që t'i përkushtohemi sistemit arsimor, për ta rregulluar dhe për t'i adresuar gjërat.

Por, vërtet nëse mendohet që brenda një afati njëvjeçar apo njëvjeçar e gjysmë do të adresohen të gjitha problematikat që i ka sistemi arsimor, kjo është më tepër sesa iluzion. Dhe nëse mendohet që për një vit e gjysmë, gjërat të cilat janë adresuar në sistemin arsimor, do t'i tregojnë rezultatet, kjo është më tepër sesa gabim. Pra, nuk priten mundësitë që brenda këtij afati të jepen edhe ato gjëra të cilat ne i kemi bërë për t'i treguar rezultatet në sistemin arsimor. Por, veprimet tona kanë qenë të menjëhershme. Duke filluar nga ato të cilat kanë qenë emergjente, e deri te ato të cilat pastaj janë planifikuar politikat edhe afatgjata.

Ajo që kemi bërë në përgjegjësinë tonë dhe më vjen keq se këtu kemi shumë deputetë të cilët janë në Komisionin parlamentar të arsimit e për të cilin ne në çdo kohë dhe në çdo moment kemi

qenë të gatshëm t'i raportojmë, t'i adresojmë dhe t'i informojmë për çdo veprim i cili është bërë brenda Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Dhe është shumë më mirë që informacionet të merren në mënyrë zyrtare, sesa të merren informacionet apo jo informacionet në mënyrë jozyrtare.

Ne kemi raportuar te Komisionin parlamentar raport të rregullt çdo tremujor. Çdo tremujor Ministria e Arsimit vazhdon të dërgojë raport te Komisioni parlamentar për Arsim, në mënyrë që t'i adresojë dhe t'i kuptojë se cila është lëvizjet që po bëhen në sistemin arsimor.

Cila ka qenë adresimi i parë që është bërë në problematikat të cilat sot këtu u përmendën disa dhe për këtë kohë është e pamundur që t'i përmendim të gjitha adresimet që ka nevojë sistemi arsimor dhe adresime të cilat ne i kemi bërë.

Ne së pari nga zhurma e madhe dhe nga parregullsitë e mëdha të cilat kishin të bënin me avancimet akademike, me publikimet në revista të dyshimta, me revista të cilat nuk kishin siguri në publikime shkencore, ne vendosëm një rregull. E bëmë një udhëzim administrativ, kur sado kudo vumë korniza më të disiplinuar për publikimet në këto platforma. Çka ndodhi? Një zhurmë e paparë. Reagime të ashpra. Ishim të vetëdijshëm, sepse po vendosim rregull. Por, sot jam më se i lumtur. Sepse, çka ndodh? Sot vetë universitetet, përfshirë Universitetin e Prishtinës, çojnë kërkesë te Ministria, a bën t'i forcojmë kriteret e publikimeve në revista më të forta sesa që i kemi në udhëzimin administrativ. Kjo është suksesi. Kjo është hapi i parë që është bërë. Dhe është bërë një gjë shumë pozitive. Pa dyshim që ne do të aprovojmë çdo kërkesë që vjen nga universitetet e që kanë për qëllim t'i forcojnë kriteret për ngritjen e cilësisë brenda universiteteve.

Kemi mundësi të lartë të korrupsionit, u përmend këtu, në arsimin e lartë. Ku është kjo mundësi e korrupsionit të lartë në arsim të lartë? Ku është kjo mundësi? Është brenda universiteteve. Dhe nëse është brenda universiteteve, kanë ndoshta hise të gjitha partitë, por më së paku ka Nisma. Dhe kjo nuk është një adresim që mund t'i bëhet Ministrisë së Arsimit. Mundet Ministria e Arsimit, ose nuk ia lejon as statuti që kanë universitetet, e as ligji që të ndërhyjë brenda organizimit akademik të universiteteve. Mund të krijojë politika të mira qeverisëse, po nuk e ka asnjë mundësi që të ndërhyjë direkt brenda këtyre universiteteve.

Hap tjetër sot në arsimin e lartë kemi një tryezë të rumbullakët, të cilët përbëhen nga ekspertët ndërkombëtarë të prirë nga ekspertët e USAID-it dhe nga shumë ekspertë vendorë, të cilët janë duke bërë një analizë paraprake për arsimin e lartë para se të merret një vendim për të pasur një strategji për arsimit e lartë.

Po ne adresuam edhe çështjen e universiteteve, por u bë një zhurmë politike dhe besoj që pa pasur nevojë fare deputetja e LDK-së që ta ngre këtë çështje, e ka raportin në Komisionin për

Arsim. Çka thotë raporti jonë? Në asnjë moment dhe asnjëherë unë si ministër nuk kam deklaruar për mbylljen e universiteteve publike. Atë e thotë sot edhe raporti. Kemi qenë për riorganizim të universiteteve publike, apo për profilizim. Të njëjtën gjë e thotë raporti zyrtar që e ka Komisioni parlamentar, dhe konsideroj që kjo është diçka që është shumë e nevojshme që të diskutohet dhe të bëhet tutje.

Çka ka ndodhur në çështjen e adresimeve që janë të nevojshme në pjesën e arsimit parauniversitar. Arsimi parauniversitar ka nevojë që të ketë një ngritje të cilësisë shumë më të lartë që e ka aktualisht. Por mos të harrojmë se një përgjegjësi më të madhe të menaxhimit dhe të ngritjes së cilësisë në arsimin parauniversitar e kanë niveli komunal, çka do të thotë se ia ka mundësuar ligji dhe këtu duhet të kontribuojnë të gjitha partitë politike për ta ndihmuar pushtetin lokal që të kemi një mbarëvajtje dhe një ngritje të cilësisë brenda pjesës parauniversitare, pra pjesës së shkollave tona.

Mirëpo ne nuk kemi ndejtur anash. Për herë të parë ka filluar matja e performancës së mësimdhënësve. Pra ishte viti 2018, një vendim i guximshëm, edhe pse kishte shumë zëra kundër, dhe shumë zhurma që mos të fillojë matja e performancës së mësimdhënësve. Dhe çka ka shkaktuar kjo? Ka shkaktuar dy gjëra shumë pozitive. E para, temë kryesore e diskutimeve mes mësimdhënësve sot janë aplikimi i kurrikulave, metodat e reja në mësimdhënie dhe në mësimnxënie. Për arsyen e vetme, sepse pritet që secilit mësimdhënës t'i matet performanca. Dhe konsideroj që kjo është një hap shumë pozitiv, sepse po na ndihmon edhe neve që të marrim shumë informacione se çka duhet të adresojmë në nivelin politik. Pra, në politikat që duhet t'i ndërtojmë për të lehtësuar çështjen e ngritjes së performancës edhe të mësimdhënësve, por edhe të mësimnxënies. Shto kësaj, pra u përmend edhe nga deputetja Balaj-Halimaj që ne jemi zotuar për depolitizim të sistemit arsimor dhe sot udhëzimi administrativ i cili do të nënshkruhet pasnesër, pikërisht do të ndikojë direkt në depolitizimin e zgjedhjes së drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve, sepse akterët kryesorë bënë vendimmarrjen e zgjedhjes së drejtorëve e zëvendësdrejtorëve do të jetë faktori prindër dhe këshilli drejtues i shkollave të cilën i përkasin, përkatësisht janë atë të cilët e menaxhojnë shkollën. Kjo është një hap tejet pozitiv.

Është theksuar në shumë herë se kemi problematika me tekstet shkollore, se përmbajnë, siç e thanë edhe këtu deputetët, ka një jokoherencë, një mospërputhje me kurrikula, ka edhe adresime dhe materiale të gabuara. Por ne nuk kemi mundur që menjëherë për një kohë të shkurtër t'i ndryshojmë tekstet shkollore. Tani jemi në fazën finale të një pjese të madhe të teksteve të reja, që ka qenë një proces shumë i rëndësishëm brenda Ministrisë, pavarësisht zhurmës së madhe që bëhet. Por, do të kemi tekste të reja, të cilët nga ekspertët konsiderohen që janë tekste në përputhje me kurrikulën. Pra, kjo është hapi tjetër i cili është bërë në pjesën e arsimit parauniversitar.

Nëse flasim te pjesa e parashkollorëve, e cila po bëhet vërtet një zhurmë e madhe. E para, kemi një kornizë kurrikulare të moshës 0-5, e cila pesë vjet ka qëndruar në sirtar. Asnjëherë nuk është finalizuar. Sot e kemi në diskutim publik dhe është para finalizimit dhe në shator Korniza Kurrikulare për moshat 0-5 do të jetë e gatshme. Po kemi kritika për rritjen e pjesëmarrjes në edukimin e hershëm. Kjo nuk mund të bëhet as për një vit, as për një vit e gjysmë, ndoshta as për pesë vjet nuk mund të bëhet. Mund të bëhet vetëm në një moment, nëse ju si deputetë dhe Parlamenti i Kosovës dhe Qeveria vendos që të ndajë një fond shumë të madh dhe të veçantë për të ndërtuar çerdhe publike. Ndryshe është e pamundur që të kemi një ngritje të përqindjes së pjesëmarrjes së edukimit të hershëm, sidomos të moshës 0-3 vjeçare. Mirëpo, ne kemi bërë hapa të nevojshëm, sepse aktualisht kur po flasim, janë duke u ndërtuar 10 çerdhe publike. Pra është një ndërtim shumë më i madh që ka ekzistuar ndonjëherë në një periudhë kaq të shkurtër. Shtu kësaj, ne kemi paraqitur si politikë të re për kthimin e shkollave, të cilat për shkak të rënies së numrit të nxënësve po braktisen, t'i shndërrojmë në çerdhe dhe që po presim që ta miraton buxhetin Qeveria. Nuk ka kaluar në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve....

**KRYESUESI:** Faleminderit! Edhe një minutë!

**MINISTRI SHYQYRI BYTYQI:** Kemi shumë politika të reja të cilat ne i kemi ngritur si Ministri e Arsimit, por që fatkeqësisht nuk kanë zënë mirëkuptim në buxhetin e Kosovës. Pra, ju jeni deputetë që mund të ndikoni pozitivisht në të gjitha politikat e reja, përfshirë edhe çështjen e mësimdhënësve të cilët kanë probleme me sëmundje shëndetësore, edhe çështjen e kujdestarisë, edhe çështjen e praktikantëve, edhe çështjen e asistentëve, që për herë të parë ne në vitin 2019 kemi përgatitur dhe kemi 100 asistentë për fëmijë me nevoja të veçanta, që do të jenë të punësuar në shkollë. Faleminderit shumë!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Luljeta, dy minuta, pastaj Arbëri.

**LULJETA VESELAJ-GUTAJ:** Nënkrjetar!

Pas replikës së znj. Balaj-Halimaj, edhe ndërtimin e çerdheve apo kopshteve publike në qytetin e Prizrenit, unë dua t'ju rikujtoj se dy çerdhe publike të cilat po ndërtohen njëra nga komuna dhe njëra nga Ministria, janë kapitalizim i projekteve të Partisë Demokratike nga mandati i kaluar.

E dyta, zoti ministër, Komisioni për Strategjinë e Arsimit të Lartë që ju e keni themeluar është i jashtëligjshëm. Këtë e kemi parë edhe nga shkresat të cilat i kanë dërguar zyrtarët nga Ministria e Arsimit.

**KRYESUESI:** Arbër Rexhaj, dy minutë replikë. Pasta ministri pas replikave.

ARBËR REXHAJ: Në fakt, nuk do të doja të replikoja, por po të mos flisja në këtë rast, do të dilja hipokrit edhe nuk dëshiroj që të ndodhë ashtu.

Ministri këtu është ministër edhe i PDK-së, edhe i Nismës. Pra, është ministër i PAN-it. Prandaj të gjitha kritikantët që iu dhanë këtu, i përfshin të gjitha subjektet politike, se ky ju përfaqëson juve të gjithëve. Kjo është e para.

E dyta, u fol për Prizrenin. Mesa pash Nisma dhe PDK-ja po dëshirojnë të kapitalizojnë pra të arriturat në fushën e arsimit në Prizren, mirëpo jo që po dua ta kapitalizoj tash si Lëvizjes Vetëvendosje, por ky është veçse projekt i Lëvizjes Vetëvendosje.

Ju e dini shumë mirë, sidomos partitë e tjera, që në fushatën parazgjedhore, jo vetëm në Prizren po në të gjitha komunat e Kosovës, ne kemi hyrë me premtimin e hapjeve sa më shumë të çerdheve publike gjithandej Kosovës dhe në veçanti edhe në Prizren.

E sa i përket kapitalizimit të vlerave që po përmend Luljeta Veselaj-Gutaj, unë po ia përmendi vetëm një gjë. Krejt çfarë mund të flasë PDK-ja në Prizren është për arrestimin e ish-drejtorit të Arsimit në Prizren, të zyrtarëve komunalë atje në kohën kur ka qeverisur ajo dhe nuk e di tash për çfarë vlerash mund të flasë për arsimin në Prizren, kur ka pasur arrestime. Unë vetë personalisht kam ngritur disa kallëzime penale, me ç'rast jemi endur pastaj në këtë shtet të kapur nëpër gjykata së bashku me ata zyrtarë. Prandaj, kur kapeni mes vete, kjo tregon se jeni në panik, dhe se zgjedhjet qenkan afër.

KRYESUESI: Faleminderit! Luljeta Gutaj-Veselaj, një minutë kundër-replikë.

LULJETA GUTAJ-VESELAJ: Kuvendi paska punë, se të arriturat po ju pengojnë, të arriturat e PDK-së dhe ndryshimet që i ka bërë rrënjësore në sistemin e arsimit. Nuk thonë që e kemi bërë më të mirën, po nga ajo që ka qenë më e mira e mundshme pas shumë viteve që nuk është investuar fare në arsim, ne kemi bërë ndryshime që mund të them qind për qind.

Ajo çka e tha Arbëri, kallëzimet penale dhe gjëra të tjera, nuk marrim përgjegjësi për personat e caktuar. Ne flasim si Parti Demokratike. Edhe zonja Balaj tha Partia Demokratike ka bërë me këtë, me atë. Nuk ka bërë Partia Demokratike dhe nuk mund të thirresh në emër të Partisë Demokratike për individë të caktuar. Është ligji dhe ata persona të cilët e shkelin ligjin kanë për t'u përgjigjur para ligjit. Ne nuk marrim përgjegjësi për individë të caktuar.

Sa i përket sistemit të arsimit, edhe një herë ta potencoj, më thuaj Arbër kur kanë pasur pagë më të dinjitetshme mësimdhënësit, apo sa u është rritur paga mësimdhënësit nga paslufta deri në vitin 2008?

KRYESUESI: Meqë e pate një pyetje, një minutë Arbër. Kundër-replikë! Pastaj Albulena.

ARBËR REXHAJ: Faleminderit kryesues!

Çështja e rritjes së pagave, ju e keni parë çka i keni bërë buxhetit edhe tash. Keni bërë buxhet të skemave. E keni shtuar hendekun e thellë, ashtu-ashtu që ka qenë mes sektorit privat dhe publik. Pra, mos flisni këtu për rritje të pagave, sepse nuk e keni bërë sipas njëfarë analize dhe kërkese kështu të mirëfilltë të qytetarëve, por e keni bërë sipas premisave elektorale, partiake. Keni pabarazi në shumë komuna, varësisht ju të PAN-it ku udhëhiqni atje.

Pra ju e dini, s'po dua të përmend komuna të caktuara, mirëpo p.sh. Prizrenin e keni privuar shumë keqas në këtë aspekt, vetëm sepse pra nuk e udhëhiqni ju. Prandaj, thirrja në rritje të pagave, normalisht që ne i gëzohemi çdo rritje të pagës, por nuk është e drejtë.

KRYESUESI: Faleminderit. Albulena Balaj-Halimaj, kundër-replikë një minutë.

ALBULENA BALAJ-HALIMAJ: Ne të PAN-it Arbër, jemi bashkë në Prizren dhe të mos manipulohen qytetarët. Drejtorinë e Arsimit e udhëheq Nisma Socialdemokrate në Prizren dhe çdo investim në çerdhe, në shkolla bëhet nga Nisma Socialdemokrate, nga DKA-ja dhe nga Ministria. Dy çerdhe janë investim i Ministrisë dhe tjetra është e DKA-së, Komunës. Pra e ka planifikuar DKA-ja. Ndërsa, Luljetën do të doja ta pyesja në cilin vit i ka planifikuar çerdhet, në 2014-ën e që kurrë nuk janë realizuar apo kur? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ismajl Kurteshi, dy minuta replikë.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit kryesues!

Ministri përveç tjerash tha se është mirë që të informatat t'i marrim në mënyrë zyrtare. Ministër, zyrtarisht i kam shkruar sekretarit tuaj për raportin e znj. Gagica, ka refuzuar ta japë. Të njëjtën gjë e kam kërkuar nga ju, nuk keni ndërmarrë asnjë gjë që ta jepni, kështu që e keni pamundësuar komunikimin zyrtar.

Çështja tjetër. Konstatuat se korrupsioni është brenda universiteteve dhe atje gjenden të gjitha partitë. Ju si ministër çka po ndërmerrni ta luftoni këtë korrupsion, se që janë të gjitha partitë, jo bash të gjitha, po një pjesë e madhe e tyre, kjo veç është e ditur.

Dhe një çështje tjetër, përgjegjësinë për cilësinë në arsim parauniversitar thoni se e kanë komunat. Kjo është vërtet krejt e papranueshme, sepse ju jeni institucioni përgjegjës për arsimin dhe duhet ta ndërroni këtë formë të të menduarit, sepse edhe nëse ligjet ju pengojnë, duhet të

ndërmerrni hapa. Të inicioni plotësim-ndryshimin e ligjit, po nuk mund Ministria të bëjë sehir për çështje që janë thjesht të arsimit.

Edhe në fund. Thatë që ju jeni zotuar kundër depolitizimit. Po, të zotoheni, jeni zotuar, por të veproni, po veproni ndryshe. Keni punësuar njerëz të partisë suaj që s'kanë absolutisht lidhje, as kompetenca për punë. Ju kam thënë disa herë për inspektor që s'e ka as kualifikimin, as përvojën. Keni gjetur zbrazëtira në ligj dhe të tilla keni bërë në shumë raste. Prandaj zotimit përmbajuni dhe mos e dëmtoni arsimin për shkak të klientelizmit partiak që po e bën edhe Nisma, siç e kanë bërë edhe subjektet e tjera përpara, e që arsimin e kanë sjellë në dergjen në të cilën e kemi sot.

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti ministër i keni dy minuta kohë që të përgjigjeni.

**MINISTRI SHYQYRI BYTYQI:** Atëherë po mundohem t'u përgjigjem shumë pyetjeve, por është pyetja shumë e shkurtër.

E para, te z. Kurteshi. Kur iu referova informacioneve zyrtare lidhur me rastin që ju e keni përmendur, nuk ka fare të bëjë që kjo zyrtare asnjëherë nuk ka qenë e ngarkuar për një raport të tillë. Por problematika është në të kaluarën, sepse asnjë veprim nuk është bërë nga ministri i kaluar që shumë universitete nuk kanë dorëzuar libra dhe sot studentët kanë diplomuar dhe ata duan zgjidhje. Ata vijnë sot kërkojnë vërtetimin e diplomave të tyre. Ne jemi duke përgatitur udhëzim administrativ për rregullimin e kësaj çështjeje, e cila do të rregullohet në të mirë të studentëve. Sepse, studentët nuk kanë faj që as Ministria në atë kohë nuk ka vepruar ndaj kolegjeve që kanë qenë të papërgjegjshme, por njëkohësisht edhe kolegjet kanë qenë të papërgjegjshme për dorëzimin e librave të tyre. Dhe kjo ka qenë arsyeja se pse ne kemi thënë që kjo nuk ka të bëjë me një raport zyrtar, por është çështje krejt tjetër.

Për të ndërhyrë brenda universiteteve, z. Kurteshi, ndryshojeni sot statutin në Parlamentin e Kosovës, ne do të ndërhyjmë edhe brenda universiteteve nëse është e nevojshme.

Nuk ka punësim Nisma, asnjë punësim zyrtar nuk e ka bërë. Ka pasur disa angazhime të vogla nga stafi civil, që i takon vetëm stafi civil, e që është Ministria më pak që ka të angazhuar me kontratë mbi vepër.

E nderuara deputete,

Theksuat një raport të Bankës Botërore dhe që po i referoheni një projekti që thuhet që janë humbur miliona. Arsye pse kanë humbur, sepse projekti i Bankës Botërore ka filluar në 2016-ën dhe është dashur të përfundojë në 2018-ën. Në 2016-ën, në 2017-ën, kur ka qenë duke u udhëhequr Ministria nga ish-ministri është realizuar vetëm 5 për qind e projektit dhe kjo ka qenë



arsyeja që Banka Botërore ka kërkuar të rishikohet kjo gjë. Dhe sot ne e kemi ngritur nivelin dhe jemi para negociatave dhe para përfundimit të finalizimit për zgjatjen e këtij projekti të Bankës Botërore.

KRYESUESI: Edhe një minutë ministër!

MINISTRI SHYQYRI BYTYQI: Instituti Pedagogjik ka nënshkruar një marrëveshje joligjore, sepse ka pasur implikime financiare edhe nga ana e buxhetit të Kosovës, dhe çdo marrëveshje që ka implikime financiare nga ana e buxhetit të Kosovës, së pari duhet të merret miratim nga Qeveria e Kosovës, nga Kuvendi dhe pastaj të jetë i zbatueshëm. Ne nuk e kemi pranuar për këtë arsye dhe nuk ka asnjë arsye tjetër nga informacionet që po ju vijnë dhe të cilët njerëzit e juaj janë brenda Ministrisë së Arsimit. Faleminderit shumë!

KRYESUESI: Faleminderit! Ismajl Kurteshi një minutë, pastaj Luljeta një minutë. Po, po e kam parasysht. Ismajl!

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit!

Së pari, ministër, në letrën e znj. Gafioca që ua ka drejtuar ju, Arbër Gecit, Ekrem Kastratit dhe Vatton Dushit, përveç tjerash thotë se: bashkëlidhur me këtë e-mail po jua dërgoj raportin lidhur me gjendjen faktike të librave amzë të bartësve privatë të arsimit të lartë. Dhe në letrën që ma ka kthyer sekretari, e ka refuzuar z. Kastrati. Nuk thotë që s'ka raport. Ai thotë ka raport, po raporti është për nevojën të brendshme, sepse ministri e ka bërë një komision, i cili po e shqyrton raportin. Këtu, ose sekretari nuk është diçka në rregull, ose kjo që po e deklaroni ju nuk është e vërtetë. Po, raport ka. Raportin duhet ta dorëzoni. Këtë kemi për ta kërkuar me çdo kusht ta dorëzoni dhe ju po i fshihni krejt këto maskarallëqet që janë bërë në institucionet private dhe ne dyshojmë se këtu ju jeni pjesë e manipulimeve.

KRYESUESI: Faleminderit! Luljeta Gutaj një minutë, kundër-replikë.

LULJETA VESELAJ-GUTAJ: Zoti ministër,

Nuk është e dinjitetshme t'i mbrosh argumentet të cilat e shkelin ligjin. E para. Ju thash që Komisioni për Strategjinë e Arsimit është i jashtëligjshëm dhe këtë e precizon neni 8 i udhëzimit administrativ për planifikim dhe hartim të dokumenteve dhe planeve të veprimtimit. Thotë se lista gjithmonë duhet të ketë përfshirje të zyrtarëve që merren me arsimin e lartë. Në këtë listë ju nuk e keni përfshirë asnjë person që është zyrtar që merret me çështje të arsimit të lartë.

Sa i përket Bankës Botërore, ju thash që në vitin 2018 përmes një raporti ju kanë njoftuar Banka Botërore që nëse projekti ESIB nuk vazhdon me punë ose nuk kryen punë të mira, do të tërhiqen paratë dhe kjo ka ndodhur, ju ka pritur dhjetë muaj zoti ministër.

KRYESUESI: Faleminderit! Bilall Sherifi dy minuta, replikë!

BILALL SHERIFI: Deputeti Enver Hoti e ka kërkuar fjalën.

KRYESUESI: Bilall, e keni fjalën.

BILALL SHERIFI: Kryesues, unë do ta pres radhën që ta marr fjalën gjatë diskutimit. Replikën e ka kërkuar deputeti Enver Hoti, në emër të Nismës.

KRYESUESI: Urdhëro, Enver! I ke dy minuta.

ENVER HOTI: Faleminderit, kryesues!

Me të vërtetë kur i dëgjojmë këto reagimet e deputetëve këtu kaq të pa baza. Mua më vjen keq, mirëpo shokut Ismajl Kurteshit duhet t'ia kthej një përgjigje.

Nuk kam pritur që zoti Kurteshi apo shoku im i ideologjisë socialdemokrate të futet në vorbullën e një propagande jo ashtu adekuate për punësimin e militantëve sigurisht.

Dëgjoni! Në mandatin e parë kur Vetëvendosje ka qeverisur në Prishtinë, jo që e ka mbushur me militantë, po ka shkuar e i ka marrë edhe në margjina jashtë Komunës së Prishtinës.

E ka udhëhequr drejtorinë e Arsimit në Prishtinë një përfaqësues apo një zyrtar, i cili fare s'ka qenë i Prishtinës, i një komune tjetër, ku mijëra qindra intelektualë që janë më të përgatitur kanë mundur ta udhëheqin më mirë, ta drejtojnë më saktë në Prishtinë, i ka injoruar dhe i ka lënë jashtë.

Shumë e shumë militantë të tjerë të Lëvizjes Vetëvendosje janë punësuar në Komunën e Prishtinës dhe kudo që ka pasur rastin t'i drejtojë. Edhe në ndërmarrjen banesore, edhe tani sigurisht i ka në Prizren dhe sinqerisht nga zoti Kurteshi nuk e kam pritur një reagim të tillë.

Cila ka qenë arsyeja që e ka udhëhequr drejtorinë e Arsimit në një mandat njëra nga koleget tona, e cila është deputet tani dhe cilat janë të arriturat e saj? A mund t'i tregojë ajo vet këtu? Faleminderit!

KRYESUESI: Ismajl Kurteshi, kundër-replikë!

ISMAJL KURTESI: Faleminderit! I nderuar zoti Hoti, krejt ato që i kam thënë do t'i argumentojë me dokumente posa të dalim tash në pauzë, një. E dyta, nëse janë bërë shkelje gjatë qeverisjes të Vetëvendosjes, jam kundër ashtu siç jam kundër shkeljeve që cilado parti i bën.

Unë, shkeljet dhe deformimet nuk i vlerësoj bazuar në autorin, po ato vlerësohen bazuar në efektet që i kanë në shoqëri. Kështu që, unë jam kritik përherë kundër gjërave negative, ndaj kujtdo që i ka bën, dhe jo vetëm Vetëvendosje, po edhe fëmija im.

Kështu që, është mirë të mos i lidhim këto çështje me parti, sepse këto që po i them nuk po i them as për inati të Nismës dhe as për inati të ministrit, po i them gjërat të cilat janë të dëmshme dhe ne bashkërisht duhet t'i luftojmë këto dukuri negative.

KRYESUESI: Ministri e ka fjalën. Dy minuta!

MINISTRI SHYQIRI BYTYQI: Atëherë, zoti Kurtesi vetëm edhe njëherë sa për informacion. Çështja lidhur me mos dorëzimin e librave të kolegjet private, nëse ju keni ndonjë informacion që dikush është i implikuar, ju kisha lutur që menjëherë të shkoni në prokurori dhe ta lajmëroni rastin.

Përndryshe, ne e kemi një komision të ngritur, dhe që në momentin kur është parë kjo parregullsi që ka ekzistuar për pesë vite me radhë, ky komision e ka marrë për obligim, në krye me zëvendësministrin Arbrin, që ta përpilojë një udhëzim administrativ dhe do të dalë me vendime konkrete.

Sapo të jetë i gatshëm udhëzimi administrativ, ne do ta bëjmë publike nëpërmjet mediave dhe nëpërmjet të gjitha mundësive publike sesi do ta trajtojmë këtë çështje.

Ju lutem, nëse ju keni nevojë për sqarimet të detajuara për këtë, ne edhe në Komision Parlamentar për Arsim, ne mund të vijmë dhe t'ua qartësojmë. Përndryshe, nëse ka mendime se ka implikime të kujtdo qoftë, edhe të ministrit për çështjen e kolegjeve private, shkoni drejt në prokurori.

Shikojeni, kërkojeni raportin e Inspektoratit të Arsimit, lidhur me trajtimin e problematikave në kolegjet private dhe kolegjet publike, qoftë në regjistrimin e studentëve përtej asaj që ka qenë i lejuar numri i studentëve për regjistrim.

Janë marrë masa për herë të parë, dhe këtë mund ta shihni në raportin e Inspektoratit dhe mund tua ofrojmë juve në qoftë se jeni të interesuar.

E nderuar deputete, ai është një grup profesional meqë i lejohet ministrit që në çdo moment të krijojë grupe profesionale për të përgatitur një strategji kombëtare, siç është strategjia për arsimin e lartë. Pra, është grup profesional i cili do të japë ide se çfarë strategjie ka nevojë që të ketë Kosova, dhe kjo është në përputhje të plotë me kompetencat që i ka ministri i Arsimit.

KRYESUESI: Faleminderit! Albulena Haxhiu, dy minuta në emër të grupit parlamentar.

ALBULENA HAXHIU: E para, zoti ministër Bytyqi, ju ftoj që të mos talleni me deputetët e Kuvendit e as të mos talleni me qytetarët e Republikës së Kosovës. Pse po e them kështu?

Prej që keni ardhur në krye të Ministrisë së Arsimit, e keni shndërrua Ministrinë e Arsimit në çerdhe të militantëve partiak, dhe për këtë flasin të gjithë. Në anën tjetër e keni shkatërruar sistemin arsimor në Republikën e Kosovës.

Zoti ministër, mos të të shkojë mendja as juve dhe as deputetëve të partisë suaj që të krahasohet me Vetëvendosjen. Nuk mund të na fusni në të njëjtin thes. Më vjen keq! Ndonëse mundoheni me propaganda të llojit më të ulët ta bëni ngjashmërinë ndërmjet Vetëvendosjes dhe juve, e keni shumë gabim bre.

Qytetarët e dinë se kush është Vetëvendosje dhe kush është partia juaj.

Po kërkoni emra, kush janë personat të cilët ju i paskeni punësuar si militantë të Nismës. Kush është ta zëmë, Pajtim Kleçka? Kush është Arianit Krasniqi? Kush është Valdete Prebreza? Kush është Shkurte Gashi? Kush është Valdete Gashi? Kush është Beslinda Hoxha? A është mbesa juaj? Kush është Milot Hyseni? A është djali i motrës së bashkëshortes tënde? Kush Lavdim Rizani? Kush është Dijanë Bytyqi? Kush është Veton Kastrati? Lista është e gjatë zoti ministër.

Dhe për këtë ne jemi njoftuar nga mediat, dhe nga njerëzit e mirë që janë brenda Ministrisë së Arsimit të cilëve ju ua keni mbytur zërin.

Prandaj, ju ftoj që të bëheni të singertë dhe të jepni llogari për të gjitha këto skandale që i keni prodhuar në Ministrinë e Arsimit. Po të kishte prokurori të pavarur, ju s'do të ishit këtu.

A e din se çfarë do të thotë për një shtet, të shkatërrohet arsimi? A jeni të vetëdijshëm për këtë? Por, meqë nuk jeni të vetëdijshëm edhe talleni me neve. Por, ne nuk do t'ju lejojmë. Do t'ju nxjerrim me fakte secilin skandal që ju e keni prodhuar.

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, para se të...Në emër të Nismës kush e do fjalën? Enver, urdhëro! Po ministër, pas atij.

ENVER HOTI: Faleminderit, kryesues!

Me të vërtetë këtu ka edhe aplauzë, se janë disa subjekte që janë të aplauzave ashtu. Në rregull është.

Ne nuk jemi që t'i marrim listat, sepse lista të tilla mund të marrim mjaft në secilin institucion ku udhëheqë edhe Vetëvendosje edhe LDK-ja edhe PDK-ja edhe secila parti.

Secila parti i ka marrë ata militantë dhe i ka punësuar me kontrata të veçanta në emër të shërbimeve të veçanta, por nuk e kemi ndërmend të hyjmë në këtë lojë sepse na vjen keq prej atyre njerëzve atje që edhe këta i kanë punësuar në mënyra të tilla.

Por, edhe njëherë po e ngriti çështjen, është vendosur një drejtoreshë e cila nuk e ka ditur se as ku është shkolla 'Sami Frashëri'. Ka marrë detyrë, funksion për ta drejtuar dhe për ta përmirësuar gjendjen në arsim në kryeqendrën e Kosovës.

A ka ndonjë arsye dhe a ka ndonjë shpjegim kjo çështje? E shumë e shumë të tjera.

Ndërsa, për transparencë do t'ju lusja pyetni ndonjë zëdhënës ose ndonjë deputet që ka qenë në qeverinë e parë të Vetëvendosjes në Prishtinë, pyetni gazetarët...

KRYESUESI: Faleminderit! Albulena Haxhiu, kundër-replikë!

ALBULENA HAXHIU: Pa dyshim që nuk mund të flitni me letra, sepse krejt këtë shpifje që e bëni, e bëni për qëllime të caktuara dhe për këtë jemi në dijeni.

Çfarë po dua të them me këtë, është që logjikën e tillë abuzive, përveçse e keni bërë me Ministrinë e Arsimit dhe me ministrinë tjera, e keni bërë edhe në Malishevë.

A e dini çfarë keni bërë në Malishevë? Mua shumë shpesh me bie që të shkoj në Malishevë, e keni shkatërruar. I keni shkatërruar shkollat në Malishevë me njerëz partiakë dhe të padijshëm.

Përveç që kanë qenë partiak edhe të padijshëm, pastaj tendencën e njëjtë jeni munduar që ta bëni edhe në Komunën e Prizrenit, por s'ia keni dalë, ngase u janë anuluar disa konkurse.

Prandaj, edhe njëherë ju ftoj që t'i ndalni këto abuzime me arsimin, sepse kjo qasje po i detyron të rinjtë tanë që ta lëshojnë Kosovën, që të kërkojnë jetë më të mirë në një vend tjetër.

KRYESUESI: Faleminderit! Ministri e ka fjalën. Urdhëro, zoti ministër!

MINISTRI SHYQIRI BYTYQI: E nderuar deputete,

E para, edukimi dhe kultura ime nuk më lënë që të tallet me askënd. Edhe me personin më të ulët ose më i vogli që mund të jetë fëmija, nuk ma lë kultura që të tallem me të.

Ndërsa, qasja juaj nuk ia vlen as me u tall, formën sesi po i drejtohesh një ministri. Megjithatë, mund të them që mos u shërbe me dezinformata. Nëse je deputete, merr informata të sakta.

Merre saktësisht që këta dy persona që i përmende si familjarë të mi, a janë të punësuar në Ministrinë e Arsimit.

Unë e di që ne kemi pasur sulme të gjithanshme, sepse kemi bërë veprime të cilat nuk janë bërë asnjëherë në sistemin arsimor dhe ne kemi qenë të vetëdijshëm që do të kemi sulme të tilla.

Por, do t'ju lusja që kur të deklaroni diçka publikisht, merrni informacionin më të saktë dhe pastaj konsideroje secila është tallja. Tallja që ne po tentojmë të bëjmë diçka apo tallja juaj që merrni informacione apo dezinformacione.

KRYESUESI: Faleminderit! Punën do ta vazhdojmë në orën 15:00.

\* \* \*

*Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës*  
*Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.*

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë,  
Jemi në vazhdimin e seancës. Adem Mikullovc i ka fjalën.

ADEM MIKULLOVCI: Ju faleminderit!

KRYETARI: Arbër Rexhaj, urdhëro!

ADEM MIKULLOVCI: Ju faleminderit! Po, zoti kryetar diçka duhet të bëhet me këta deputetë. Kësisoj, asnjë seancë nuk po mund t vazhdojmë. Dy orë prita, badihava!

KRYETARI: Arbër Rexhaj e ka fjalën. Urdhëro, zoti Mikullovc i Regjia, zotëri Mikullovc i fjalën.

ADEM MIKULLOVCI: Më fal, po më duhet të flas, se jam përgatitur që të diskutoj.

Asokohe kur Serbia na i mbylli shkollat, na i përzuri nxënësit dhe profesorët nga shkollat, ne i hapëm, i bëmë shtëpitë shkolla. Shkollimi u bë nëpër shtëpia, dhe u gëzua shumë një grumbull aktorësh në teatër që ia kthyem Serbisë, nuk lejuam që Serbia ta mbyll arsimin e fëmijëve tanë.

Mes nesh ishte Anton Çetta i cili na tha se është një proces shumë i keq. Ne u çuditëm dhe i thamë; pse profesor? Pasojat e këtij shkollimi, tha, do të jenë më vonë mjaft të rrezikshme dhe të këqija.

Do të dalin quadro gjysmë të arsimuara. Pa kualitet. Do të humbë cilësia, do të humbë kualiteti. Ne nuk e morëm fort seriozisht, por ai na tha, paramendojeni kur pas disa vitesh, këta fëmijë, tani që po arsimohen në këtë mënyrë nëpër shtëpia, ku i zoti i shtëpisë është drejtor i shkollës, i zënë postet dhe marrin vendet vendimtare, ku merren vendime shumë të rëndësishme për arsimin e Kosovës, këta do të jenë në krye të vendit.

Po më vjen keq, por po më duket se ajo kohë ka ardhur tani.

Shekspiri thotë në një vend, kur vijnë të këqijat nuk vijnë një nga një, po vijnë në taborë. E tabori i të këqijave në arsimin tonë i ra partisë të zotërisë, i cili më përqeshi kur duartrokita unë.

Do të kemi shumë punë. Janë duke na dëmtuar me pasoja shumë të rënda dhe duhet të angazhohemi të gjithë, i madh e i vogël, dhe t'i bindim këta njerëz, t'i heqim këta njerëz të cilët

mendojnë se marrja e postit është privilegj. Nuk është privilegj, por është përgjegjësi. Përgjegjësi shumë e madhe. Ju faleminderit! Kaq kisha.

KRYETARI: Arbër Rexhaj e ka fjalën.

ARBËR REXHAJ: Të dashur e të nderuar qytetarë,  
Sot, por edhe në të kaluarën, arsimit nga Qeveria, rrjedhimisht edhe nga ministra, por edhe drejtoritë komunale, është parë si çerdhe e punësimit të militantëve, mundësi përfitimi partiak dhe kurrë si shtyllë institucionale e shpirtit të Republikës sonë.

Nëpër forumet e partive politike, nuk ka diskutim për arsimin edhe kur ka, është i mangët, pos që i kemi bërë ne me dhjetëra konferenca e diskutime për këtë.

Në këto forume partish, diskutohen se kush është në rend për t'u punësuar sipas kalkulimeve elektorale dhe ndarjeve në nëndegë të subjekteve politike. Ndërsa, në të vërtetë arsimit do duhej të ishte krenaria, emancipimi i shpirtit të popullit tonë, si dhe investimi parësor e kryesor yni.

Të dashur qytetarë,

Ne, sot, por edhe në të kaluarën, kemi pasur dhe kemi një sistem arsimor i cili është duke u kalbur nga mosdija e zvatësve, keqpërdoruesve të cilët veç ndërrohen dhe jo kot jemi vendi i fundit në PISA.

Me këtë mendësi partiake, fëmijët tanë do t'i dërgojmë drejt humnerës dhe errësirave të mosdijes.

Ne kemi mungesë të thellë të bibliotekave shkollore për nxënësit dhe mësuesit. Edhe aty ku ka biblioteka ka pak libra. Edhe kur ka tekste e libra, janë jocalësore. Tekstet i kemi përplot me gabime të natyrës gjuhësore, përmbajtjesore, të saktësisë, të strukturës e tjerë.

Për ta ilustruar situatën në arsim, po dua të ndalem në disa të dhëna nga terreni në komunat tona, respektivisht në komunat e Republikës së Kosovës e veçanërisht në ato që janë jashtë vëmendjes dhe njoftimeve të lajmeve qendrore, por fatkeqësisht edhe komplet janë jashtë.

Në Komunën e Vitisë, emërimi i drejtorëve kryekëput politik, pa merita edhe emërimi i tyre pa prezantuar planin zhvillimor çka e kanë obligim ligjor. Përzgjedhja e personelit në baza partiake dhe konkurset të kurdisura.

Në gjimnazin "Kuvendi i Lezhës", nuk ka kabinete të gjuhëve, nuk ka sallë të edukimit fizik. Ka shkolla kur ka orë që nuk janë mbajtur më shumë se dy muaj. Në trajnime shkojnë vetëm ata të



cilët janë të afërt me pushtetin. Buxhet jo i mjaftueshëm në shkollat profesionale. Kabinete në gjendje shumë të keqe, sidomos te shkolla “Jonuz Zejnullahu”.

Mungesë laboratorësh të fizikës, kimisë dhe biologjisë. Dezinfektimi edhe pse është paraparë vite me radhë në plan të prokurimit, asnjëherë nuk është bërë. Sipas raportit të drejtorisë së Inspeksionit në 16 mostra të marra nga shkollat e Vitisë, rezulton se 30% e mostrave, rezultojnë si të kontaminuara dhe ka prani të nitriteve dhe nitrateve.

Kontrollet stomatologjike te fëmijët e cikleve të ulëta nuk janë buxhetuar, ato bëhen vetëm ad hoc etj.

Po kaloj në komunën tjetër, në Komunën e Skenderajt. Në Skenderaj janë dy çerdhe, një është në Skenderaj dhe një është në fshatin Banjë nën menaxhimin e komunitetit serb.

Çerdhja në Skenderaj është publike. Ka kushte jo të mira, por edhe në kushte të tilla është privilegj për prindërit që arrin t’i regjistrojnë fëmijët e tyre aty.

Për çerdhen nën menaxhimin e komunitetit serb, nuk dihet asgjë, sepse si në gjithë Kosovën, ato kanë mbetur jashtë relacioneve me institucionet përgjegjëse për arsimin.

Në shkollën e kësaj komune, përtej formës së punësimit që është klientelizëm klasik, ku drejtorët janë anëtarë të PDK-së, problem i vazhdueshëm është mungesa e bibliotekave nëpër shkolla, mungesa e laboratorëve e sallave sportive e të tjera.

Problem më specifik është stërzgjata e punimeve në ndërtimin e disa shkollave. Shembull, gjimnazi i përgjithshëm “Hamëz Jashari”, ka vite punët nuk janë kryer aty. Ndërsa, në shkollën e fshatit Makermal, Zyra Kombëtare e Auditimit, ka gjetur se dyert dhe dritaret e shkollës figurojnë si të ngjitura në letra, por në të vërtetë nuk ishin të vendosura fare. Kjo i bie se operatori i ka marrë paratë, pa i vendosur dyert dhe dritaret fare.

Kalojmë te Komuna e Kastriotit. Komuna e Kastriotit sipas regjistrimit të fundit të popullsisë ka më tepër se 21 000 banorë, ku gjendet vetëm një çerdhe publike me kapacitet të kufizuar me numër maksimalë 150 fëmijë. Aty pranohen kryesisht fëmijët e komunarëve dhe të familjeve të ndërlidhura me ta.

Dy fshatra që numërojnë më tepër se 2 mijë banorë, janë Millosheva dhe Mazgiti, dhe përkundër kërkesave të vazhdueshme për çerdhe publike, një gjë e tillë nuk është marrë parasysh asnjëherë.

Sipas informata që i kemi, institucionet parashkollore, aty ku funksionojnë nuk i kanë kushtet elementare për punë. Problem dhe sfidë është numri i vogël i edukatorëve në raport me numrin e madh të fëmijëve.

Gati në të gjithë Komunën e Kastriotit, ekzistojnë shkollat fillore në të cilat stafi akademik, stafi udhëheqës dhe administrativ, zgjidhen kryesisht nga mesi i militantëve politik të partive në pushtet, e kryesisht partisë që në dy mandate e fundit udhëheq me komunën, pra AAK-në.

Rreth 50% e shkollave organizojnë mësimet deri në klasën e pestë dhe për vazhdimin e klasave vijuese, fëmijëve të shumë fshatrave iu bie që të udhëtojnë me kilometra të tëra në këmbë duke bartur çanta me peshë mbi 10 kilogram.

Kalojmë në Komunë e Fushë Kosovës. Në mungesë e çerdheve publike, numri i madh i nxënësve nëpër klasa nuk ofrohet arsimit parashkollor. Granti i arsimit nuk mund të rritet për shkak të mosregjistrimit të banorëve të rinj. Mesatarja është 29 nxënës për një mësimdhënës.

Mungesa e kabineteve, laboratorëve, sallave të sportit. Mungesa e hapësirave shkollore. Numri i nxënësve nëpër fshatra po bie, ndërsa në qytet ka rritje enorme të numrit të nxënësve.

Drejtorët dhe stafi menaxhues emërohen apo zgjidhen mbi baza partiake. Konkursët manipulohen, ka favorizime. Edhe pse në qytet është duke u ndërtuar një shkollë, ajo nuk i plotëson kushtet elementare të një shkolle, por as kërkesën për hapësira shkollore. Nuk ka oborr fare dhe duhet të dilet drejt në rrugë.

Mosfunksionalizimi dhe ridestinimi i objekteve të çerdheve në qytet dhe në fshatra. Në shator nuk është paraparë punësimi i mësimdhënësve të cilët do të punësohen në vend të atyre që do të pensionohen.

Kalojmë në Komunën e Sharrit. Ekziston vetëm një çerdhe në komunë, por ajo ekziston vetëm fizikisht, pra si objekt. Në këtë çerdhe nuk zhvillohet proces edukativo-mësimor. Është jofunksionale që tri vite, ani pse për të janë harxhuar qindra e mijëra euro.

Nga 185 mësimore sa ka viti në shkollat e kësaj komune, realizohet vetëm një vizitë. Sigurisht, kjo ndodh me rastin e krenimit të një dite specifike që bëhet në objektet shkollore. Pamundësia për ta vënë praktikë kurrikulën e re mësimore.

Si pasojë e mosllogaritjes së ndërsjellë nga udhëheqësit e sektorit arsimor, si dhe punonjësve të këtij dikasteri, orari i mësimor në shumë shkolla nuk respektohet fare.

Ka më shumë se 14 punonjës të nivelit fillorë, të cilët, edhe pse nuk e përmbushin orarin e tyre të plotë akademik, paguhen sikur për orar të plotë.

Në mungesë të kohës, po hyj edhe te Komuna e Deçanit, për ta përfunduar. Në Deçan nuk ka fare çerdhe publike, përveç një çerdheje private, e cila, me sa kemi informacion, funksionin në kushte jo të mira.

Përshtatja e kriterëve të konkurseve, kandidatëve, militantëve partiakë. Për shembull, rast konkret, është tash së fundmi në gjimnazin “Vëllezërit Frashëri”, ku konkursi i orkestruar dhe rezultatet që nuk përputhen me asnjërin nga aktet administrative në fuqi.

Problemi kryesor, është niveli shumë i ulët i përgatitjes profesionale të stafit mësimdhënës, nga parashkollor e deri te ia në gjimnaz. Është fenomen i përhapur në shkollat e Deçanit, mësimdhënia në lëndë apo fusha për të cilat nuk e kanë shkollimin adekuat.

Prandaj, edhe pse shumë vonë, politikat arsimore duhet të jenë zhvillimore. Partitë politike që udhëheqin nëpër komuna, duhet ta shohin arsimin si sistem që duhet të shërohet e të pastaj të ndërtohet. Ata duhet të heqin dorë nga kapja e sistemit arsimor. Rëndom, kapja gjithandej e sistemeve të shtetit.

Ju nuk mund ta bëni këtë, sepse nuk mund ta shërojnë ata të cilët e kanë katandisur në këtë formë arsimin. Nevojitet mendësi e re për këtë arsye lëshoni rrugë për ata që dinë.

*(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Kujtim Shala.)*

**KRYESUESI:** Faleminderit! Radhën e ka deputetja, Teuta Haxhiu.

**TEUTA HAXHIU:** Faleminderit, nënkryetar!

Fillimisht e di që baca Adem është lodhur dhe e falënderoj që është më i rregull se të tjerët, mirëpo baca Adem krejt vetëm ishe, për atë erdha të bashkohem këtu, po të erdhën edhe disa kolegë, edhe pse është thirrur seanca nga ju.

Megjithatë, që në fillim në fjalën time thashë që arsimi është përgjegjësi e secilit, pa hequr përgjegjësinë e secilit brenda institucioni, qoftë të nivelit lokal apo qendror. Por, për të treguar një shembull më të keqin të punësimeve në arsim ka qenë Komuna e Prishtinës, e udhëhequr nga Vetëvendosja, e cila edhe sot e kësaj dite e ka një ekip profesionistësh që bie në kundërshtim me Udhëzimin administrativ për përzgjedhjen e mësimdhënësve, është e vetmja prej komunave në Kosovë që ka rënë ndesh me udhëzimet administrative dhe në këtë rast ka treguar shembullin më të keq të punësimeve, duke marrë njerëz joprofesionistë, të cilët edhe janë ankuar, por s’ka pasur asnjë përgjigje dhe asnjë përgjegjësi e marrë nga kushdo qoftë.

Tanimë nëse duam kështu, sikurse po flasim sot sa për të dalë në televizor, por nëse duam të japim një mesazh të mirë, unë në fillim e thashë, ne mund të bëjmë rezoluta të përditshme, por në qoftë se nuk ndalemi në pikat e rezolutave për të shikuar se sa po zbatohen ato dhe për të kërkuar përgjegjësi nga secili, atëherë ne nuk po bëjmë asgjë më shumë se sa për poenë politikë.

Shembujt më të këqij të punësimeve partiake, kudo qofshin ato, pa u përjashtuar, nuk janë të mira nga cilado komunë. Normalisht që Aleanca udhëheq me shtatë komuna dhe nuk është njëjtë si me një, si me shtatë.

Dhe, shembulli që ka qenë në Prishtinë dhe shembulli tanimë që është në Prizren, nuk është më i miri i mundshëm, po përkundrazi, unë ju ftoj të shkoni e t'i pyetni qytetarët, edhe të komunës së Prizrenit atje, po edhe qytetarët që jetojnë në Prishtinë se vërtet a janë punësuar njerëz meritore ata që kanë qenë më meritoret, më profesionistët, por ka ndodhur krejt e kundërta. Po flas sidomos një vit pas marrjes së pushtetit në Prishtinë.

Nëse duam të nxjerrim konkluzione që nuk është arsimi në nivelin çfarë e duam, pa hequr përgjegjësinë të asnjë qeverie, po, prej arsimit prauniversitar deri në atë universitar.

Një çështje që është me rëndësi dhe duhet ditur dhe të na tregojë edhe ministri është raporti i Auditorit të Përgjithshëm, i cili thotë që në Universitetin e Prishtinës janë së paku tetë mësimitdhënës profesorë universitarë, të cilët janë të angazhuar në punë sekondare që nuk e kanë deklaruar punën sekondare, që bie ndesh me Rregulloren brenda universitetit. Ky është një fakt, por e përmend Ministrinë e Arsimit dhe unë kisha dashur të di, ministër, a jeni në dijeni që janë disa punëtorë brenda Ministrisë së Arsimit që janë të angazhuar te ju që e kanë quajtur punë sekondare, të cilën nuk e kanë deklaruar. Pra, po flasim për tetë pozita, tetë profesorë dhe atëherë ankesat e studentëve, të cilët shumicën e ligjëratave i mbajnë me asistentë.

Pra, po e tregoj në raportin e Auditorit të Përgjithshëm është e cituar që në kundërshtim me Rregulloren për të ardhurat personale të personelit akademik, numër 2/486 e datës 11 shtator 2017, neni 6 përcakton se personeli akademik në marrëdhënie të rregullt pune brenda Universitetit të Prishtinës mund të angazhohet me honorar në institucione të tjera, pas që më parë të ketë marrë pëlqimin nga dekani dhe miratimin nga rektori i universitetit.

Pra, tetë raste ku profesorët kanë deklaruar marrëdhënie të rregullt pune brenda UP-së, njëkohësisht janë të angazhuar me punë sekondare në institucione të tjera publike, si në Ministrinë e Arsimit, Shkencës e Teknologjisë, për këtë normalisht se pa marrë as miratimin paraprak nga rektori. Por, a jeni në dijeni se cilët janë ata, megjithëse ata thjesht nuk e paskan pyetur as rektorin, pa dijeninë e tij, po të paktën ministria e di cilët janë ata.

Pra, edhe një herë po ju them që s'kemi çka të lavdërohem, kisha dashur të shoh një shembull të mirë të një menaxhimi të mirë, po shembulli më i keq, edhe një herë po i kthehem, ka qenë me kohën e Vetëvendosjes në Prishtinë.

**KRYESUESI:** Replikë në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, Arbër Rexhaj.

**ARBËR REXHAJ:** Unë po dua pak t'ia përmend deputetes së AAK-së, sepse nuk munda më herët, veç po e përmend Deçanin. Sepse pajtohem me Albulenën, nuk po dua t'i hyj asaj që këta po dëshirojnë ta njoftosin edhe Lëvizjen Vetëvendosje dhe ta bëjnë rëndomë si krejt subjektet e tjera politike.

Në Deçan nuk ka fare çerdhe publike, përveç një çerdheje private, e cila me sa kemi informacion, funksion në kushte jo të mira.

Përshtatja e kriterëve të konkurseve të kandidatëve, militantëve partiakë. Për shembull, rast konkret e përmenda një shkollë atje, "Vëllezërit Frashëri".

Problemi kryesor është niveli shumë i ulët i përgatitjes profesionale të stafit mësimdhënës nga parashkollor e deri te ai në gjimnaz. Është fenomen i përhapur dhe kjo më nuk ka nevojë të bëhet shumë publike, sepse të gjithë qytetarët e Deçanit e dinë se në shkollat e Deçanit ka mësimdhënës në lëndë a fusha për të cilat nuk e kanë shkollimin adekuat.

Edhe unë po dua të di që 15 vjet e drejtojnë këtë komunë, të cilën e voton AAK-ja tradicionalisht, ja një konceptim të asaj se çfarë kanë bërë për arsimin dhe ku e kanë kryeministrin e Republikës së Kosovës, pse nuk gjendet këtu për të diskutuar me ministrin e vetë të Arsimit, sepse është ministër i tij dhe këta deputetë këtu e replikojnë, ndërsa kryeministri nuk është prezent për t'u marrë me ministrin e vet, pra me ministrin e Arsimit.

**KRYESUESI:** Faleminderit! Teuta Haxhiu, kundër-replikë.

**TEUTA HAXHIU:** Agjendat e kryeministrit nuk janë të jashtëzakonshme, sikurse jeni ju të jashtëzakonshëm. Pikërisht e tha Arbëri atë që e thashë.

Përshtatja e kriterëve të konkurseve të kandidatëve, po jo të përgatitur profesionalisht, ka ndodhur si shembulli më i keq në komunën e Prishtinës, pra kjo është faktike dhe në kundërshtim me Udhëzimin administrativ që Arbëri mund të mos jetë në dijeni, për përzgjedhjen e mësimdhënësve. Është në kundërshtim, plus gjatë asaj kohe po të njëjtit udhëheqës të departamenteve kanë qenë edhe ligjërues në qendrat e kompetencës, duke i lënë në mungesë edhe kandidatët atje. Pra, edhe një herë, shembulli më i keq për përshtatjen e kriterëve

konkurrentëve joprofesionistë ka qenë komuna e Prishtinës, një vit në kohën pasi ka dhënë dorëheqje zoti Thaçi, për shkak se po të kishte shkuar qysh duhet, nuk ishte vendosur ai...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Faton Topalli.

FATON TOPALLI: I nderuar kryesues,

Të nderuara kolege,

Të nderuar kolegë

Po sot kemi një debat të rëndësishëm parlamentar sa i përket gjendjes në arsim.

I dëgjova me kujdes të gjitha fjalimet që ishin deri më tani dhe mjerisht nuk pati ndonjë përshkrim, nuk pati ndonjë kërkesë konkrete, përveç akuzave për sistemin arsimor, përshkrimin të gjendjes, e cila besoj që për shumicën e qytetarëve të Republikës së Kosovës është e njohur dhe nuk po sjell deri më tani asgjë të re, asgjë konkrete.

Kam menduar gjatë si ta filloj këtë debat dhe mund të them që po, për mua ka qenë bukur e vështirë të përgatitem për debatin, për arsye se tema me të cilin është ftuar ky debat, tema e arsimit, është një det me pyetje, me tema, të cilat do të diskutohen në një forum, i cili nuk është forum i ekspertëve të arsimit dhe nuk e kam atë shpresën më të vogël që pas përfundimit të këtij debati, ashtu siç edhe pas përfundimit të shumë debateve të tjera, nuk u soll asgjë e re, përveç një rezolutë e për këtë debat nuk kemi asnjë rezolutë.

Prandaj, mendoj që për secilin prej nesh, së paku për mua ka qenë shumë vështirë të përgatitem.

Nuk e di nëse duhet të flasim për gjendjen fizike të shkollave tona, për kushte të mësimit, për bibliotekat, për ngrohjen, për sallat e kimisë, kabinetet e për çështje të tjera të cilat kanë të bëjnë me kushtet në shkollë, por menjëherë pas kësaj a duhet të flasim ndoshta për nivelin e arsimtarëve që ligjërojnë në këto shkolla, ndoshta do të flasim edhe testet shkollore, të cilat ne i kemi e të cilat i kritikojmë shumë, ndoshta do të flasim edhe për korrupsionin, e cila është gjithashtu një temë e cila ka të bëjë me arsimin, për arsye se për vite me radhë librat publikohen gjithmonë në të njëjtin vend, mund të flasim edhe për universitetin dhe kuadrot, të cilat është duke i përgatitur ky universitet e një mijë tema të tjera, të cilat kapin fushën e arsimit po që në fakt me këtë nuk do të mund të ndryshojmë asgjë.

Nëse më lejoni shkurtimisht, dua të flas për tri qëllime kryesore, të cilat i ka arsimit, e njëri prej këtyre qëllimeve është ndërmjetësimi i vlerave themelore të shoqërisë, respektivisht reproduktimi i tyre.

Unë jua kisha shtruar një pyetje gjithë juve që të mendoni gjatë kësaj fjalës time. Cilat janë 3-4 vlerat kryesore, të cilat duhej t'i ndërmjetësoni shkollat tona, cilat vlera? Unë besoj që do të kishim mendime shumë të ndryshme, sepse shkollat tona, sistemi ynë arsimor, por edhe ne si deputetë, si shoqëri, nuk është se jemi përcaktuar për vlera të caktuara dhe dëshirojmë t'i reprodukojmë ato vlera.

Pra, ky qëllim, reproduktimi i vlerave që ne i kemi si shoqëri përmes shkollës, nuk bëhet, këtë funksion nuk e kryen shkolla jonë.

Një funksion tjetër, pra i dyti me radhë që kanë shkollat është kualifikimi, pra ndërmjetësimi i dijes dhe aftësive për të ushtruar profesione të ndryshme.

Edhe në lidhje me këtë për të treguar që shkollat tona nuk e kryejnë këtë funksion, do t'ju kisha lutur edhe juve, edhe qytetarët, ndoshta edhe ekonomistët, ndërmarrjet ekonomike, më thoni cila, ma thoni një shkollë në Kosovë, e cila nxjerr kuadro, të cilat menjëherë pas përfundimit të shkollës janë në gjendje të punojnë në vendin e punës. Pra, nuk kemi të tilla dhe nëse kemi, kemi shumë pak dhe nëse kemi, kemi vetëm pak individë. Pra, kushtin e dytë themelor për të krijuar kuadro profesionale, shkollat tona nuk e kryejnë.

Qëllimi tjetër i shkollave është që përmes provimeve të ndryshme të përcaktojnë nxënësit në bazë të nivelit të tyre, se cilat shkolla mund t'i përfundojnë ata. Pra, dikush që nuk di matematikën, nuk mund të bëhet inxhinier, po dikush që di matematikën, mund të bëhet muzikantë i shkëlqyer.

Kështu që edhe funksionin e tretë, të cilin e kanë shkollat tona, nuk arrijnë të realizojnë.

Pra, shkollat tona nuk po i kryejnë këto funksione dhe po prodhojnë thjesht letra pa vlerë. Pra, letrat pa vlerë janë diploma, diploma që kanë një çmim shumë të lartë për një vlerë shumë të ulët funksionale.

Megjithatë, ekziston një kryetar i një komune të vogël në Republikën e Kosovës, e ky është Qëndrim Kastrati, ka filluar një debat joatraktiv, por produktiv për shoqërinë, një debat për reformën për arsim në komunën e tij.

Qëndrim Kastrati nuk kishte mundësinë që ta inicioje këtë debat në Kuvendin e Republikës së Kosovës, as ta detyronte Qeverinë të fillonte një reformë të tillë.

Ai e filloi aty ku kishte mundësinë, në komunën e vogël të Kamenicës, i bindur dhe i vetëdijshëm që kundërshtarët kryesorë do t'i ketë ata që duan godina shkollash, madje shkollave të mëdha pa nxënës, po jo me arsim kualitativ.

I bindur që do ta sulmojnë më së shumti ata që nuk e duan arsimin, ata që duan letrat pa vlerë, pra diploma për vlerë, pa dijë e pa aftësi

Qëndron Kastrati e bëri të ditur që klasa e vogël me nga një nxënës, dy, tre, katër apo pesë nxënës, pra këto klasë kanë kuptim dhe ndihmojnë në zhvillimin e fëmijëve me nevoja të veçanta, por janë kontraproduktive për fëmijët me aftësi normale.

Ato, pra, klasë të vogla, e kthejnë shkollën në një vend monoton, në një vend ku mungon mundësia për t'u gëzuar dhe për t'u hidhëruar, për të mësuar për t'i zgjidhur konfliktet, për të pasur afër vetes një shok apo një shoqe, të cilës ia qan hallin, për t'u mësuar me konkurrencën, për të mësuar prej njëri-tjetrit, për ta provuar dhe përballuar hidhërimin, për të kënduar dhe vallëzuar së bashku, për t'i këmbyer me njëri-tjetrin të arriturat në mësim, për ta pasur njëri-tjetrin si model, për t'u angazhuar dhe për t'u zhvilluar fizikisht.

Qëndron Kastrati u tregua i guximshëm dhe guxoi të thoshte se kemi mësimdhënës që nuk e dinë mirë as shkrimin, as leximin. Që arsimtari i muzikës jep matematikë, dhe ndoshta që ai i fizikës jep muzikë, e ky i artit kimi. Nuk e tha bash kështu, por kjo është praktika në disa shkolla të Kosovës.

Qëndron Kastrati krijoi një task-forcë për të filluar reformën, një hap shumë i madh për një kryetar të një komune të vogël.

Unë uroj, edhe pse pak shpresoj që Kuvendi i Republikës së Kosovës, në këtë debat do të nxjerrë ndonjë vendim, i cili pastaj do ta ndryshojë gjendjen në arsim.

E pashë që i jeni gjuajtur ministrit të Arsimit, i takon opozitës ta kritikojë ministrin e Arsimit, po ky është ministri i fundit prej shumë ministrave që kanë qenë deri tani dhe që e kanë sjellë sistemin arsimor sot ku jemi këtu.

Edhe ky ministër, po qoftë edhe një ministër tjetër që vjen pas tij, pa një analizë të gjendjes në arsim, pa krijuar një komitet, çfarëdo quani, një komision të përbashkët, ku angazhohen të gjithë faktorët relevantë, së pari për ta studiuar gjendjen në të cilën jemi, për të përcaktuar cilat janë ndryshimet, të cilat ne i dëshirojmë t'i arrijmë në arsim, nuk do të ketë asgjë, nuk do të ketë asnjë ndryshim, do të vazhdoj kështu padituria, Kosova do të vazhdojë të prodhojë kuadro, të cilat nuk janë në gjendje të konkurrojnë me kuadrot që zhvillohen në vendet e tjera.

Pra, e kemi një gjendje jashtëzakonisht të vështirë, po për të dalë nga kjo gjendje duhet të ulem të gjithë bashkërisht, ta bëjmë një analizë të përbashkët, të gjithë faktorët relevantë dhe tek pas një analize, të vendosim si dëshirojmë ta kemi arsimin, si do të zhvillohet kjo reformë dhe nuk do të presim që reforma për arsim të kryhet brenda një viti, dy apo tre vjetësh, por ne duhet të



angazhohemi që të krijojmë një reformë, e cila i parasheh ndryshimet në arsim në 5, 15 a 20 vjetët e ardhshme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Milaim Zeka.

MILAIM ZEKA: Faleminderit, kryesues!

Sinqerisht po e them si qytetar dhe si deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës, se janë dy gjëra për të cilat sot çdo njeri normal në këtë vend ndihet i turpëruar.

E para, ndihet i turpëruar çdo njeri të thotë që kam qenë i burgosur politik dhe kam qenë pjesëtar i luftës.

Dhe, e dyta, ndihemi shumë të turpëruar të tregojmë sa shkollë kemi kryer.

Kur u bë gjithkush me diplomë të doktoratës, vaj halli për këtë vend!

Më tha një plak i urtë intelektual në Prishtinë: “A do të bësh parti me njerëz të shkolluar, a me njerëz të mençur?”

I thashë partia bëhet me njerëz të mençur, sepse me ata doktorë shkencash, të cilët japin sot mësim nëpër kolegje e nëpër universitete, sinqerisht pjesa dërmuese e tyre na bëjnë të turpërohem.

Nuk mund të jesh patriot dhe hajn! Nuk mund të jesh intelektual dhe hajn! Nuk mund të jesh intelektual kur t’i jep mësim në pesë universitete dhe kurrë nuk shkon nëpër ligjërata! Dhe këtë, zoti ministër, e bëjnë mësimdhënësit e Republikës së Kosovës, sepse ka profesorë doktorë sot në Republikën e Kosovës i merr 12 rroga, kjo e para.

E dyta, po nisemi te mjekësia që është pjesa më e rëndësishme e shoqërisë. Vajza ime ka diplomuar këto ditë në mjekësi, MEKDANS, dhe unë i thashë, e shyqyr, u bëre mjeke. A e dini çka më tha, se këtu kemi qe profesorin le të ma demantojë, ky e di më mirë, mund ta dokumentojë fjalën që po e them unë, tha “unë, babë, edhe 10 vjet nuk dal mjeke përnjëmend”. Pse: “6 vjet fakulteti, 2-3 vjet më duhet të shkoj ta mbaroj praktikën e përgjithshme në spital, pastaj duhet shkuar në doktoratë 6 deri 8 vjet”, a është kështu, Imet, apo jo? Në kushte normale?

Të nderuar qytetarë të Kosovës, dhe ju deputetë,

A e dini që spitali i përgjithshëm, Klinika Universitare në Prishtinë, prej 7 mjekëve të zemrës, kirurgëve, që ta prenë zemrën, ta qesin në tavolinë, prej 7-ve vetëm 3 kanë diplomë adekuate, vetëm 3, 4 s’kanë fare. Qysh ne nuk alarmohemi kur sot kemi vdekshmërinë e pacientëve 26% dhe, me vdekshmërinë 26% në Gjenevë, në Londër ose në Berlin ta mbyllin klinikën. Policia i nis hetimet. Te ne nuk ndodh kurrëgjë, si ka mundësi që asnjë pacient nga Maqedonia e vockël

nuk vjen në Prishtinë ose nga Mali i Zi, por pacientët tonë shkojnë atje? Ne kemi pacientë që janë trajtuar një vit gjoja me tuberkuloz, ata kanë pasur kancer, imagjino, gabimi më fatal bëhet këtu në dhënien e diagnozës.

Sa i përket PISA-s që u përmend këtu, po të bëjë vaki të na fusin në PISA neve këtu në Parlament, jo 'pisa', po pista a pisa, domethënë kur njeriu që falsifikon diplomën është pis, ai që është doktor fals, ai është fals, ai që është veteran fals e i rrejshëm, e që s'ka qenë kurrë në luftë, ai është pis, kështu që kjo është Pista, bash Pista, e këtë farë Pistën me na fut këtu neve njëfarë rëntgeni, pak dalim këtu njerëz domethënë që e kalojmë atë provimin e nxënësve të klasës tretë filllore në shkollat tona. Në çfarë gjendje të mjerueshme janë shkollat tona të gjithë e dimë, unë jam i vetmi deputet që krejt fushatën si deputet i pavarur e kam bërë pikërisht te çerdhet, pse? Çerdhet janë bazamenti i ndërtimit të shoqërisë, ama çka të na bëjnë neve se 98% na kanë lidhur në lulak, na kanë prishur trurin në djep, na kanë rrahur me tëhollues, na kanë rrahur me bisht shati, ne nuk e dimë çka është çerdhja, ne nuk reflektojmë dashuri ndaj fëmijëve dhe ndaj njëritjetrit, po ato frustrimet tona të brendshme si fëmijë i nxjerrim në shoqëri, në familje, te shokët tonë, te kolegët tonë, edhe te fëmijët.

Ne e dimë fort mirë se në Kosovë sistemi i arsimit ka mundur të rregullohet komplet duke kërkuar ndihmën e Lidhjes të arsimtarëve nëpër Evropë, qoftë në Suedi, Norvegji, të ndërtojmë një sistem kualitativ edukativ. Nuk është bërë një gjë e tillë, sepse ne nuk jemi duke punuar për shtet, ne jemi duke punuar për parti politike. Shih këtë mjedisin tim këtu, që një deputete tha jo, ju drejtua Vetëvendosjes, tha "e keni thirr këtë seancë", jo ju, se edhe unë e kam nënshkruar thirrjen e kësaj seance, e kam nënshkruar edhe thirrjen e seancës së nesërme për homologimin. Por, shihni këtë rendin këtu, i kemi 4 qeveri, 4 qeveri brenda qeverisë. Qeveria e PDK-së, e AAK-së, e Nismës dhe Qeveria e 6+.

A e patë, dje doli ai Fikrimi atje, i quajti terroristë ata gylenistët, e foli çka iu tek këtu pa kurrfarë kriteri, as s'i ka shpallur gjykata terroristë as kurrëgjë. T'i dëgjosh sot kritikën e mazhorancës, që po i thonë, në gjuhën frëngjishte a italishte, domethënë të shumicës, më shumë e kritikojnë këta ministrin se sa opozita. Dhe, tash kush na sheh neve përmes televizionit, bëjnë hajgare, thonë çka është more duke ndodhur në Parlamentin e Kosovës, në vend se këta ta mbrojnë, secila parti politike këtu që del në foltore të flasë, ta merr mendja se ne asnjë problem nuk e kemi në arsim, që ju i keni rregulluar çështjet e arsimit dhe unë po ju them që krejt këto i kam thënë dhe do t'i ripërsëris 1 milion herë, që 'bërlloghanen' e madhe edhe në arsim, edhe në shëndetësi e ka bërë PDK-ja dhe LDK-ja. Vetëvendosja e ka bërë në Prishtinë, këta e dinë, ashtu i kanë vendosur drejtorët bash qysh thatë këtu, krejt janë drejtorë politikë, krejt çerdhet janë me morra, unë këtu po jetoj, vajza ime prej çerdhes së Prishtinës ka ardhur me plot morra. Po të kishte qenë në Obri, bile e kishin nxjerrë atje në livadh e s'kishte pasur morra. Kështu që nuk kemi bërë ndonjë farë pune të lavdërohem ne shumë, por po kthehem te ministri, dhe pse kemi ardhur sot këtu.

Zoti ministër, deputeti Kurteshi është e vërtetë që ka kërkuar nga sekretari permanent një raport të auditimit të brendshëm, të cilin në shkresën e vet zyrtare nuk ia kanë dhënë deputetit dhe atë raport e ka bërë zonja Kumrije Gagica. Kur Kabineti yt nuk i jep dokumente një deputeti të Parlamentit të Kosovës, çfarë dokumenti mund të nxjerrë një qytetar i thjeshtë, ose një gazetar i Republikës së Kosovës, kjo e para.

E dyta, e keni kurdis këtë vend të gjithë politikanët e mëparshëm që faktikisht, juridikisht nuk mund të kritikojmë. Ministri kurrfarë faji nuk ka juridikisht, sepse këtu fajin kryesor e ka sekretari permanent dhe stafi tjetër, sepse ministri është ministër. Por, vetëm sa për informacion, ju e dini që Kumrija e ka bërë një raport shumë të frikshëm se si janë regjistruar studentët jashtë orarit, pasi ka kaluar afati i regjistrimeve nëpër kolegjet private. Keni hapur universitete publike për vota, mbajeni tash në shpinë degradimin e arsimit. Keni hapur kolegje për vota, mbajeni në shpinë degradimin e arsimit dhe unë po ju them, ka probleme edhe të tjera në ministri. Edhe largimi i zonjës Kumrije Gagica, do të flasim ndonjë seancë tjetër, e ka një domethënie shumë të madhe pse u largua, pse u kthye, kënd e shantazhoi Kumrija me sms-a, cili lider politik i tha gazetarit të Radiotelevizionit të Kosovës “aman, zaman, mos e transmeto kronikën e përgatitur”, cilat skandale kanë pasur të dalin nga Ministria e Arsimit, cili polic nga Inspektorati Policor i Kosovës ka shkuar dhe dhunshëm ka dashur ta nostrifikojë diplomën e vet te Kumrije Gagica, dhe pse nuk ka pranuar Kumrije Gagica t’ia bëjë nostrifikimin e një diplome false. Këto janë pyetjet që po i bëj sot, përgjigjet i jap ndonjë seancë të ardhshme, me emër e mbiemër, nuk jam si Tina që tha Milaim, mos fol me emra, por unë do të flas me emra, sepse për atë shkak jam zgjedhur deputet i këtij vendi.

A pe sheh që m’u harxhua koha se jua kisha kallëzuar edhe emrat, kështu që zoti Ismajl Kurteshi le të ma dokumentojë këtë, a është e vërtetë që keni kërkuar dhe nuk jua kanë dhënë raportin e auditimit. Faleminderit, kryesues!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Ismajl Kurteshi, replikë!

**ISMAJL KURTESHI:** Faleminderit!

E falënderoj edhe deputetin Milaim që ma dha mundësinë ta lexoj një pjesë të përgjigjes së sekretarit Ekrem Kastrati, të dërguar në ditën e mërkurë, më 27 mars të këtij viti, ku përveç tjerash thotë: “Me këtë rast ju njoftojmë se ne kem pranuar raportin dhe kemi themeluar një komision, i cili është i ngritur nga ministri Bytyqi, i cili mbi bazë të kësaj gjendjeje do të dalë me disa rekomandime, të cilat edhe do të mund të ndahen me aktorët relevantë. Raporti i dorëzuar nga zonja Gagica është përgatitur për nevoja të brendshme dhe veçmas për komisionin e ngritur, në mënyrë që ata ta kenë mundësinë të analizojnë atë dhe të dalin me rekomandime dhe si i tillë nuk mund të ndahet me aktorët relevantë jashtë ministrisë”.

Edhe një herë po e përsëris, “si i tillë nuk mund të ndahet me aktorët relevantë jashtë ministrisë”, kërkesa ka qenë e një deputeti të Kuvendit të Kosovës që udhëheq Komisionin e Arsimit dhe nëse, edhe përfaqësuesit e popullit janë më pak të besueshëm se zyrtarët, atëherë vërtet nuk e di kah po shkojmë në këtë vend dhe ajo që dua të konstatoj është se raport ka dorëzuar kjo zonjë dhe unë këtu publikisht po i bëj thirrje ministrit, nëse s’e ka ditur që e ka dorëzuar raportin, raporti ekziston dhe raportin të na e dërgojë në afatin më të shkurtër të mundshëm, sepse po bëni shkelje të rëndë të Ligjit mbi transparencën, për të cilën natyrisht se do të kërkojmë përgjegjësi nëse brenda kësaj jave nuk na e dërgoni raportin.

**KRYESUESI:** Faleminderit! Ministër, dy minuta!

**MINISTRI SHYQIRI BYTYQI:** Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Atëherë edhe një herë po e përsëris, konsideroj që po bëhet zhurmë pa nevojë për një gjest, të cilën nuk është aspak me rëndësi. Kur ta definojmë çështjen se çka do të thotë raport, duhet të dimë definicionin e raportit. Pra, një raport i një ministrie mund të jetë kur dikush është i ngarkuar për ta përgatitur një raport, nëse themi është përgatitur një informacion, jam dakord edhe informacionin mund ta ndajmë, por zoti Kurteshi, edhe një herë po e theksoj, ai komision i cili është formuar për ta vlerësuar gjendjen e kolegjeve private që nuk kanë dorëzuar për disa vjet me radhë regjistrin e studentëve të regjistruar, e që më vonë neve na vijnë studentët për t’i verifikuar diplomat dhe këtë nuk mund ta bëjmë, i takon një periudhe pesëvjeçare të kaluar, për të cilën komisioni akoma nuk e ka përfunduar punën.

Në momentin kur komisioni e përfundon punën, del me rekomandime dhe Udhëzim Administrativ, do të jetë publike për të gjithë, po ashtu edhe për komisionin parlamentar në çdo moment ne mund t’ jua ofrojmë. Nëse ju e quani të rëndësishëm një informacion për çdo moment që e ka shënuar një zyrtarë, merreni informacionin dhe konsideroni çfarë ju dëshironi.

**KRYESUESI:** Faleminderit! Ismajl Kurteshi, një minutë dhe mbylleni këtë se kemi dy orë që po flasim për të njëjtën çështje.

**ISMAJL KURTESHI:** Faleminderit!

Ministër, këtë dokument unë po e quaj ashtu siç e ka quajtur autorja, në letrën e saj thuhet përveç tjerash: “Bashkëlidhur me këtë e-mail po ua dërgojmë raportin lidhur me gjendjen faktike të librave të amzës të bartësve privatë të arsimit të lartë”. Ajo e ka quajtur raport, edhe sekretari i ministrisë e ka quajtur raport, pra fjala është për një dokument që ju mund ta quani si të doni, po këtë dokument që e quan autorja raport dhe sekretari raport, të na e dërgoni në afatin më të shkurtër të mundshëm dhe arsyen pse e keni larguar një herë këtë zonjë prej pune, e keni kthyer prapë, edhe këtë është mirë të na e shpjegoni, se sekretari në këtë pyetje nuk është përgjigjur fare. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Albert Kinolli nuk është, Fidan Rekalju s'është, Vjosa Osmani Sadriu s'është, Naser Rugova e ka fjalën.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Zoti ministër,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës, e në veçanti nxënësit, studentët dhe mësimdhënësit e të të gjitha cikleve të arsimit në vendin tonë.

Zoti ministër, më 9 shtator bëhen 2 vjet që kur është formuar kjo qeveri dhe ju e keni marrë përgjegjësinë që të udhëhiqni me sistemin e arsimit në vendin tonë. Unë nuk do të lëshohem në emra, në mikro detale dhe në statistika, sepse jemi organi më i lartë legjislativ i vendit që e monitoron punën e Qeverisë, e në këtë rast po flasim për një dikaster, sipas meje, më i rëndësishmi që është sistemi arsimor në vend. Ka shumë çështje që e mendojnë arsimin kosovar, por unë do të përqendrohem vetëm në disa prej tyre që i konsideroj të rëndësishme. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Administrata, trupat e kësaj ministrie janë kupola që udhëheqin me sistemin arsimor të një vendi. Në këtë kupolë këta muajt e fundit për 27 pozita menaxhuese punojnë ose nuk punojnë fare nga 2 zyrtarë njëkohësisht. Domethënë, 54 persona i mbajnë 27 pozita. Tani kemi njëfarë ambiguiteti me nënshkrimin e organogramit të ri, zoti ministër, për të cilin ne i kemi dhënë disa vërejtje tona, jo në këndvështrimin opozitar, por më shumë që e duam Ministrinë e Arsimit funksionale, kompetente, konkrete, dinamike konform trendeve të kohës dhe me njerëzit kompetentë dhe profesionalë.

Tash së voni MASHT-i ka filluar nxjerrjen e akt emërimeve sipas organogramit të ri. Unë konsideroj dhe Lidhja Demokratike e Kosovës vlerëson se kjo çështje do të shtojë problemet edhe më tej, sepse tash nuk flitet për zgjidhje të përkohshme, por aktemërimet janë vendime që mund të lënë, ministër, pasoja afatgjate. Këta hapa kanë shkaktuar edhe konfuzion, edhe pakënaqësi brenda administratës, departamenteve dhe drejtorive të MASHT-it, e në këtë dritë duhet parë edhe incidentet e përfolura kohët e fundit nëpër media, në Departamentin e Integriteteve Evropiane dhe në sektorin e NARIKUT. Se kjo Qeveri, vërtet këto ministritë që i menaxhojnë partnerët e koalicionit i konsideron si feude, fatkeqësisht, nuk e ka parë arsimin si top prioritet dhe që nga fillimi i marrjes së udhëheqjes nga partnerët e koalicionit të kësaj qeverie janë filluar gabimet në sektorin e arsimit. Është dëmtuar bukur shumë administrata dhe reputacioni i MASHT-it, nuk po flasim këtu për individë, por edhe karriera e individëve është po aq e rëndësishme. Janë degraduar dhe iu është pamundësuar puna profesionale e dhjetëra profesionistëve që kanë udhëhequr me vjet të tëra departamente të rëndësishme në strukturën e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Njerëz me background profesional, etik, familjar dhe që i kanë kryer të gjitha trajnimet e mundshme dhe kanë një ekspertizë dhe mosangazhimi dhe mosshfrytëzimi i potencialeve të tyre, konsideroj që e dëmton seriozisht edhe suksesin tuaj si ministër.

Dhe, konsideroj që gjetja dhe vendosja e njerëzve të duhur në vendin e duhur ka shumë rëndësi për menaxhimin e sistemit të dijës dhe shkencës që janë nën kupolën e Ministrisë së Arsimit. Zoti ministër, edhe në kohën okupimit klasik kur kemi organizuar arsim paralel, ministri i Arsimit i Republikës së Kosovës ka vendosur se kur përfundon viti shkollor, ne nuk e dimë kush po vendos, a duhet pyet SBASHK-un, a departamentet komunale të arsimit, apo drejtorët e shkollave. Unë konsideroj që ju jeni titullari i sistemit arsimor në vend dhe vendimi i ministrit do të respektohet. Prandaj, le të jetë ky viti akademik dhe shkollor i fundit kur nuk vendos ministri, po flasim 20 adresa në emër të shefit të sistemit të arsimit në vend.

Ishim dëshmitarë të faktit se një koordinator nacional për kulturë, rini dhe sport organizon teste diturie në shkollat në Kosovë. Kjo është paradoks i kohës, kjo e zhvleftëson edhe punën tuaj si ministër, po e zhvleftëson dhe e nënçmon nivelin e mësimdhënies dhe mësimnxënies në Republikën e Kosovës, zoti ministër. Një test diturie nga një koordinator, sepse kjo Qeveri shquhet edhe për do koordinatorë nacionalë, nuk e di kryeministri në mos do ta emërojë edhe një për interkoneksion mes galaktikave, organizon teste, të cilat dolën në publik. E keni fyer inteligjencën e mësimdhënësve, nxënësve dhe janë ofenduar edhe prindërit dhe ne si prind, po e përjashtojmë veten se dikush nga ne këtu kolegët është edhe mësimdhënës, prandaj duhet t'u vëmë pikë këtyre aventurave dhe keqmenaxhimeve me sistemin arsimor të vendit.

Tani kemi edhe informacione që, në fakt ju e dhatë një përgjigje, zoti ministër, për 3.5 milionë të fondeve të Bankës Botërore për komponentin e arsimit të lartë dhe sistemin e të dhënave në arsim. Konsideroj, zoti ministër, se me atë përqindje, edhe nëse kanë filluar 2016-2017, kur ju në fund të 2017-ës e keni marrë mandatin, a ju ka bërë dikush nga këta përgjegjës, nga këta kompetentë një raport se çka ka ndodhur me këto fonde, pse s'janë realizuar këto projekte, e gjithashtu na intereson edhe shkalla e implementimit të projekteve të donatorëve në MASHT për projekte të caktuara që janë goxha të rëndësishme për ngritjen e cilësisë së arsimit në vendin tonë.

Po dua të ndalem te arsimit të lartë. Fatkeqësisht po vazhdon trendi i një politizimi të skajshëm, ne e dimë që është kapur shteti. Personalisht, ministër, kam pritur që do të tentosh ta neutralizosh sado pak kapjen në çdo porë të arsimit të lartë në vendin tonë. Ndërrimi i këshillave drejtues dhe ndërrimi i përfaqësuesve të MASHT-it në këta këshilla në universitetet publike kam pritur se do të shkojnë njerëz më profesionalë, le të jenë edhe të partive, sepse ne të gjithë jemi të partive, ama të shkojnë njerëz me kredibilitet, që kanë njohuri bazike elementare se si funksionon një institucion i arsimit të lartë, e në veçanti në këto publike. Sepse, jemi dëshmitarë tani të dështimeve të mëdha të politizimeve dhe problemeve në sektorin e arsimit të lartë publik.

Te akreditimi, rezultatet e dobëta të universiteteve publike në raportet preliminare të akreditimit, jemi dëshmitarë të bërjes publike të rezultateve katastrofale të vlerësimit të jashtëm për akreditimin e tri universiteteve publike, Pejë, Mitrovicë, Gjakovë. Ne e dimë se disa universitete

në Kosovë i ka hapur një ish-kryeministër ekskluzivisht për nevoja elektorale dhe për rehatim të militantëve partiakë dhe kjo gangrenë e këtij sistemi të arsimit të lartë publik po vazhdon dhe e di, ministër, që e keni trashëguar. Por, në gjysmë të mandatit si ministër i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë është dashur ta vësh një pikë të madhe dhe ta ndërpresësh këtë praktikë të keqe, sepse me vendime të tilla politike, unë e di që ju nuk keni vendosur për shkarkimin e 1/3-ës së Bordit atëherë të Agjencisë së Akreditimit. U përjashtuam nga EQAR-i, po kemi probleme që gati dy vjet, do të kemi probleme në minimum edhe nja tre vjet të ardhshëm. A e dini shkaktarin dhe a ju ka dhënë përgjigje shefi juaj përse e ka bërë atë hap? Sepse, 5-6 breza mësimdhënës, studentë, studiues, do të paguajnë faturë për këtë akt të pamenduar.

Ju kujtohet, zoti ministër, që ne si Lidhje Demokratike e Kosovës në seancën e thirrur për atë çështje ju kemi qëndruar prapa, ju kemi mbështetur, sepse nuk është interes i një partie arsimit, është interes i shtetit, është interes i intelektualëve, i nxënësve, i studentëve dhe i brezave që vijnë.

Zoti Ministër, konsideroj që...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Faleminderit, Naser! Kaq patët kohë. Fjalën e ka deputetja Fitore Pacolli Dalipi.

FITORE PACOLLI DALIPI: Të nderuar qytetarë të Republikës,

Të nderuar deputetë,

Diskutimi sot filloi me dy parti në pushtet, të cilat thanë jo, ne i kemi meritat për dy çerdhe në Prizren, jo filan partia i ka meritat kryesore për dy çerdhe në Prizren. Por, të dyja e kishin gabim, sepse nuk kishin informata të sakta se çfarë po ndodh në Prizren.

Në fakt, në Prizren nuk janë dy çerdhe, janë gjashtë çerdhe. Pra, është një çerdhe që po ndërtohet me buxhetin e komunës dhe do të përfundojë këtë vit, një çerdhe që po ndërtohet me buxhetin e nivelit qendror dhe do të përfundojë vitin që vjen, janë dy çerdhe që po ndërtohen prej donatorëve të huaj dhe dy çerdhe që janë objekte ekzistuese dhe do të shndërrohen në çerdhe për qytetarët e për fëmijët e Prizrenit.

Pra, nuk janë dy, janë gjashtë dhe nëse keni dilema se kujt i takojnë meritat, duhet të ndaleni e ta shihni praktikën, pra se çfarë ka ndodhur. Kjo më bën mua që të kthehem në punën tek Komuna e Prishtinës. Në vitin 2014 deri në vitin 2017 Komuna e Prishtinës nën udhëheqjen e Lëvizjes Vetëvendosje ka arritur t'i hapë pesë çerdhe me bazë në komunitet. 5 çerdhe të tjera ia kemi lënë gati komunës që të hapen në këtë mandat, në vitin e parë dhe vitin e dytë. Në momentin kur ata udhëheqës largohen prej Lëvizjes Vetëvendosje, nuk ka më aty punë. Tash është hapur vetëm një çerdhe, edhe ajo në Kodër të Trimave, e cila ka qenë gati në fillim të vitit 2018. Vetëm duhet ta

kaloni rrugën, këtu në Lagjen Tophane, ku ekziston çerdhja për fëmijët e Lagjes Tophane. Është gati. Vetëm duhet dikush ta çelë derën, por kryetari e ruan atë kur të vijë fundi i mandatit, që të përfitojë meritat, qysh tentuan edhe dy partitë ta bëjnë këtë.

Të njëjtën po e bëjmë në Prizren. Kemi filluar me asnjë çerdhe në Prizren, po i hapim brenda mandatit 6, i kemi filluar, janë të tjerat që ne kemi planifikuar, pra do të jenë më shumë se gjashtë. Dhe, për meritat vetëm i drejtohen Lëvizjes Vetëvendosje, sepse në praktikë ashtu është. Pesë çerdhe funksionojnë tani në komunën e Prishtinës dhe ato është mirë që të shkoni t'i vizitoni.

Po, më shtyni pak më larg, që ta jap edhe një shembull se çfarë ndodh me ata të cilët janë në Lëvizjen Vetëvendosje, largohen nga Lëvizja Vetëvendosje dhe ndërrojnë parimet. Çerdhen në Besi kur e kemi hapur jemi dakorduar që çdo vit çerdhes t'i japim 20 000 euro në vit që çerdhja të funksionojë tamam, që fëmijët e çerdhes në Besi, që është çerdhja e vetme në fshat, të kenë shërbimet e njëjta sikur fëmijët në Lagjen Arbëria apo në Lagjen Mati 1. Me ndryshimin e partisë, me të bërit Socialdemokratë, i ndalet fondi dhe bëhet dallimi në mes të fëmijëve në Besi dhe fëmijëve në Arbëri. Pra, fëmijët në Besi nuk marrin kushte apo shërbime të njëjta siç marrin fëmijët në Arbëri.

Një tjetër gjë ta sqaroj, Komuna e Prishtinës, Drejtorja e Arsimit, ka filluar me dy ekspertë. Dy ekspertë shumë të mirë, Jusuf Thaçin dhe Arbërie Nagavcin, të cilët kanë vendosur rregullat bazë, procedurat ligjore të hapura dhe transparente, duke filluar nga regjistrimi i fëmijëve në çerdhe deri te punësimi dhe nga tenderët në këtë drejtori. Pyetini qytetarët e komunës së Prishtinës, pyetini mësimdhënësit, edukatorët, drejtorët dhe pyetini udhëheqësit tani në Komunë, të cilët kanë marrë e-maila që i kanë falënderuar për punësimet, jo ata që janë punësuar, ata që nuk janë punësuar, kanë dërguar e-maila, të cilët janë trajtuar në mënyrë të drejtë. Kështu që, këtu përfundoj me disa kritika që u desh t'juaj kthej.

Në Kosovë vetëm gjatë tre vjetëve janë shtuar diku 69 579 fëmijë. Sipas parashikimit të Entit të Statistikave numri i fëmijëve nga mosha 0 – 4 vjeç në vitin 2019 do të arrijë në 140 191 fëmijë. Pra, përderisa numri i fëmijëve nëpër komuna po rritet, numri i çerdheve publike mbetet i njëjtë. Në vitin 2015 ishin 43 çerdhe publike, 43 çerdhe publike janë po tani. Çerdhet në bazë në komunitet në Komunën e Prishtinës nuk numërohen, nga se ministri nuk di ta bëjë dallimin në mes çerdhes me bazë në komunitet dhe çerdhes private.

Në edukimin parashkollor sot janë përfshirë vetëm 8 335 fëmijë dhe prej tyre 4 099 janë në çerdhe publike, 3 856 janë në çerdhe private dhe 480 fëmijë janë në çerdhet me bazë në komunitet, që funksionojnë vetëm në komunën e Prishtinës.



Kosova mbetet vendi me përfshirjen më të ulët të fëmijëve në edukimin parashkollor në rajon dhe Evropë. Ministria po dështon të realizojë planin strategjik për arsim në Kosovë 2017 – 2021 dhe Strategjinë kombëtare për zhvillim 2016 – 2021. Nga statistikat e përmendura Kosova mbetet shumë larg drejt arritjes së objektivave në këto dy plane strategjike dhe këtë e thekson edhe raporti i Bashkimit Evropian, i cili thotë se vetëm 4.9% të fëmijëve janë të integruar në sistemin parashkollor. Për ta ndryshuar këtë gjendje ministri Bytyqi gjatë raportimit në Komisionin për Integrimi Evropiane vjen me një plan, me një “inovacion të hatashëm”. Thotë se duhet bërë një ndryshim, “fëmijët prej 0 - 3 vjet nuk do të shkojnë në çerdhe dhe fëmijët prej 4 - 6 vjet do të kenë mundësi të shkojnë në çerdhe”. Ky është një plan i ministrit, që nëse tenton të realizohet, ne nuk do ta lejojmë, sepse kjo është një logjikë e njëjtë që ka bërë Qeveria. Për ta ulur numrin e papunësisë të rinjtë në Kosovë, çka ka bërë Qeveria? Ka hapur universitete në secilën komunë, rrjedhimisht diku mbi 30 000 studentë, 30 000 të rinj i ka zhvendosur prej listës së të qenit të papunë, në listën e të qenit studentë dhe kështu me një ndryshim Qeveria e ul papunësinë. Pra, logjikë e njëjtë. Ministri po tenton njëjtë ta bëjë, t’i ndalojë fëmijët të shkojnë në çerdhe prej 0 – 3 vjeç dhe pastaj thotë: “Po, unë i kam integruar fëmijët në çerdhet publike, janë kaq numër”, sepse një numër e mban në shtëpi.

Me këtë mendësi që mbizotëron në MASHT dhe në këtë Qeveri dhe në këto parti politike që kanë udhëhequr dhe po udhëheqin vendin, nuk mund të bëjmë asnjë ndryshim. Kosovës i duhet ndryshim urgjent.

Çerdhet me bazë në komunitet: Ministria nuk i njeh si çerdhe me bazë në komunitet, i njeh çerdhe private. Unë po dua t’i tregoj ministrit që çerdhet me bazë në komunitet janë çerdhe që funksionojnë në përputhje me ligjet, rregulloret dhe udhëzimet administrative. Në këto kopshte nuk ka pronarë, nuk ka dorë që vjel fitimin, duke cunguar cilësinë dhe zhvillimin e procesit të edukimit. Prandaj, duhet që këtë sistem, këtë model të çerdheve me bazë në komunitet, që e kemi propozuar si Lëvizje Vetëvendosje, t’i ndihmoni komunave dhe ta përhapni sa më shumë që është e mundur, sepse ju keni filluar të ndërtoni disa çerdhe, mirëpo kur këto çerdhe të ndërtohen, përgjigja e ministrisë është “lëreni çerdhen njëherë, sepse duhet të prisni për përgjigje, nëse mund ta hapim çerdhe publike apo jo” dhe kështu përfundojmë ashtu siç tha deputeti Arbër Rexhaj, se ka çerdhe në plot komuna, objekte, të cilat ekzistojnë si çerdhe, por në fakt nuk kanë fëmijë, sepse ministria nuk ka mënyra, nuk gjen mënyra qysh t’i bëjë çerdhet funksionale. Ne e kemi modelin, ia kemi dhënë komunës, ia kemi dhënë ministrisë, le ta vazhdojë. Çerdhet me bazë në komunitet duhet ta kenë bazën ligjore dhe jo të konsiderohen si çerdhe private, sepse këto kanë dallim.

Pra, ministria përderisa nuk lejon hapjen e çerdheve publike, se ka arsytim si për shembull, kufizimi buxhetor që ka Kosova për shkak të marrëveshjes me Fondin Monetar Ndërkombëtar, Komuna e Prizrenit do të përballet me të njëjtat probleme me të cilat jemi përballë ne në Komunën e Prishtinës. Pra, do të gjejë mënyrën që të hapë çerdhet me bazë në komunitet. Këto

çerdhe me bazë në komunitet, që janë ndër çerdhet më të mira në Kosovë dhe në rajon, dhe unë e ftoj secilin deputet që të shkojë dhe t'i vizitojë, duhet që të bëhen si model edhe në komunat e tjera. Nëse nuk hapim çerdhe publike, ministër, atëherë duhet t'i njihni këto çerdhe, t'i trajtoni edukatorët në mënyrë të barabartë, sikurse edukatorët e çerdheve publike.

Prizreni shumë shpejt do të ketë gjashtë çerdhe dhe duhet të vendoset mënyra se si do të hapen: çerdhe publike apo çerdhe me bazë në komunitet. Nëse ministria dëshiron ta lërë në pritje Komunën e Prizrenit, ne nuk presim, kemi modelin që funksionon shumë mirë dhe do ta zbatojmë po atë model. T'ia përkujtoj ministrit, kur kemi hapur këto çerdhe, Komuna e Prishtinës ka pasur shumë probleme. Vetë MASHT-i ka tentuar që të na i mbyllë ato çerdhe, vetë MASHT-i ka telefonuar që t'i mbyllë ato çerdhe, mirëpo ato janë duke funksionuar shumë mirë dhe do të vazhdojmë me përhapjen e tyre.

Tutje, ministri po dëshon në mbikëqyrjen e çerdheve private...

*(Ndërprerje nga regjia)*

**KRYESUESI:** Faleminderit! Deputetja Emilija Rexhepi e ka fjalën.

**EMILIJA REDŽEPI:** Zahvaljujem se potpredsedniçe!

Uvaženi ministre,

Kolege poslanici,

Poštovani građani,

S obzirom da nam je danas na dnevnom redu debata o opštoj situaciji u obrazovnom sistemu, želim da ponovo iznesem problematiku u Bošnjačkoj zajednici i u nastavi na bosanskom jeziku, pre svega počev od predškolskog uzrasta gde u nekim opštinama poput Prištine i Istoka, konkretno u Banji ali i u gradu Prizrenu, osnovna škola "Lek Dugađini", gde godinama unazad tražimo otvaranje predškolskog odeljenja a nemamo ga još. Pa se pitam dali neko svesno ili nesvesno vrši asimilaciju naših učenika pre upisa u osnovne škole.

Situacija u osnovnim školama u nastavi na bosanskom jeziku je solidna. Imamo dosta problema u opštini Priština, gde naša deca zbog loših uslova i nestručnog kadra po školama upisuju se i na drugim jezicima, a pre svega na turskom jeziku, što je za nas velika problematika i veliki broj dece ove godine počeo je i na srpskom jeziku u Gračanici.

Borimo se svim svojim snagama političkim zajedno sa pojedinim roditeljima da zaustavimo ovu aktuelnu situaciju u Prištini a u drugim opštinama, kao što je Peć, Istok, Dragaš, Prizren, odnosno u okolnim našim selima, nije toliko loša situacija i naši se direktori bore za svoje škole, kako bi učenicima stvorili bolje uslove školovanja. Ali mi kao zajednica, poštovani ministre, već dve decenije imamo problem oko prevoda udžbenika koji su neadekvatni i nekvalitetni. I sada je

raspisan konkurs za udžbenike za nacionalnu grupu predmeta i bez prethodno izgrađenog i odobrenog plana i programa, kada su u pitanju nevećinske zajednice, što se stalno u kontinuitetu dešava. Jedan te isti čovek piše sve te predmete. Koji je to vrhunski ekspert toliko stručan da za sve zajednice može sve to da napiše, a milioni se troše na nove udžbenike koji će biti opet isti a mi ćemo i dalje zaostajati za znanjem i kvalitetom.

Poštovani ministre, zahtevam od Ministarstva, lično od vas, kontrolu nad izdavačkom kućom kao i celokupnom toku prevođenja udžbenika, kako bi se ova zloupotreba pojedinaca sprečila a kvalitet udžbenika poboljšao. Takođe, gledajući uopšteno za sve zajednice za veliko žaljenje je i kako pojedini nastavnici mogu uopšte dobiti licencu od strane Ministarstva na terenu pokazuju jako malo, odnosno minimalno angažovanje i nezainteresovanost, čak ni roditelji ne žele da upišu svoju decu kod njih, što u velikoj meri utiče na učenike i njihovu zainteresovanost za nauku.

Pitanje je dali Ministarstvo uopšte ima mehanizama da proverava i odobrava licence nastavnika, ili se to radi po šablonu kao što je to bilo do sada? I zato je potpuna pasivnost svih nastavnika i profesora po školama uz svo uvažavanje pojedinaca, koji daju svoj maksimum da decu izvedu na pravi put tokom njihovog daljeg školovanja.

Zatim, uvaženi ministre, i dalje se nastavlja diskriminacija prema prosvetnom kadru iz redova nevećinske zajednice po pitanju organizovanja raznih vrsta seminara. Vi ste to, da budem iskrena, malo promenili u pozitivnom smislu, ali nama treba još takvih seminara. Takođe, nama kao zajednici nedostaje pedagoška dokumentacija za nevećinske zajednice. Često nam se dešava da školska godina krene bez prevedene školske dnevničke, nedostaju nam i matične knjige na svim jezicima nevećinske zajednice, svedočanstva za učenike i ostala dokumentacija. To je gospodo, naše ustavno pravo, i neko nam namerno to krši i zahtevam od ministra veću odgovornost po tom pitanju. Molim vas, vršite nadzor i kontrolu nad tim firmama ili izdavačkim kućama koji uzimaju milione i milione evra za ovaj posao.

Visoko školsko obrazovanje se kod nas izvodi u opštini Prizren na javnom Univerzitetu Ukšhin Hoti, kao i u opštini Peć, Univerzitet Hadži Zeka, koji ovih dana imaju veliku problematiku oko akreditiranja pojedinih smerova. Vi ste takođe, ministre, dobro upoznati sa tom celokupnom situacijom i očekujemo vašu podršku za rešenje ovog problema.

Nama kao zajednici je jasno da problem obrazovnog sistema u našoj državi je globalni problem i dotiče svakog našeg učenika, bez obzira na naciju. Jasno nam je i da decenijski problem kojeg je teško rešiti, ali od vas očekujemo malo više da se bavite odgovornostima onima koji krše zakon i malo više tehničkim i infrastrukturnim projektima koje direktno utiču na poboljšanje uslova i kvaliteta obrazovnog sistema.

Poštovani ministre, ja se vama lično zahvaljujem na određenim potezima koje ste za ovaj kratak vremenski period odradili u interesu Bošnjačke zajednice, ali treba nam još veća vaša podrška da zajedno rešimo ovaj naš problem kojeg imamo dve decenije, sve u interesu naših učenika i boljeg kvaliteta nastave na bosanskom jeziku. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Dukagjin Gorani.

DUKAGJIN GORANI: Faleminderit zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Përgjithësisht prej themelimit, shkolla në Kosovë është përjetuar vetëm si formalitet, si obligim, si kusht, edhe si detyrim. Andaj ishte e pritshme që me kalimin e kohës, ajo të vlerësohet vetëm si notë, si dëftesë e si diplomë, si letër. Nuk mbaj mend nëse ndonjëherë shkollimi te ne është përjetuar si kureshtje, si dëshirë, kënaqësi apo edhe argëtim. Nuk e mbaj mend të jetë përjetuar si vullnet për ta kuptuar botën dhe si përkushtim për dituri. Patjetër, ka përjashtime nga ky pohim, mirëpo kam frikë se ato mbeten vetëm përjashtime, dhe si të tilla vetëm sa e vërtetojnë atë pohim.

Sot asgjë nuk e ilustron më mirë logjikën tonë shoqërore edhe shtetërore sesa sistemi arsimor. Ai e pasqyron më së miri mosmarrëveshjen tonë të gjatë e të mundimshme me bashkëkohësinë. Duke qenë i reduktuar vetëm në formë, e kurrë në përmbajtje, ajo shpërfaq njërën nga vetitë tona më absurde në përcaktimin e vlerës shoqërore, atë se sasia është gjithmonë më e rëndësishme se cilësia. Jo vetëm gjatë këtyre njëzet vjetëve të fundit, por edhe prej 70 vjetësh më parë, shkollimi në Kosovë është vlerësuar vetëm numerikisht. Gjatë gjithë jetës, e tëra që mbaj mend nga deklaratimet e përfaqësuesve të arsimit, ishte përqendrimi në numra, edhe në sasi. Ishte vetëm numri i shkollave, numri i nxënësve, numri i të diplomuarve, numri i mësimitdhënësve, numri i magjistrantëve e doktorantëve. Ishin vetëm këto që konsideroheshin me rëndësi. Asnjëherë cilësia, asnjëherë aftësia, dhe asnjëherë dituria.

Me dekada të tëra jemi lavdëruar me numër të nxënësve e të objekteve shkollore, duke besuar naivisht se vetvetiu sasia do ta nënkuptoj cilësinë. Se vetëm forma, e kurrë përmbajtja do ta ndërtojë një vlerë të përdorshme e të qëndrueshme në shoqëri. Dëshira jonë e madhe për ta bindur botën në arritshmërinë tonë si shoqëri, përfundimisht na ka detyruar ta gënjejmë veten. Gjatë viteve, ky obsesion me sasi dhe formë e degradoi idenë e shkollimit, në një industri të letrave, në një biznes të prodhimi e të riprodhimit të paaftësisë shkencore, kulturore e shoqërore. Sidomos në këto njëzet vjetët e fundit, ofrimi i shkollimit të pavlerë është shndërruar në biznes multimilionësh. Sot ai e përbën një standard shoqëror. Andaj, është edhe e kuptueshme që çfarëdo përpjekje për ta ndryshuar e transformuar, do të përballet me akuza e kundërshtime, si në sektorin publik, ashtu edhe në atë privat. Insistimi në cilësi do t'ju shkaktojë armiqësi. Kurrë nuk kemi pasur më shumë shkolla e universitete, kurrë s'kemi pasur më pak cilësi. Jo vetëm në arsim, por sidomos në arsim.

E kemi ndërtuar një kështjellë prej letrave, që nuk ka as kuptim e as vlerë. Tashmë është bërë trishtë e verifikueshme se cilësia e nxënësve, e studentëve tanë, nuk është e kualifikuar dhe nuk është e kualifikueshme, nuk është e përdorshme dhe nuk është konkurruese. Punësimi i tyre nëpër sektorë me kërkesa të larta të cilësisë, si ata profesionalë, qoftë vendorë, qoftë ndërkombëtarë, është i papërbalueshëm dhe është i paarritshëm. Ky sistem i bazuar në shkollim formal, pa qëllim, pa specializim, nuk prodhon tjetër, veçse njerëz të varur dhe shoqëri të pashpresë. Krijon klientë, krijon individë që mungesën e dijes detyrohen ta plotësojnë me dëgjueshmëri e shërbëtori. Tash e sa vjet, kjo armatë fatkeqe e shoqërisë sonë me dëftesa në dorë, synon të punësohet vetëm aty ku nuk kërkohet cilësi, ku lojaliteti gjithmonë vjen para kualitetit. E në Kosovë kjo kryesisht nënkupton shërimin publik, dikasteret qeveritare, ndërmarrjet publike e partitë politike.

Madje gjatë viteve është prodhuar edhe legjislacion i veçantë për ta pamundësuar zhvillimin e arsimit cilësor. Një mal i ligjeve, i udhëzimeve administrative e rregulloreve janë hartuar me një qëllim të vetëm, që mësimdhënia të reduktohet në rutinë e dëgjueshmëri, e nxënësi të përjetohet vetëm si numër edhe sasi. Një sistem i këtillë arsimor, i pavlerë e i pakuptimtë duhet të kuptohet edhe si një nga arsyet kryesore të braktisjes alarmante të vendit. Mijëra të rinj e qindra familje të reja largohen çdo vit në kërkim të një jete më të mirë, e jo rrallëherë edhe në kërkim të një shkollimi më cilësor për vete, edhe për fëmijë.

Sot përballemi me fshatra të boshatisura e me shkolla të braktisura, me objekte të zbrazura e të ndërtuara pa nevojë edhe pa arsye. Sot dhjetëra të tilla qëndrojnë si përmendore të një obsesioni shoqëror e shtetëror për sasi dhe formë, e asnjëherë për cilësi e përmbajtje. Këto pamje të fshatrave pa banorë dhe të shkollave pa nxënës e reflektojnë edhe pasojën përfundimtare të logjikës së mbrapshtë që vazhdon ta mirëmbajë sistemin tonë arsimor.

Sot është pikërisht sasia dhe numrat me të cilat krenoheshim ndër vite, ato që kanë filluar të zhduken. Pas gjithë këtyre dekadave të shpenzuara në besimin se dituria është vetëm formalitet, se notat, dëftesat e diplomat janë më të rëndësishme se aftësitë, sot e kemi arritur pikën ku na pret hakmarrja e madhe nga mungesa e cilësisë. Jo vetëm në arsim, por sidomos në arsim. Mungesa e cilësisë po e kërcënon mbijetesën e shoqërisë dhe mbijetesën e shtetësisë. Vetëm në Komunën e Kamenicës, gjashtë shkolla përpiqen të funksionojnë me më pak se pesë nxënës. Gjashtë të tjera funksionojnë me më pak se 20 nxënës. Sipas të dhënave të fundit, mbi 50 përqind e shkollave në këtë komunë, funksionojnë me pak se 70 nxënës. Përpjekjet e sotme të kryetarit të kësaj komune, Qëndron Kastratit, që ta pranojë këtë fakt dhe ta racionalizojë funksionimin e arsimit përballë me akuza, me ofendime e kundërshtime. Këto kundërshtime shkaktohen pikërisht nga moskuptimi se vetëm muret e dritaret nuk e përbëjnë shkollën. Se shkolla nuk është vetëm vend pune për arsimtarë e për administratë, e sidomos jo në situatë kur mungojnë edhe banorët e edhe nxënësit.

Arsimi në Kosovë nuk ka dështuar as sivjet, as vitin e kaluar, e as dy vite më herët. Ai përbën një anomali sistemike që u zhvillua me dekada dhe që në fund ia doli të shndërrohet në një normë fatkeqe shoqërore. Që moti dëftesat e diplomat e tij kuptohen vetëm si dëshmi e paaftësisë dhe e analfabetizimit funksional. Ai nuk ka nevojë për reformim e as për përmirësim. Ai duhet të transformohet, të rimendohet dhe të rithemelohet. Kjo nënkupton përpjekje të mëdha për vite të tëra. Mirëpo sa më shumë që vonohen, aq më shumë do të zgjasë edhe aq më keq do të bëhet. Në të kundërtën, arsimi ynë do të vazhdojë kështu si është, duke ofruar një gjë të vetme për tash e 70 vjet, që t'i mësojë kosovarët shkrim-lexim. Ju faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Fjalën e ka ministri Bytyqi.

**SHYQIRI BYTYQI:** Faleminderit kryesues!

Deputetja Pacolli s'qenka këtu, se na ngriti disa çështje. E para, e falënderojmë shumë që po na mëson tipat e çerdheve në Kosovë, por mos të gëzohet shumë se e ka marrë gabimisht. Çerdhet me bazë në komunitet në Kosovë ekzistojnë që nga viti 2000, si p.sh. në Pejë, kështu që nuk është zbulim i zonjës Pacolli, është zbulim i shumë njerëzve me para.

Zonja Pacolli paske harruar, ose të shikojë edhe një herë se çka kemi thënë në Komision kur kemi folur për moshën 0-3 vjeçare. Kemi thënë, për shkak të pamundësisë që të krijojmë kushte institucionale që të gjithë fëmijët e kësaj moshe të jenë pjesë e institucioneve, ne nuk do të rrimë duarkryq, por do të marrim masa konkret. Dhe bashkë me UNICEF-in e kemi përgatitur projektin që ta kemi një pako ku do t'ju dërgojmë familjeve që kanë pamundësi të dërgojnë fëmijët 0-3 nëpër çerdhe, që të kenë këtë pako me material didaktik dhe materiale të tjera, përrshirë edhe Ministrinë e Shëndetësisë, në mënyrë që edhe këta fëmijë që nuk e kanë mundësinë aktuale të jenë pjesë e institucioneve, të edukohen dhe të rriten ashtu siç duhet çdo fëmijë tjetër që është brenda institucionit. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Fitore Pacolli, kundër-replikë, një minutë!

**FITORE PACOLLI-DALIPI:** Zoti ministër, unë s'e paskam pasur hiç gabim. Ashtu ke thënë, se në plan ti e ke mos të hapësh asnjë çerdhe tjetër, por të mundohesh që të bësh edukimin në shtëpi. Unë ta dhashë modelin. Ne e kemi modelin me bazë në komunitet. E kemi modelin e çerdheve publike. Ti më trego sa çerdhe publike ke në plan t'i hapësh për fëmijët 0 deri 3 vjeç. Mos më trego mënyrën sesi do t'i edukosh prindërit që t'i edukojnë këta fëmijë, sepse kjo ka për të dështuar qysh në fillim. Pra, kjo është një arsytim që ti e bën për mospunën tuaj. Pra ma jep numrin e saktë të çerdheve, sa çerdhe planifikon. Sepse nuk është vështirë. Komuna e Prizrenit për dy vjet ka filluar gjashtë çerdhe. Nuk është vështirë, vetëm duhet punë dhe vullnet dhe Lëvizja Vetëvendosje ka. Ne e kemi planin, ta japim nëse do. Shko vizitoji çerdhet me bazë në komunitet dhe hapi. S'ke nevojë të bësh edukim në shtëpi, s'ke nevojë të shpikësh ujin e nxehtë.

Mund të hapësh çerdhe. Ke objekte që nuk shfrytëzohen, shndërroji në çerdhe ministër. Shndërroji në çerdhe.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Bilall Sherifi. Shpresoj të kapërcejë përtej çerdheve, sepse u zgjat shumë.

S'ka të drejtë.

BILALL SHERIFI: Përshëndetje i nderuar kryesues!

Përshëndetje kolegë dhe qytetarë,

Para se të hyjë në fjalë, megjithatë po e bëj unë replikën. Epo nuk shkon bre kjo, diçka çka të refuzon populli, të kërkosh ta zbatosh Nisma, ministria jonë. Pra ti e ke pasur atë model te qytetarët, të ka dhënë aq sa të ka dhënë. Tash s'mundemi ne të veprojmë me modelet e tua. Ne i kemi modelet tona. Pra, ti atë që s'ta pranon populli, kërkon ta imponosh te Qeveria. Po s'e kemi ndërmend t'i marrim modelet të cilat s'i ka pranuar populli.

Tash vazhdojmë me debatin.

Të nderuar kolegë,

A jemi këtu për të debatuar për të gjitha dështimet të cilat një nga një i numëroi jashtëzakonisht mirë kolegu Gorani, Dukagjin Gorani, apo jemi këtu për të matur punën e Ministrisë këto dy vite? Veç ta dimë për çka jemi këtu! Për çka e keni thirrur seancën? A e keni thirrur për të numëruar një nga një dështimet e sistemit të arsimit në 20 vjet, besa në 30, sepse të gjithë e dimë që edhe periudha e mbijetesës të arsimit '89, sidomos '90-'99, ka qenë e domosdoshme si e tillë, por të gjithë e dimë që nuk ka qenë e mjaftueshme për t'u quajtur sistem i arsimit. Të gjithë e dimë.

Por çka kemi bërë për këto 30 vjet, sidomos këto 20 vjet, apo jemi për të matur ministrin. Unë kam pritur që këtu do të flasim për atë që kemi ardhur. Pra, të masim këtë Qeveri, këtë ministër, sidomos nga opozita, se jo nga mazhoranca, këto goditje të tipit të Brutit nuk i kam dëshirë, se do të dimë edhe ne t'i bëjmë, po nuk është mirë. Nuk është mirë të sillemi në atë mënyrë. Kjo Qeveri ka miratuar një projekt-plan, një plan për arsim dhe të gjithë deputetët do të duhej së pari të flasin edhe me partitë e tyre, kur flasin së paku në emër të partive të tyre, të mazhorancës se a janë pjesë e Qeverisë dhe a kanë marrë mandatin për të folur në këtë mënyrë kundër planit të Qeverisë. Sa është zbatuar dhe sa nuk është zbatuar. Pra, kjo sa i përket.

Unë mendoj që këtu jemi për të matur çka ka bërë ministri. Përndryshe, nës hyjmë në atë historikun njëzetvjeçar, unë s'besoj që do të mund t'i radhisë dikush më mirë se Dukagjin Gorani këtu. Dhe tash shpresoj sot ta ketë parë Vetëvendosje çka ka humbur. Dhe nëse një nga ekspertët më të mirë të arsimit e ka humbur. Pra nga një njeri që ka një vizion për arsimin, kanë mbetur të

flet një njeri për çerdhe. Po, po të çojmë ty në çerdhe. Shko se, ej, a e di për çka është çerdhja, të mësohen gjërat elementare të mirësjelljes, pra edukata mësohet në çerdhe. Në çerdhe mësohet edukata se si të sillësh me kolegë, si të sillësh në familje, cilat janë vlerat që u tha këtu nga Topalli.

Prapë po dalim te Topalli, po vlerat e shoqërisë i përcjellin te gjeneratat që vijnë. Çka është për neve me vlerë të cilën nuk e shkelim, për të cilin nuk manipulojmë? Cilat janë ato vlerat tona të përbashkëta që nuk na ndajnë, që na bashkojnë, që na detyrojnë së paku që të ecim së bashku, përkundër diversitetit, përkundër dallimeve që mund të kemi për çështje të tjera. Hyn, kemi filluar edhe po e përfundojmë seancën me goditje të ulëta, me pseudofakte, me le të themi me grumbullim të dështimeve për 20 vite, duke i derdhur në një seancë. E kjo është ajo që kolegu Glauk Konjufca, sot e tha mos bëni propagandë. A e shihni bre që s'është mirë të merresh me propagandë, se pastaj vjen një moment kur ju zë përfundi ai mekanizmi që ju krijoni? Çdo ditë bëni propagandë, një herë u bë pak propagandë për juve, desh u çmendët, mos bëni propagandë. Epo kur të bësh propagandë, do të vjen momenti që të gjendet propaganda, që të zë përfundi propaganda.

Tash, a duam reformë në arsim, a duam mirëmbajtje të sistemit që e kemi ngritur? Kjo ngrehinë ka shpresë. Unë mendoj që ka shpresë, përkundër asaj që thuhet se nuk ka shpresë. Unë mendoj se ende ka shpresë për riparime, ama duhet vendime të mëdha. Nuk është reformë pesë çerdhe më shumë, gjashtë shkolla më shumë, shtatë mësues më shumë. S'është reformë. Ajo është mirëmbajtje. Dakord jam që duhet të mirëmbajmë këtë sukses, përderisa nuk kemi një sistem tjetër. Ama nuk ka shumë shpresë që duke e mirëmbajtur këtë sistem të arsimit, do të arrijmë të jemi konkurrentë për ekonominë tonë, le më për ekonominë e jashtme.

A jeni duke e vërejtur çka po bëjmë ne? Ne prodhojmë mjek të mirë, nuk janë mjek të këqij, ama na i merr Gjermania. Krenohemi se mjekët tanë po gjejnë vend pune në Gjermani. Po normal që gjejnë vend pune, sepse mjekësia është shkencë universale, si në Prishtinë, si në Berlin, pastaj ta bën mjek kur ta fut në klinikë. E bën mjek, siç u tha edhe nga kolegu.

Pra, a duam? A më tregoni ju edhe një vend tjetër në botë ku 30 mijë fëmijë fillojnë shkollën fillore, 30 mijë e kryejnë të mesmen, 30 mijë regjistrohen në universitete. 100 për qind? Ma tregoni veç edhe një vend! A nuk do të duhej të ishte arsimiti njëlloj piramide, fillojnë shumë, baza shumë, për arsimimin e përgjithshëm, edhe në nivele lart shkon duke u ngushtuar. Edhe po supozojmë që te doktoratura duhet të mbeten disa që e vendosin atë kapakun, atë gurin e fundit në piramidë. A do të duhej të ishte kështu? Të gjithë do të thonin po do të duhej të ishte kështu dhe nëse nuk është kështu, është gabim. A jemi të gatshëm ta bëjmë këtë?

Jam shumë i sigurt që kushdo që të vjen në pushtet, do t'i nënshtrohet po këtij rendi të gabuar që e kemi vendosur në arsim, këtij sistemi nëse jo le të themi të gabuar, së paku një sistemi që nuk



po funksionon, që nuk po prodhon kuadro që janë, që do të duhej, që do të mund të ishin konkurrentë në treg. Çka do të thotë kjo? A jemi të gatshëm që të ndjekim modelin perëndimor? S'ka universitete private. Pra, le t'i lëmë universitetet private, por le të bëhen ato shoqata jofitimprurëse, organizata jofitimprurëse. Pra, jo të bëhen milionerë pronarët e tyre, por të hapin universitetet dhe çdo qindarkë të shkon në universitet, në paga, në investime, në literaturë, në sjelljen e ekspertëve, profesorëve, ku ta di unë nga bota e përparuar që ne synojmë të shkojmë. Pra le t'ua heqim ne mundësinë privatëve që të fitojnë nga to, që të bëhen milionerë. As ju, as ju, as ne këtu nuk jemi në gjendje këtë ta bëjmë. Nuk jemi të gatshëm ta bëjmë. Sepse, kjo siç u tha, ka shumë shkurtime, duke filluar nga vota, s'po shkoj më larg. Shkurtimet fillojnë nga vota, s'po shkoj më tej, sepse nuk po dua të hap debat të cilin më vonë mund ta hapim.

A jemi të gatshëm që universitetet publike, jo t'i mbyllim, mos bëni propagandë, të kapet për fjalë të një kolegu, dhe pastaj të themi ja kjo parti e do, kjo s'e do arsimin. A jemi të gatshëm që këto t'i reformojmë? Çka do të thotë të reformojmë? Të ristrukturojmë. Të gjithë kanë nga një ide çka është ristrukturimi. Mund të ulemi së bashku pozitë, opozitë, të heqim këtë nga agjendat partiake, sepse ju lutem kolegë duke filluar nga ministri që të mos më përmendni fjalën politizim. Është politikë arsimit, është normale që të bëhet politikë në arsim. Secila mazhorancë i ka politikën e veta për arsim, por të departizojmë. Pra depolitizimi dhe departizimi janë dy fenomene krejt të ndryshme. Hajde të ulemi pozitë-opozitë e të bëjmë një strategji nacionale sesi të zhvillohet arsimi në pesë, në dhjetë, në pesëmbëdhjetë apo njëzet vjet, duke mos pasur të drejtë asnjëra, kushdo që vjen në Qeveri që ta ndryshojë atë strategji.

Të fillojmë nga arsimi i ulët, i mesëm, i lartë e deri tek doktoratat. A ka gatishmëri? Ne në emër të Nismës ofrohemi, dhe jemi të gatshëm që të fillojmë një proces konsultimi, bashkëpunimi me të gjithë ata që janë të gatshëm.

Kushdo që nesër që troket në dyer e thotë, nëse ju nuk e bëni këtë, nuk e mbështesni një projekt të tillë ne do t'ju votojmë, të thoni jo, faleminderit, sepse jote sot është për ta rrënuar vendin tim nesër.

Pra, nëse jemi të gatshëm dhe duam që para se të shikojmë votën, financimin e ku ta di unë se çfarë formash të tjera të bashkëpunimit me të gjithë ata që keqpërdorin në emër të arsimit për interesa të tyre personale dhe private dhe nëse jemi të gatshëm që të heqim dorë nga këto, jam i sigurt që brenda periudhë pesëvjeçar, kushdo që do të jetë në qeverinë e ardhshme, kurdo që të mbahen zgjedhjet, do të vërehet ndryshimi i jashtëzakonshëm në cilësi në shkollim të ulët, në shkollim të mesëm dhe në shkollim të lartë.

Uroj që ky debat, së paku të na shërbejë që në të ardhmen të heqim dorë nga propaganda, sepse propaganda është një ngrehinë që herë do kurdo ju zë edhe juve për fundi.

Prandaj, le të flasim objektivisht, çka jemi të gatshëm të bëjmë duke qenë jo vetëm në opozitë po edhe në pushte në mënyrë që të ecim përpara dhe ta ndërprejmë këtë rrugëtim jashtëzakonisht të rrezikshëm të sistemit të arsimit dhe të arsimit në përgjithësi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, Bilall! Fitore Pacolli-Dalipi ka kërkuar replikë. I ke dy minuta.

FITORE PACOLLI-DALIPI: I nderuar deputet, Reformë është ty me ta ndërruar mendësinë, deputet, sepse ju nuk e keni idenë e doktrinës kurrikulare dhe të moduleve për arsim parauniversitar. Pra, reformë është që në këtë Kuvend të mos kemi më deputet si ju, të cilët nuk e dinë rëndësinë e edukimit parashkollor. Edukimi parashkollor...

KRYESUESI: Regjia, ju lutem ta mbyllni mikrofonin. Zonja deputete, duhet t'i respektoni normat e komunikimit në Kuvend. Kjo s'është formë me të cilën mund t'i drejtojeni një deputeti tjetër që është sikurse edhe ju.

Ne këtu jemi për qëndrime dhe jo për kualifikime personale. Të mos më detyroni që tua ndërpres fjalën. Mund të vazhdoni.

FITORE PACOLLI-DALIPI: Modeli i çerdheve në bazë në komunitet, ka kërkesa të mjaftueshme, mjafton ta shikosh listën e pritjes nëpër këto çerdhe.

Çerdhet në bazë në komunitet, për dallim prej shumicë së çerdheve këtu në vend, nuk shërbejnë si institucione për projekte për përkujdesje, por janë institucione thelbësisht edukative.

Ekspertët vendor, si dhe në raportet që financohen nga Bashkimi Evropian, i kanë rekomanduar ministrisë, e përsërisë, i kanë rekomanduar që ky model të replikohet edhe në vende të tjera.

Prandaj, këtu në këtë Kuvend, sado që ne flasim, sado që propozojmë modele të reja, ne duhet të kemi deputetë tjerë që dinë rëndësinë e çerdheve dhe dinë rëndësinë se çfarë sjell një edukim i një fëmijë prej moshës zero deri në gjashtë vjet. Kaq.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputet Bilall Sherifi, kundër-replikë. E ke një minutë.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, kryesues! Çka të them, kjo flet më së miri për mendësinë e subjektit që ajo përfaqëson, jo të saj personal.

Këta dëshirojnë që të gjithëve tua fusin çipin që ua kanë futur atyre në kokë. E po, demokraci nuk e ka këtë. Demokracia e ka diversitetin. Pra, secili deputet që e ka marrë besimin e popullit, ka të drejtë të vijë edhe t'i thotë mendimet e veta, pa marrë parasysh se a i pëlqejnë dikujt apo jo.

Nuk është mirë të vijmë në atë gjendje ku të mallkojmë popullin. Lëreni popullin le të zgjedhë, dilni bindeni se ju jeni më të mirët, por kështu siç keni filluar vetëm sa do të rrudheni dhe të bëheni edhe më të parëndësishëm që jeni tani.

KRYESUESI: Faleminderit! Radhën e ka deputetja Valentina Bunjaku-Rexhepi.

VALENTINA BUNJAKU-REXHEPI: I nderuar, nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë ka kohë që e kam kërkuar fjalën për replika shumë të kolegëve dhe që të diskutoj për shumë çështje që u diskutuan këtu.

Sinqerisht, bashkërisht ne si opozitë kemi ftuar këtë debat parlamentar duke menduar që secili prej jush do ta jepni kontributin tuaj dhe do të kontribuoj as sa di dhe aq sa mundën që problemet në arsim së paku të evitohen, sepse që të zgjidhen të gjitha për një kohë kaq të shkurtër është e pamundur.

Këtu më tepër u lavdëruar kryetarët e komunave, jo kryetari kësaj komune më mirë, jo kryetari i asaj i komune më i mirë dhe absolutisht nuk u dha një propozim konkret sesi të dilet nga ky kaos apo nga këto problematika që janë në Ministrinë e Arsimit apo në arsimin në përgjithësi.

Dua t'ju bëj me dije që këtu u akuzuan edhe të gjitha partitë që kanë qenë në pushtet, por për hir të njoftimit të opinionit, Lidhja Demokratike e Kosovës nuk ka udhëhequr me Ministrinë e Arsimit që 11 vite.

Unë e di që ministri aktualisht nuk mundet që brenda një mandati kaq të shkurtër t'i zgjidhë të gjitha problemet që janë në arsim, po së paku duhet të ketë tendencë për përmirësimin e cilësisë dhe eliminim e problemeve në arsim në Republikën tonë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Ganimete Musliu.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, nënkryetar!

I nderuari ministër,

Të nderuara kolege dhe ju kolegë deputetë,

Po besoj se shumëçka u fol sot. U fol edhe për çerdhet. Nga Fitorja e nga Milaimi u fol edhe për shkollat e mesme. Nga Arbri, për drejtoritë për arsim. U fol edhe universitet nga Teuta. Për akademinë nga Bilalli e kështu me radhë.

Na ka mbetur shumë pak ndoshta të themi.

Unë shumë shkurtër, dhe vetëm një pyetje shumë konkrete e kam për ministrin e Arsimit.

Ministër, e kam ndjekur mbrëmë një kronikë televizive gjatë lajmeve, lajmeve qendrore, dhe më bëri shumë përshtypje raporti gjatë asaj kronike, ku një pjesë e mësuesve ose mësimdhënësve tashmë vetëm sa janë duke i bërë pushimet në bregdet, që i ka dërguar sindikata e arsimit. Ndërsa, një pjesë tjetër janë të stresuar, frustruar, të pakënaqur ishin duke e mbajtur ose duke e vijuar mësimin.

Gjithashtu, edhe nxënësit të cilët u intervistuan që fare nuk iu mbulua fytyra në ato kronika, e shprehnin pakënaqësinë e tyre, sepse vërtetë ishte e pakuptimtë kur klasat ishin të boshatisura me pak nxënës në ato klasa.

A mund të më tregoni se çfarë duke ndodhur me këtë çështje? A jeni ministër dhe a kemi Ministri të Arsimit që e njeh krejt Kosova, që e njohin krejt shkollat apo thjesht kujt t'i teket dhe çfarë t'i teket të bëjë në këtë vend.

Për mua ishte shumë shqetësuese ajo kronikë edhe s'po dua që të lëshohem e t'i komentoj krejt ato që u thanë. Thjesht, më ka bërë shumë përshtypje negative ajo kronikë dhe kisha dashur ta dijtë se cili është qëndrimi juaj. Çfarë është duke ndodhur dhe a do të përsëritet një skenar i tillë, sepse i janë prishur planet prindërve. U janë prishur plante mësuesve, i janë prishur planet edhe fëmijëve.

Mbi të gjitha, nuk ka mësim këto ditë, që veç po shkojnë sa për sy e faqe në shkolla.

**KRESUESI:** Ministri e ka fjalën. Dy minuta!

**MINISTRI SHYQIRI BYTYQI:** E nderuar deputete, siç e dini kjo situatë është shkaktuar për shkak të ndërhyrjes së SBASHHK-ut në mënyrë jo kompetente, që nuk kishte të drejtë dhe obligim që të ndërhyjë në sistemin arsimor. Mirëpo, që kishte dhe ndikime politike edhe shtyrje politike nga SBASHK-u dhe ka krijuar këtë kauzë që është tash në përfundim të viti shkollor.

Ajo e cila është dashur që secila komunë në bazë të takimit përfundimtar që e kemi pasur me të gjithë drejtorët e DKA-ve, jemi dakorduar që secila DKA, duhet ta bëjë planifikimin për të realizuar normativin e orëve e cila është paraparë me udhëzim administrativ.

Varësisht nga komunat sesi e kanë planifikuar për kompensimin e orëve që të plotësohet normativi, kemi diferenca në mbylljen e vitit shkollor. Por, ka pasur edhe ndërhyrje jozyrtare dhe jolegjislative për të cilat edhe kemi ngritur padi në gjykatë për këta persona.

**KRYESUESI:** Faleminderit! Ganimete e ke një minutë.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, mos ma merr për të keq edhe me tendencë. Thjesht, unë e kam parë si shqetësim të prindërve dhe qytetarëve.

Më intereson ta di se ata mësimdhënës edhe ata që janë treguar të padëgjueshëm, a do të ketë konsekuenca për ta. Pra, cilat do jenë vendimet tuaja si ministri në të ardhmen, sepse nëse këta shkojnë në heshtje pa u ndërmarrë diçka ose pa u ndëshkuar, ose thjeshtë pa u sanksionuar, unë besoj që vitin tjetër do të kemi kaos edhe më të madhe në këtë drejtim.

KRUESUESI: Ministër, një minutë.

MINISTRI SHYQIRI BYTYQI: Tashmë Inspektorati i Arsimit është duke i marrë informacionet nëpër të gjitha DKA-të, dhe varësisht nga informacionet që do t'i kemi nga DKA-të, do të jenë edhe masat ligjore që parashihen me anë të ligjeve që i kemi në fuqi aktualisht.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! Fjalën e ka deputetja Albulena Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Së pari dy ndërhyrje, para së të nisë me temën të cilën do të doja që ta shtjelloja sot.

Për rikujtim të deputetëve të Kuvendit, kjo është hera e parë që po e marr fjalën për të folur për çështjen në të cilën jemi thirru. Ato kanë qenë vetëm replika, kështu që do duhej që të ishit më të vëmendshëm kur jeni këtu në seancë.

Janë dy çështje që po dua paraprakisht t'i adresoj. E para, është lidhur me atë që deputeti Sherifi e përmendi në fillim të fjalës së tij. Pak a shumë kishte kuptimin që Vetëvendosje nuk ka legjitimitet dhe pak a shumë bënte propozime me qëllim që ne t'i marrim parasysh, sepse meqë populli s'i ka përkrahur ato, atëherë pse e duhet t'i marrim parasysh.

Duket që deputeti Sherifi ka harrua që në 2017-ën, Lëvizja Vetëvendosje është konfirmuar si subjekti i parë pas zgjedhjeve të jashtëzakonshme. Por, po ashtu edhe në zgjedhjet lokale e kemi rikonfirmuar fitoren në Prishtinë edhe në Prizren. Për shkak të qeverisjes së Lëvizjes Vetëvendosje në Komunën e Prishtinës, kemi fituar edhe një komunë tjetër, që ishte Prizreni, por edhe Dardana.

Zoti Sherifi, në fakt nuk ka kompetencë të flasë për legjitimitetin, sepse nuk mund të flasë për legjitimitetin një përfaqësues i një subjekti politik, i cili ka qenë pjesë e një koalicioni me diku 50 parti. S'është ky legjitimitet.

Jeni bërë 50 parti bashkë dhe natyrisht se disi fitoni.

Tjetra, kush e ka drejtuar arsimin në Komunën e Prishtinës, u përmenden disa herë. E ka drejtuar Jusuf Thaçi dhe zonja Arbërie Nagavci që është aktualisht deputete e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Ju e dini shumë që dy këta, janë njerëz profesionistë. Janë njerëz të jashtë zakonshëm, të cilët e kanë drejtuar arsimin në Komunën e Prishtinës në mandatin e kaluar, dhe falë tyre, një horizont plotësisht i ri u vendos në rregulla, por edhe në praktika. Dhe, kurrë më parë ato s'i kishim parë.

Lëre në Prishtinë, po në asnjë komunë tjetër.

Plotë profesionistë, plotë studentë, ish-nxënës, plot qytetarë që e kanë parë nga afër sesi është qeverisur drejtoria e arsimit, mezi presin që njerëz të tillë si Arbëria dhe si Jusufi, t'i drejtojnë politikat arsimore në nivel të Kosovës. Kaq, për këto ndërhyrje.

Tash, deputetët e Vetëvendosjes adresuan shumë çështje. Unë do të ndalem specifikisht te tekstet shkollore e që besoj se është jashtëzakonisht e rëndësishme.

Konkretisht me shkelje të rënda ligjore të këtij procesi komplet klientelistë, sepse ky proces ka qenë më tepër tender për përfitime të kompanive ose shtëpive botuese, specifikisht një shtëpie botuese sesa konkurs përmbajtjesor.

Çështja e teksteve shkollore duhet ta marrë vëmendjen e qytetarëve tanë, sepse po bëhet fjalë, pra siç po e përmendi për tekstet shkollore. Neve na vjen mirë që për këtë çështje kanë reaguar edhe shumë profesionistë të fushës dhe organizata të fushës, sepse janë shqetësuar me vet faktin që ministri i Arsimit po bën krim me këto tekste dhe atë në kurriz të fëmijëve tanë.

Duhet që njëherë e mirë të kuptohet, zoti ministër, se librat dhe mësimi nuk janë eksperimente. Ajo se çfarë ka bërë ministri i Arsimit me tekstet, përveç tjerash është siç e thashë, edhe krim edhe skandal.

Pra, botimi i librave të rinj të cilat më shumë janë bërë për t'i dhënë tender klientelës sesa dije nxënëseve.

MASHT-i për të treguar që nuk e ka fare synim zhvillimin e sistemit arsimor në vend, por mirëmbajtjen e kompanive të afërta me pan-qeverinë apo pan-hajninë, jo vetëm që i ka dhënë 80% të këtyre teksteve për botim kompanisë 'Dukagjini', por edhe pas qindra vërejtjeve përbrenda teksteve ka vazhduar punën drejt botimit.

E para, fondi për tekstet shkollore mbërrin një shifër deri në 10 milionë euro. Në listën përfundimtare kanë qenë 46 dorëshkrime, 30 prej tyre i ka fituar shtëpia botuese 'Dukagjini'.

Pra, nuk ia mundësuan, sepse e adresoi Vetëvendosje çështjen e shpronësimit të Ekrem Llukës, 55 milionë euro, por tash po e bartni diku tjetër.

Në raportim para komisionit përkatës, ministri i Arsimit i Shyqiyri Byqyqi deklaroi që tekstet do të pilotohen dhe pastaj do të mund të korrigjohen nëse janë gabim. Ku keni parë more, që të pilotohen tekstet? A keni parë ndonjë vend që tekstet shkollore pilotohen a?

Së pari, kjo tregon për motivin e botimit të këtyre librave që është dhënia e tenderëve për kompaninë në fjalë, dhe së dyti, për qëllimet dhe objektivat që këta pushtetarë kanë për shkencën dhe mësimin. Megjithëse, janë evidentuar gabimet, këta duan ta harxhojnë publike në këto tekste për t'i rikthyer për ribotim më pas.

Si mund të pilotohen tekste me të pavërteta dhe përplot gabime përmbajtjesore didaktike dhe teknike që kanë pasaktësi shkencore e përzierje konceptesh. Për shembull, në librin e gjeografisë të klasës së gjashtë, ka dy shifra për sipërfaqen e rruzullit tokësor, të mbuluar me tokë.

Në faqen 13 thuhet se sipërfaqja e rruzullit tokësor e mbuluar me tokë është 150 milionë kilometra katror, ndërsa në faqen 60 thuhet se kjo sipërfaqe është 149 milionë kilometra katror.

Apo, libri i historisë faqe 34 i klasës së pestë apo shtatë, faqe 56, kontradikta në lidhje me Betejën e Kosovës. Njëri tekst thotë, se beteja u zhvillua në Fushën e Kosovës, që nënkupton një rajon gjeografik shumë të gjerë të Kosovës, kurse tjetri hamendëson se Beteja u zhvillua në Fushë Kosovë, e cila nga të gjithë kuptohet si një qendër komune, pra që është Komuna e Fushë Kosovës.

Njëri thotë se Sulltanin e vrau Milosh Kopiliqi, kurse në librin tjetër thuhet se Sulltanin e vrau Milosh Kopiliqi.

Njëri thotë se vrasësi i Sulltanit është nga fshati Kopiliq i Drenicës, kurse tjetri thotë se, për vrasjen e Sulltanit burimet historike nuk e sqarojnë këtë çështje mirë. Njëri flet për Princin Teodor Muzaka, kurse tjetri për Princin Teodor II Muzaka. Njëri i referohet si princ shqiptar e tjetri si princ arbëror.

Teksti tjetër, gjeografia e klasës së shtatë dhe asaj të nëntës, i referohen përkatësisë kombëtare etnike të boshnjakëve me termin mysliman dhe jo boshnjak. Pastaj, psikologjia që është lëndë shumë e rëndësishme. Veç shihni se çfarë thotë në tekstet që ministri po dëshiron t'i shtyjë përpara; femrat janë më ankthioze, të depresuara dhe kanë vetëbesim paksa më të ulët dhe përfshihen në agresivitet verbal indirekt...

Sinqerisht, kështu shkruan. Pastaj thuhet se meshkujt e rëndomtë, përfshihen në më shumë agresivitet fizik dhe sjellje të rrezikshme dhe në këtë mënyrë bëjnë më shumë krime. Këto po dëshironi që tua mësoni nxënësve tanë?

Përnjëmend ministër, këto po dëshironi tua mësoni nxënësve, fëmijëve tanë? Jo, nuk lejomë. Nuk lejojmë, siqerisht. Pra, ju si ministër duhet të tërhiqeni nga këto tekste të cilat në fillim i kishin, si të themi, 45 ditë në dispozicion që të përpilohen, por më tutje ju ndërhytë dhe të njëjtat ua aprovuan në një vikend diku në bregdet.

Ndoshta keni qenë në bregdetin shqiptar, dhe aty brenda dy ditësh, i keni aprovuar këto tekste.

Në fund, edhe njëherë, tekstet shkollore nuk pilotohen. Të bëhet pilotimi i teksteve shkollore i bie sikurse të pilotohen vaksinat e fëmijëve. A e din se çfarë do të thotë kjo? Për shembull, po i pilotojmë vaksinat e fëmijëve. Po ua japim njëherë, e pastaj shikojmë, nëse ka efekt mirë, nëse s'ë dimë çfarë efekti ka, e pastaj shohim i marrim të tjera dhe i certifikojmë të tjera.

Kjo Qeveri që po jep mësim përditë sesi vidhet buxheti, paraja publike dhe ka imagjinatën e kufizuar vetëm në asfalt, tash është pranë përfundimit edhe të një skandali që do të ketë pasoja të mëdha në mësimnxënie dhe mësimdhënie. Nëpërmjet këtyre teksteve që nuk kanë të bëjnë fare me dijen dhe me shkencën.

Lëvizja Vetëvendosje, kërkon që urgjentisht të anulohet ky botim i këtyre teksteve dhe gjithë procesi të kthehet në pikën zero.

Ministri i Arsimit duhet të japë përgjegjësi ligjore për këtë skandal, për këtë dështim total të përgatitje së teksteve të reja.

Dhe fare në fund, ne si Lëvizje Vetëvendosje përkrahim propozimin e komisionit hetimor, sepse meqë prokuroria nuk po vepron kundrejt këtyre skandaleve të Ministrisë së Arsimit, e vetmja punë që mund të bëjë ose e mirë që mund të bëhet këtu, është formimi i komisionit hetimor, jo vetëm për ta adresuar skandalin me tekstet shkollore, por të gjitha skandalet prej kur në krye të Ministrisë së Arsimit është vendosur Shyqiri Bytyqi. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Bilall Sherifi e ka fjalën. Dy minuta replikë.

**BILALL SHERIFI:** Faleminderit, kryesues!

Po, një përpjekje për t'ia sqaruar kolegje Haxhiu, atë që e thashë.

Po, atë që e thashë edhe qëndroj prapa saj, ngase natyrisht që çdokush ka të drejtë të japë propozime. Natyrisht që ka të drejtë të japë ide, po kur kjo e drejtë për të dhënë propozime kalon



në histeri, për të imponuar qëndrimin e saj, atëherë me automatizëm shkakton edhe bllokim dhe rezistencë në palën tjetër.

Kur propozimet, kritikrat, shqetësimet vinë në mënyrë miqësore, kur ato vijnë me idenë dhe me qëllimin për të kontribuar në përmirësimin e gjendjes, nuk ka njeri, nuk ka deputet këtu që nuk është i hapur për një gjë të tillë.

Madje, në fjalën time përfundimtare në fund, fjalinë time e thashë jemi të hapur dhe Nisma ofrohet për gjithë ata që dëshirojnë të japin ide edhe kontribuojnë për të ndërtuar një strategji nacionale për arsimin. Pra kjo përfshin edhe çerdhet e lartpërmendura, edhe çerdhet e superpolitizuara e superpartizuara.

Pra, çdo gjë që hyn në sistem të arsimit, jemi të gatshëm të ulemi ta bisedojmë.

Mirëpo, unë mendoj dhe vazhdoj të besoj që këtu ose do të ulemi të ndërtojmë një sistem të arsimit që do të sillnin ndryshime rrënjësore, ose sa për të mirëmbajtur këtë sistem jam i sigurt që secila parti veç e veç dhe secili koalicion së bashku si do që të jenë kanë potencial të mjaftueshëm vetë.

Tash sa i përket subjektit më të madh, subjektit më të vogël, nuk shkon kjo kur ju nevojitet për KQZ të keni një vend, dy vende, thoni ju jeni një subjekt, ju PAN-i, ne jemi një subjekt. Pra, ose jeni një atëherë dhe tash, ose jeni dy. Pra, meqë jeni një, i keni dy vende në KQZ, ne si PAN tash jemi një...

*(Ndërprerje nga regjia)*

**KRYESUESI:** Faleminderit! Ministri e ka kërkuar fjalën.  
Urdhëroni, dy minuta!

**MINISTRI SHYQIRI BYTYQI:** E nderuar deputete,  
E para, unë e kuptoj që kjo është fushatë dhe mund të vazhdoni me fushatë. Në fillim theksova se nuk është që ta shndërrojmë në debat politik çështjen e arsimit.

Unë nuk e kuptoj se ku po i gjeni ato leximet që po i bëni tani për libra, po librat asnjëherë nuk janë publikuar, për libra të vjetra kuptoj, edhe klasa e pestë është libër i vjetër, edhe ato që i përmend, librin e vjetër dhe për ata i kemi ndaluar që këto libra më të mos shkojnë te fëmijët tanë.

Libra, flasim për libra të reja dhe që i takojnë nivelit 01, 6, 10,2,7,11 janë të vlerësuara sipas të gjitha procedurave ligjore që parashihen dhe të cilat janë në fuqi dhe të cilat janë të vlerësuara nga recensentët, pra personat që janë profesionalë.

Arsyeja pse ne kemi thënë që këto duhet të shkojnë në pilotim, sepse pasi që ka përfunduar vlerësimi profesional i librave dhe KEPSHT-i i ka propozuar ministrit për libra, të cilat janë tekste të reja, të cilat mund të përdoren, ka pasur të drejtë ligjore që të marrë vendim dhe të përdoren këto libra.

Por, në mënyrë që të ruhet çdo mundësi e gabimeve të mundshme, ne kemi marrë vendim që për një vjet librat të jenë në pilotim, për herë të parë kemi shumë libra të shtëpive botuese që kanë fituar, por nuk e kemi vetëm një shtëpi botuese, ka disa shtëpi botuese për të njëjtin libër të cilën ka fituar.

Dhe, ajo çka ne sigurohemi që personi përgjegjës për përdorimin e një libri është recensenti, recensenti ka dhënë vijën për t'u përdorur një libër dhe nëse ka gabuar shtëpia botuese, autori dhe recensenti, do ta vlerësojnë mësimdhënësit, prindërit, nxënësit gjatë tërë një viti dhe do të japë përgjegjësi recensenti nëse ka bërë gabimisht. Pra, recensenti do të ndiqet në mënyrë penale, sepse në momentin kur është aktivizuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës Teknologjisë, përveç që e ka nënshkruar një kontratë angazhimi, ka nënshkruar dhe fletën e betimit dhe mbi betim ai do të japë përgjegjësi nëse ka vlerësuar që është gabimisht.

Dhe, tani ju të diskutoni për libra të cilat nuk janë publikuar dhe askush nuk e ka materialin, përveç recensentëve...

*(Ndërprerje nga regjia)*

**KRYESUESI:** Faleminderit! Kundër-replikë Albulena Haxhiu.

**ALBULENA HAXHIU:** Faleminderit!

Disa çështje që lidhen me fjalën e ministrit. I kam disa pyetje: kush e ka bërë aprovimin e teksteve? A ka qenë ai Këshilli i ekspertëve për tekstet, domethënë a i kanë aprovuar këto Këshilli i ekspertëve për tekstet?

Tjetra është, si janë përzgjedhur recensentët dhe tjetra është që po të ftoj t'jua sjellësh deputetëve të Kuvendit, të paktën Komisionit për Arsim, nëse jo të gjithëve, ekzemplarët e teksteve këtu në Kuvend ose bëj publike, sepse ju thatë që ku i keni gjetur, i kemi gjetur në forma të ndryshme nga profesionistë që janë larguar nga Këshilli i ekspertëve për tekste. Vetë kanë denoncuar publikisht për gabimet që je duke i bërë, aty i kemi gjetur.

Prandaj, po të ftoj t'i bësh publike këta ekzemplarë....

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Faleminderit! Ministër, një minutë!

MINISTRI SHYQIRI BYTYQI: Të gjitha këto pyetje janë parashtruar edhe nga Komisioni i Arsimit në Parlament dhe i keni përgjigjet, po pavarësisht kësaj, i përgjigjemi.

Ashtu siç është e paraparë me ligj, KEPSHT-i ka marrë vendim për listën finale më 13 qershor për libra të cilat i kanë kaluar standardet dhe iu kanë propozuar ministrit për aprovim, më 13 qershor është finalja.

Ju thoni që anëtarët e KEPSHT-it në mënyrë profesionale i kanë sjellë librat te ju. Asnjë anëtar i KEPSHT-it nuk e ka pasur asnjë dorëshkrim, sepse dorëshkrimi u ka takuar vetëm recensentëve. Çdo dorëshkrim ka qenë i koduar, çdo recensent ka qenë i koduar dhe asnjë anëtar i KEPSHT-it nuk ka pasur asnjëherë dorëshkrim.

Sipas ligjit kërkohet që ministri t'i emërojë recensentët. Për t'u siguruar më tutje, për të shkuar më tutje ministri nuk i ka emëruar, e ka bërë një komision të pavarur, ka bërë ...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Regjia, edhe një minutë ministrit.

MINISTRI SHYQIRI BYTYQI: Secili recensent që ka shprehur gatishmëri të jenë pjesë e recensuarës, kanë sjellë dokumentacionin në Ministrinë e Arsimit dhe komisioni i ka shqyrtuar dhe e ka përzgjedhur listën.

Dhe për herë të parë kemi pasur 5 recensentë, zakonisht kanë qenë 3 recensentë që radhë i kemi pas 5 recensentë, ku është përfshirë edhe psikologu, edhe pedagogu.

KRYESUESI: Fitore Dalipi, dy minuta!

FITORE DALIPI: Unë veç po dua t'i tregoj deputetit të Nismës pse nuk përkrahet një model i tillë është se në çerdhet me bazë në komunitet të gjitha të hyrat që vijnë edhe nga komuna, edhe nga subvencionet, edhe nga donacionet nga jashtë, investohen direkt në çerdhe. Pra, nuk ka përfitues privat, nuk ka mundësi për zhatje të buxhetit, nuk ka mundësi për kontroll, sepse i kontrollojnë prindërit. Pra, për këtë arsye, Nismës nuk i konvenojnë çerdhet e tilla.

Ndërsa vetëm i them ministrin se tash e tutje fëmijët do të kenë detyra jo të llojeve të ndryshme, por vetëm një detyrë. Gjenerali gabimet, sepse po pilotohen librat dhe duhet ata t'i gjejnë gabimet, se librat janë përplot gabime dhe çdo ditë kanë detyra të njëjta.

KRYESUESI: Faleminderit! Time Kadrijaj e ka fjalën.

TIME KADRIJAJ: Kryesues, fillimisht shkon vërejtje për juve, si është e mundur që dikush në këtë parlament, në një debat parlamentar mund të flasë dhjetë herë, asnjëherë nuk ka qenë kjo praktikë sikur tash, unë s'po dua t'i ndiej, dëgjoj, nga 10 minuta, edhe nga 5 minuta, 15 edhe nga 20, ne s'patëm këtu një 3-4 vetë aktorë që patëm në këtë seancë që i dëgjuam, edhe çështja e komisioneve hetimore.

Nuk keni faj opozita, lypni komisione hetimore, punën e deputetit nuk jeni kah e kryeni, po vini, po merrni mëditje, nuk po votoni asnjë projektligj, tash veç duam t'ju bëjmë prokurorë dhe gjykatës, s'ju ka mbetur tjetër, se punën e deputetit nuk jeni duke e marrë seriozisht, tash ju bëjmë dhe s'kini çka, veç lypni, lypni prapë debatin nesër çka është, veç me komisione hetimore.

Absurditeti i seancave të jashtëzakonshme. E kishim seancën e jashtëzakonshme paradite që rezultoi me një votim, që bile i përkrahëm sportistëve dhe artistë që është një e arritur.

Ndërsa sot në këtë seancë të jashtëzakonshme çka ka pasur të jashtëzakonshme, ku janë deputetët, ku janë deputetët nëse ka qenë i jashtëzakonshme, u thirr me një urgjencë të tillë, ku janë deputetët? Dhe çka dëgjuam, dëgjuam se cila komunë po menaxhon arsimin më mirë, cila komunë i ka ekspertët më të mirë, cila ka hapur çerdhe më shumë në komunitet, në baza komunitet se e ka dikush mani ato, dhe kurrëgjë tjetër nuk dëgjuam.

Është shumë në rregull, s'kam përmendur emra. S'ka të drejtë askush ta marrë fjalën përderisa s'kam përmendur emra, se u bëre bajat sot, 100 herë të dëgjova e nuk fole asgjë të hairit.

Mund të thirrni debate, është e arsyeshme, edhe debat për arsim, edhe debat për shëndetësi. Nëse jemi të brengosur për gjendjen në arsim e shëndetësi, është në rregull, po cilat janë rekomandimet? Çka do të themi në fund të këtij debati, çka thamë dhe cilat konkluzione i arritëm, cilat rekomandime janë nëse kemi qenë të shqetësuar për gjendjen në arsim, për gjendjen në shëndetësi apo gjendje të tjera.

Njëra prej kolegeve tha se një parti politike këtu është e mësuar ajo veç me etiketime, PAN hajnia, po për besë, unë s'kisha pasur qejf të jem pjesë e partisë së tyre.

Pas atyre ngjarjeve që kanë ndodhur në atë parti që vetë i kanë elaboruar nëpër emisione televizive, unë se di si ka prind normal që ka qejf ta ketë fëmijën në atë parti, bile, bile, secilën ndoshta prej këtyre partive të tjera kisha pasur qejf të jem pjesë, po jo pjesë e asaj partie politike.

Nuk e di ku doni, në fund të gjitha këto rekomandime që po doni dhe po i jepni këto komisione, po me çka doni t'i votoni, ata ndoshta se ua keni mundësuar deputetëve ju të opozitës të votojnë prej shtëpie, ndoshta u thirrini në telefon dhe e japin votën, thonë që po votojmë për formimin e një komisioni parlamentar, se po jap votën për rekomandime. Amon na keni lodhur me këto seanca të jashtëzakonshme. Nëse nuk keni deputetë dhe nuk rrini në sallë t'i dëgjoni debatet në fillim, ato debate që i thirrni vetë, mos i thirrni hiç, bile, mos na maltretoni as neve, po as opinionin e gjerë. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Shemsi Sylja.

**SHEMSI SYLA:** Zoti kryesues, përshëndetje zoti ministër,

Të nderuar deputetë,

Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës,

Çdo veprim institucional pas luftës në sistemin e arsimit është bërë pa koncept. Pa e ditur çka duam, duke iu nënshtuar politizimit më vulgar të mundshëm në të gjitha nivelet dhe interesave materiale multimilionëshe të klasës në pushtet, pa përjashtim kush e ka pasur pushtetin.

Të parët në Ballkan aplikua sistemin nëntëvjeçar, se ashtu e kishte edhe tërë Evropa dhe e morëm hiç më pak si model, se sa sistemin suedez që edhe ata vetë më vonë thanë se nuk ishte i përshtatshëm as për shoqërinë suedeze.

Pra, sistemi ynë arsimor u bë i njëjtë me sistemet arsimore të vendeve më të avancuara të Evropës. Kuptohet vetëm në letër, jo edhe në përmbajtje.

U fol për metoda interaktive, nxënësi në qendër, mësimi lojë, sikurse ne po fillonim një shkollë për herë të parë, e jo që kishim përvojë goxha të gjatë dhe një sistem arsimit klasik që deri në kohët tona është dëshmuar si sistem më i suksesshëm kudo në botë.

Dhe kështu, në emër të metodës nga sistemi shkollor fillimisht u hoq edukata, pastaj mësimi elementar i të shkruari të germave dhe të numrave, tabela e shumëzimit dhe u tha se tani e tutje sistemi ynë arsimor ka prioritet teknologjinë informative dhe mësimin e gjuhës angleze dhe nxënësi i Kosovës nuk ka nevojë as për edukatë, as për njohuri elementare.

Gjendja shkoi deri aty sa ministrat e Arsimit, sistemin arsimor të Kosovës e shpallën 'luginë silikoni', që domethënë gjithçka do të shkëlqejë, kurse më vonë aspiratat u rritën aq shumë sa

sistemi arsimor dhe përtej kësaj Kosovën e shpallën shtet i dijes, po për dreq doli ai testi PISA, na e nxori gjumin dhe pamë se dija që prodhon shkolla jonë është në fund të dynjasë.

Të nderuar deputetë,

Fillimisht arsimi parashkollor nuk e kryen rolin e vet themelor që është pjesë e edukimit dhe e socializimit.

Çerdhet publike janë thujse të rezervuara për grupe të caktuara, kurse çerdhet private janë biznes i pastër dhe më shumë kanë rolin e strehimoreve për fëmijë, e të mos flasim për literaturën.

Kurse arsimit parauniversitar i paraprin reforma pa koncept. Kurikula është kopje nga shumë sisteme arsimore të vendeve shumë të zhvilluara, kryesisht atyre skandinave që nuk janë në harmoni ndërmjet veti.

Janë marrë modele që nuk i përshtaten realitetit, kulturës, dijes dhe gjendjes sonë ekonomike e sociale. Nuk bëhet lidhja e praktikës me terinë, prandaj kemi këso shkolla të larta të analfabetëve funksionalë. Pothuaj edhe në metodologjinë e mësimdhënies janë futur metoda të reja të vendeve më të avancuara, pa asnjë përgatitje të mësimdhënësve dhe sado që ato metodologji thonë se mësimi duhet bërë përmes veprimit praktik, në rastin e shkollave tona mësuesi vepron vetëm me fjalë, pa u demonstruar asgjë nxënësve, kurse ironia është te trajnimet e mësimdhënësve, ku mësuesin me fakultet e magjistraturë e trajnon ndonjë përfaqësues i shoqërisë civile, OJQ-ve me shkollë të mesme, por që ka lidhje me institucionet arsimore dhe me fondacionet e ndryshme nga jashtë.

Po ashtu, tekstet shkollore janë për 'ibret' dhe janë hartuar nga joprofesionistët, por nga miqtë e jaranët e strukturave politike në pushtet dhe me tekste është bërë një biznes shumë fitimprurës, e me gjasë, siç shihet, e njëjta gjë ka ndodhur edhe tash me hartimin e botimeve të teksteve të reja. Dhe për të vajtur tek ajo më e rënda në lëndët nacionale, konkretisht në letërsi dhe histori, nxënësi i fillorës duhet të mësojë për anaforen, kurse nga programi janë hequr poetët dhe shkrimtarët e traditës, si: Kristoforidhi, Çajupi, Gramenoja, Ali Asllani, Risto Siliqi, Filip Shiroka, Luigj Gurakuqi e të tjerë. Edhe lënda e historisë mësohet copa-copa, dhe disa periudha shumë të rëndësishme të historisë tonë kombëtare në Kosovë janë anashkaluar, lëvizjet e organizimet ilegale që në periudhën pas Luftës së Dytë Botërore në Kosovë organizuan dy demonstratat më të rëndësishme, që ndërruan epokë e që ndërruan rrjedhën historike, siç janë demonstratat e vitit 1968 dhe ato të vitit 1981, kanë protagonistët e tyre, kemi një armatë të tërë të të burgosurve politikë, pjesëtarë e themelues të këtyre lëvizjeve ilegale që nuk mësohen fare nga fëmijët tanë. Por, çka është edhe më e rëndë fakti tjetër, kanë kaluar 20 vjet nga lufta e Ushtrisë Çlirimtare e Kosovës dhe ende nuk kemi një trajtim historik adekuat as sa u takon

figurave historike të kësaj lufte, e as atyre kryesore, as vetë luftës si akt heroizmi për çlirim kombëtar për liri e pavarësi.

Të nderuar deputetë,

Atdhedashuria dhe patriotizmi në çdo shoqëri moderne kultivohet. Askush nuk lind patriot, por është familja, shkolla dhe institucionet e tjera relevante që e kultivojnë patriotizmin dhe dashurinë ndaj atdheut të rinjtë. Në shkollat tona kjo qasje mungon, në këto 20 vjet kanë dalë gjenerata të tëra të rinjve tanë që nuk e njohin historinë, kulturën, letërsinë, artin e sakrificën e lirisë e të pavarësisë që ka bërë ky popull. Kjo mungesë ka prodhuar gjenerata të tëra pa asnjë ndjesi kombëtare, prandaj edhe ikja e të rinjve nga Kosova është kaq masive.

Dhe, krejt në fund, para jush të nderuar deputetë, po jap një shembull ekstrem se në çfarë niveli të dijes kanë mësimdhënësit dhe çfarë niveli të dijes e të shkollimit kemi në shkollat tona. Para disa ditësh gjatë një bisede me disa miq të mi që janë njohës bukur mirë të sistemit arsimor, por edhe bartin përvoja të gjata në sistemin e shkollimit, e nxita debatin lidhur me problematikën e arsimit në Kosovë. Secili prej tyre fliste me një shqetësim të madh, por edhe ofronin zgjidhje, kurse për të argumentuar se deri në çfarë shkalle ka arritur degradimi i sistemit arsimor, njëri nga bashkëfolësit tregoi një rast se si një arsimitare e lëndës së gjeografisë, në një shkollë të një qyteze në Kosovë, nuk ka ditur t'u tregojë nxënësve të saj se me cilat shtete kufizohet Kosova. Pra, ky është prototipi i analfabetit funksional që prodhojnë universitetet e kolegjet e arsimit në Kosovë, që për fat të keq, është edhe mësimdhënësi. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Enver Hoti.

**ENVER HOTI:** Faleminderit, i nderuar kryesues! Me të vërtetë gjatë gjithë këtij debati u pa që nuk ka qenë seanca për t'u thirrur e jashtëzakonshme, ka mundur të thirrej një seancë krejtësisht e qetë, e mirë për t'u debatuar një temë, e cila na rëndon që sa vjet, së paku që 20 vite e këndeje siç është situata në arsim.

Dëgjuam lloj-lloj hapje të debateve nga kolegët e mi deputetë, duke filluar me të dashur, të çerdhes atje, të dashur qytetarë, e krejtësisht e ka një emërues të përbashkët, e dashura votë. Po e them kështu, sepse i gjithë debati, i cili e pati për qëllim edhe e ka për qëllim, është thirrur të debatojë një temë e cila ka të bëjë me të tashmen e shumë më shumë me të ardhmen tonë si komb, si gjeneratë e re, si popull, si vend, institucione, u degradojmë nga disa pjesë, të cilat dikush deshi të marrë flamurin dhe të tregojë se sa çerdhe i ka ndërtuar, sa aktivitetet i ka ndërmarrë, sa ka pasur mundësi të marrë informacione, ndoshta në rrugë të ndryshme formale dhe joformale, brenda institucioneve të vendit, brenda Ministrisë së Arsimit dhe e gjitha kjo për t'u përkthyer në një betejë elektorale, për të fituar një votë më shumë apo një realitet dhe fare nuk u diskutua për boshtin e temës që do të duhej të ishte, sistemi arsimor.

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë dua të falënderoj edhe zotin Sherifi, edhe zotin Gorani që tentuan me fjalën e tyre ta zhvendosin debatin, ta vënë debatin në binarë, në binarë të cilët neve si deputetë na ka hije, ajo është për ta diskutuar, debatuar gjendjen në sistemin e arsimit që shumë pak ose fare nuk ka ndikim ose nuk ka pasur ndikim në ngritjen e këtij sistemi ministri aktual dhe qeveria aktuale. Ky sistem, të cilin e ka trashëguar ministri Bytyqi dhe kjo qeveri tani, kjo ministri në kabinetin e tij ka trashëguar një mundësi të sistemit ku të gjithë në Kosovë janë me diploma, të gjithëve u është mundësuar të jenë njerëz të diplomuar, e çka kanë ndodhur, cilat janë pasojat. Pasojat, unë mendoj se janë edhe në familje, edhe për ata individë, shumë të rinj e të reja, të cilët i kanë marrë ato diploma dhe kanë shpresuar se me ato diploma do ta lehtësojnë jetën e vet, do të gjejnë mundësi të jetojnë në vendin e tyre, në shtëpitë e tyre, në familjet e tyre, unë mendoj se pasojat janë dy: njëra është që me investimin në ta është varfëruar buxheti familjar i atyre familjeve dhe ata të rinj e kanë një diplomë dhe një rrugë për të ikur nga vendi i tyre, kjo duhet të na shqetësojë neve, sepse nuk janë aftësuar, nuk janë ngritur dhe nuk kemi krijuar një sistem, i cili mund të ishte i dallueshëm kush është ai që do të duhej të shkojë në segmente të niveleve akademike dhe që do të jetë shtyllë dhe bartës i procesit dhe institucioneve për zhvillimin e vendit dhe cila është ajo strukturë, ajo kategori e fëmijëve, të rinjve, të cilët duhet të përgatiten për tregun dhe për ekonominë aktuale, qoftë të brendshme, qoftë në nivel të jashtëm.

Prandaj, ministër, unë e di që ke pranuar goditje të mëdha dhe do të pranosh, tentativa juaj, duke filluar nga ristrukturimi në ministri u pa që këtu u kritikua shumë dhe u kritikua nga ata, të cilët edhe e kritikojnë sistemin, edhe bëjnë thirrje që të ruhet çdo gjendje, e cila është qoftë në ministri, qoftë në sistemin e arsimit dhe pse, sepse po i mbron interesat e kategorive të caktuara, brenda sistemit të arsimit dhe jashtë sistemit të arsimit që bukur shumë kanë interesa në aspektin material dhe financiar, këtu nuk ka asnjë dilemë. Prandaj, unë po them që një pjesë ndoshta e deputetëve, kolegëve deputetë nga PDK-ja dhe nga LDK-ja, më së paku kanë pasur të drejtë të ngrenë zërin për t'ju kritikuar juve. Ata kanë shumë fakte ndoshta nxjerrin shumë elemente për t'ju godit dhe a di pse, sepse ata e kanë sakatuar sistemin e drejtësisë dhe tani ai nga sakatim që ia kanë bërë sistemit të drejtësisë, i nxjerrin ato elemente të këqija, të cilët janë përgjegjës vetë që i kanë ndërtuar dhe të godasin ty. Unë do të them që nuk je duke bërë ndoshta punën më të mirë të mundshme, por së paku janë marrë disa iniciativa nga ju për t'i dhënë një drejtim tjetër dhe për t'ju qasur një reforme në sistemin e arsimit, por pengesat janë edhe të brendshme, edhe janë jashtë institucionit, janë politike, janë për interesa të ndryshme. Nëse ne duam që t'i qasemi në mënyrë serioze për të bërë një reformë të thellë që është aq e domosdoshme në sistemin e arsimit, duhet t'i kemi së paku tri kushte: të kemi një vullnet politik, një guxim intelektual dhe një mbështetje të jashtëzakonshme financiare edhe nga Qeveria aktuale, por edhe nga qeveria kushdo që do të vijë në të ardhmen.

Prandaj, ky debat i cili edhe një herë po kthehem në fillim ku e nisa fjalën time, duke e provuar që të ngre apo të jetë ai më meritori, qoftë duke e menaxhuar arsimin në ndonjë komunë apo



duke e marrë iniciativën për të ndërtuar ndonjë çerdhe ose ndonjë fushë të sportit, mendoj që me të vërtetë ka degraduar dhe ku shihet qartë se opozita aktuale nuk ka ndonjë kauzë, nuk ka ndonjë qëllim në vetvete për të bërë një opozitarizëm efektiv, efikas dhe të domosdoshme që është aq i nevojshëm në Kosovë, por kthehet në seanca të jashtëzakonshme dhe mandej ato seanca as nuk i përfill vetë, as nuk i përmbahet temës për çka e ka dhe del krejtësisht nga binaret për çka e ka ftuar seancën. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, Enver! Po tipi i opozitës që po kërkoni ju bëhet kur ka shumicë, kemi probleme të tjera. Fjalën e ka deputeti Bekim Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Po filloj me atë që është thirrur kjo seancë e jashtëzakonshme dhe në parim, jo seanca të jashtëzakonshme, por për gjendjen në arsim mendoj që ne duhet mbajtur seanca të rregullta, edhe atë ndoshta në fillim çdo muaj, sepse gjithë këto pa dallim jo sot, por prej vitit 2011 kur jam deputet, kam ngritur shqetësimet e mia për gjendjen në arsim. Edhe rezultatet e PISA-s e kanë dëshmuar një gjë të tillë se nuk jemi mirë me arsimin, e kam thënë edhe atëherë, ka qenë një guxim i ministrit të kaluar të hyjë në projektin e PISA-s, e cila na ka nxjerrë ashtu si jemi, pra do të thotë jo mirë.

Pra, ne nuk mund ta fajësuar tash pasqyrën pse s'dukemi mirë, por duhet përmirësuar aty ku nuk dukemi mirë dhe ta përmirësojmë gjendjen. Nuk mund të themi nëse dikush e kritikon ministrin e Arsimit për gjendjen në arsim, e të thuash po e godet ministrin. Jo, kritika e ka qëllimin ta përmirësojmë gjendjen në arsim.

I nderuar Enver, edhe kur Partia Demokratike ka udhëhequr me Ministrinë e Arsimit, kam bërë vërejtjen, për më keq, Enver, një prej vërejtjeve të mia kanë qenë çantat e rënda shkollore të fëmijëve, në vitin 2011 e kam ngritur si shqetësim, sot jemi në 2019-ën, as ai ministri i PDK-së, e as ky i Nismës, asnjëri s'e ka zgjidhur dhe e kam hequr edhe si kërkesë më në pyetje parlamentare për ministra të Arsimit. Paramendojeni ne për 9 vjet nuk kemi qenë në gjendje ta përmirësojmë ose ta zvogëlojmë peshën e çantave të fëmijëve. Çka duam të përmirësojmë? Pra, duke bërë politikë njëri me tjetrin, dikush mendon që e ka një model të çerdheve më të mira në Prizren, tjetri mendon që e ka në Prishtinë dhe kemi debatuar nja gjysmë dite këtu për një çerdhe në Malishevë, mandatet e kaluara, e mbaj mend se kam qenë pjesë e këtij Parlamenti.

Por, paraprakisht, i nderuar ministër i Arsimit, përpara se të vihej te procesi i botimit të teksteve shkollore, cilin model të arsimit duam ta implementojmë në Kosovë, për arsye se prej atij administratorit të parë të UNMIK-ut që ka qenë për fushën e arsimit e deri sot ne ende nuk e kemi të qartë se cilin model të arsimit duam ta implementojmë në Kosovë. Kemi filluar me

modelin gjerman, pastaj e përziejme me slloven, pastaj me shtetet skandinave, kanë marrë një pjesë të arsimitarëve i kanë dërguar në trajnime në Finlandë, disa të tjerë në vende të tjera në Suedi, të tjerë pastaj në Holandë e Belgjikë, e në fakt, sistemi i arsimit, mënyrat përbëjnë një mish-mash të tërë.

Nuk ka një model, i cili fillon prej arsimit fillor deri te ai universitar e të dimë se cilin model po e ndjekim, sepse ne që jemi këtu, shumica prej nesh e ka vazhduar ose ka përfunduar studimet e një modeli krejt tjetër, prej sistemit të kaluar kemi filluar me modelin austriak dhe rus, ku ka pasur shumë më shumë lexim se sa punë praktike, ndërsa tani cilin model po duam? Të fokusohemi, e duam modelin finlandez, fillojmë me modelin e sistemit arsimor finlandez prej çerdhes e deri në universitet. Po duam me modelin gjerman, po e vazhdojmë, apo me slloven, të përcaktohem cilin model të arsimit duam ta bëjmë, e pastaj po vazhdojmë tutje. Tekstet, i nderuar koleg Enver, edhe në të kaluarën këtu kam filluar debatin për një libër të historisë së klasës së pestë, në vitin 2011, ku vetëm tre rreshta i kushtoheshin luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe komandantit legjendar Adem Jashari, por i kushtoheshin 5-6 faqe konstituimit të institucioneve të UNMIK-ut, të pasluftës, e Kuvendit të parë, të dytë e tretë, por jo edhe historisë së vërtetë të popullit shqiptar, historisë më të re.

Pra, a duhet vërtet të vazhdojnë këto debate dhe iniciativat t'i përdorim vetëm për qëllime politike apo duam vetëm ta ndërrojmë pak, edhe ne si deputetë, edhe si parlamentarë, mënyrën e komunikimit me ministrinë, që ta kritikojmë me qëllim që ta përmirësojmë, sepse në zgjedhjet e fundit lokale në shumicën e komunave pat një ndryshim të kryetarëve të komunave. Po cila është mënyra si ata kanë vendosur në sistemin e arsimit? A hoqën dorë ata nga politizimi? A i vendosin kryetarët e komunave sot në Kosovë drejtorët e shkollave? Në 99% vetëm nëse ik rastësisht ndonjë që s'e ka marrë vesh, se në 99% kryetarët e komunave i vendosin drejtorët e shkollave. Derisa kryetarët e komunave vendosin se kush ka për të qenë drejtor i shkollës fillore e të mesme, nuk mund të presim shumë që do ta kemi një arsim të mirë, në veçanti kur flasim për arsimin fillor dhe arsimin parauniversitar.

Pra, nëse ne dëshirojmë ta bëjmë një sistem të arsimit të mirëfilltë, atëherë hajde ta marrim sistemin gjerman, ku nuk mund të jesh as inspektor i arsimit e as drejtor shkolle, nëse nuk ke të paktën dhjetë vjet përvojë pune në arsim. Po ne, puna e parë e shumë drejtorëve të shkollave është në arsim. Ndodh që largohet nga puna një drejtor i suksesshëm e vjen një tjetër, i cili asnjëherë nuk ka punuar në sistemin arsimor dhe për herë të parë punën e tij e fillon si drejtor shkolle. Ne duhet t'i përcaktojmë këto kritere.

I nderuar ministër, edhe kur keni sjellë Ligjin e arsimit të lartë për shkak se ai ligj nuk votohet nga deputetët e minoritetit serb, për shkak se edhe duhen 2/3-tat e shumicës së kualifikuar, domethënë se atëherë ne kemi mundësi tjetër me e bë. Hajde silli statutet e universiteteve publike dhe përmes tyre reformën të cilën mendon me e implementua në arsim, atëherë bëhet ato kritere

që ke paraparë në ligj të bëhen përmes statuteve, sepse statutet e universiteteve janë ato që japin legjitimitet funksionimit të çdo universiteti publik.

Sigurisht se ne duhet të reflektojmë në zhvillimin e teknologjisë informative, në atë që edhe sot sepse nuk mund të pretendojmë të kemi shkolla aty kur kishte shumë vite më parë, për shkak të lëvizjes së popullsisë por se si duhet me e përmirësua këtë dhe vërtet si duhet avancuar arsimin neve na duhet një debat shumë konstruktiv në mes partive politike. Ndoshta-ndoshta, për t'u ikur nga pak këtyre koordinacioneve politike ose nganjëherë dëshirës për të mbledhur vota ose për të fituar poenë politike një subjekt apo subjekt tjetër ndoshta edhe me debatua grupi i ekspertëve të të gjitha partive politike edhe në ambiente pa medie, ku mund të debatohet vetëm në aspekte profesionale kishte me qenë shumë e leverdishme, se sa mënyra që fillojmë një iniciativë pastaj ajo iniciativë prej iniciativës për të diskutuar dhe për të zgjidhur problemet të cilat duhet me u zgjedh kalohet në iniciativë krejt puro politike. Pastaj, kalohet edhe në debate krejt personale dhe humb kuptimi i esencës së asaj për çfarë e kemi filluar një iniciativë ose një debat fillestar.

Kritikën nuk duhet me e marrë si goditje, por si një tentativë për ta përmirësuar e në veçanti kur këtu ka debat konstruktiv dhe qëllimshëm dhe asnjëherë, sepse asnjë parti e vetme nuk ka udhëhequr në Kosovë, as PDK-ja e as LDK-ja. Edhe në atë kohën kur dikush pretendon me e kritikua ka pasur pothuajse edhe liderë të subjektit që i takojnë kanë qenë pjesë e asaj partie politike e i kanë bërë bazat e këtij sistemi arsimor. Po çka është që ky sistem arsimor nuk po funksionon, nuk po jep rezultatet e duhura dhe këtu na duhet një konsensus i përbashkët pa ngjyrimë politike, vetëm në aspektin profesional Nuk mund ministri t' nxjerrë librat më të mirë, por ekspertët më të mirë mund t'i nxjerrin librat më të mirë. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Deputeti Enver Hoti, replikë dy minuta!

**ENVER HOTI:** Faleminderit, kryesuese!

I nderuar zoti Haxhiu,

Është e vërtetë që ndoshta e keni ngritur, nuk e di, temën shumë herë duke filluar nga ato pesha e atyre çantave që i bartin nxënësit, por ne kemi nevojë të dalim përtej një ngritjeje të një shqetësimi që ngrit deputeti. Ne jemi aty ku e përfunduat fjalën edhe ju, që jeni për një konsensus të gjerë nacional për të bërë një reformë të thellë në sistemin e arsimit.

Përgjegjësit e këtij sistemi të arsimit, i cili nuk po funksionon dhe më vjen mirë që edhe ju e pranuat se nuk po funksionon, dihen. Kanë adresë dhe dihet kush janë, por është momenti i fundit që ne të arrijmë me një konsensus nacional për të bërë një reformë të thellë në sistemin e arsimit. Nisma si parti dhe si udhëheqëse e Ministrisë së Arsimit është e gatshme kurdo dhe sido që të arrijmë atë konsensus. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Bekim Haxhiu kundër-replikë, një minutë!

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryesues dhe Enver!

Vetëm po dua ta potencoj një fakt, që çdo kryetar komune, ose kandidat për kryetar komune në fushatë thotë që ka me bë reformë në arsim edhe e ka arsimin prioritet. Në momentin që e merr detyrën fillon me i vendos njerëzit e vet. Pra, konsensusin po e kërkojmë për të bërë reformë, por jo që kjo reformë të përdoret nga ministri për pastrime politike, por reformë për qëllim të përmirësimit në sektorin e arsimit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Sami Kurteshi.

SAMI KURTESHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuara kolege dhe kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Unë do të filloj nga e veçanta me metodën logjike të induksionit e të shkoj te e përgjithshmja, ndoshta nxjerr ndonjë konstatim, një. Dhe e dyta, nuk do të merrem me nivele tjera të arsimit, por vetëm me nivelin e arsimit të lartë.

Po e filloj nga shumë e veçanta, një mësimdhënëse universitare e re që ka ardhur rishtazi me shumë probleme në universitetin e Prishtinës shkruan kështu: Mbas leximit dhe komentimit të më tepër se 50 punimeve seminarike që studentët i kanë punuar në grupe, mund të them veç diçka: Fakultetit Juridik në Prishtinë i duhet urgjentisht një lëndë për metodologjinë e hulumtimit dhe shkrimit akademik në vitin e parë të studimeve, urgjentisht. Studentët nuk dinë të shkruajnë. Kjo e ka fjalën për studentë të viteve të larta, sepse atëherë fillojnë me punime seminarike dhe me mësimin e metodave shkencore.

Po kaloj në një nivel pak më shumë, por kjo ka të bëjë vetëm me arsimin e lartë. Një letër e studentëve që unë e kam këtu, me disa vërejtje, unë po i lexoj vetëm vërejtjet në përgjithësi. Thotë, sistemi ynë (unë vetëm po e përkthej pak) merret vetëm me mësim, me mësimnxënie, nuk merret më me krijim të dijes, me studime. Domethënë, është ende niveli para humboltian i universiteteve tona, ne nuk kemi universitete, as në kuptimin e mirëfilltë të fjalës, as pa kuptimin e mirëfilltë. Thotë, asnjë studiues që vjen nga mërgata nuk ka proceduralisht të hapura dyert e universiteteve, ose ka shumë vështirësi me u integrua këtu. Është çështja e konkurrencës natyrisht.

Nuk ka universitetet, ose universiteti, nuk ka shtëpi të veten botuese. Kush do i boton tekstet universitare, munden edhe mësimdhënësit vetë, po s'ka. Nuk ka kushte për hulumtime shkencore, hiç s'ka. Mungesa e literaturës adekuate edhe tekste universitare në gjuhën shqipe, mungesa e laboratorëve, mungesa e praktikës për shumë programe të fakulteteve, në të vërtet nuk e di a ka ndonjë fakultet ndonjë program për praktikë, po edhe nëse ka janë minimale. Avancimet në baza klienteliste dhe jomeritore të profesorëve, uzurpimi i hapësirës dhe resurseve publike edhe ashtu të mangëta nga kolegjet private me numër enorm të studentëve, mandej thonë

mungesa e kushteve në biblioteka edhe kushtet e këqija edhe pak vend, mungesa e profesorëve në ligjërata, vetëm shënohen, i marrin të hollat edhe nuk shkojnë gati kurrë. Studentët nuk i njohin profesorët e tyre. Pabarazia dhe privilegjet e ndryshme, sidomos kanë vërejtje me fëmijët e mësimdhënësve në universitete, që dallohen në mënyrë brutale nga studentët e zakonshëm. Dallimi i madh në raportin mësimdhënës - vlerësim, domethënë se nuk shkojnë mësimdhënësit, profesorët nuk shkojnë me i vlerësua studentët, e çojnë aty një asistent. Lidhja e ekonomisë edhe e studimeve nuk është.

Kjo është gjendja për universitetin e Prishtinës. Merreni me mend si duhet të jetë gjendja në universitetet tjera private, që janë në gjendje të mjerueshme.

Tash po dal në nivel pak më lart. Edhe ai nivel pak më lart nga një studim i vitit 2018 del kështu:

- se në Universitetin e Prishtinës relacioni profesor - student është 1 : 58, larg më i madhi në krejt Evropën, edhe në rajon edhe në Evropë, e në Botë duhet të jetë diku rreth nivelizimit me PIZ-ën e ajo është domethënë vendi i tretë në botë nga fundi;

- nga 465 profesorë 41 i kanë justifikuar titujt sipas kriterit të punimeve shkencore, kurse 59% nuk i kanë plotësuar këto kushte, ata punojnë në universitet, kjo është për shumicën;

- sot kemi profesorë, nja 16 prej tyre, së paku, të stafit akademik të cilëve u janë dëshmuar plagjiaturat dhe ata ende punojnë;

- problemi i mësimdhënies në tri-katër institucione të arsimit të lartë, s'po i quaj tash universitete, është një dukuri e shprehur, sepse një profesor mundet deri në 4 universitete të punojë, sepse është "gjeni" edhe këtu te ne numri i madh i "gjenive" është shumë i madh, vetëm se cilësia arsimit e edukimit e mos të flas për universitetet, nuk është kurrkund;

- te ne nuk ka universitete që krijojnë dije, ose së paku krijojnë njerëz që janë të aftë të punojnë sipas metodave shkencore, ende u japin mësim, ende nuk dinë të shkruajnë studentët një punim shkencor;

Tash të kaloj në një nivel pak më të lartë, se unë thash do të punoj me metodën e induksionit, për ta parë si është gjendja. Gjendja është kështu:

- në kërkime shkencore nga plani strategjik i Universitetit të Prishtinës, në vitin 2010 janë shpenzuar 100 000 euro nga 1 milionë, 1/10-ta; në vitin 2011 - 200 000 euro nga 2,4 milionë; në vitin 2012 - nga 3,5 milionë janë shpenzuar diku rreth 500 000, pak më pak, po aty po e marr. Edhe këto në të shumtën e rasteve janë shfrytëzuar nga profesorët për ngritje të ndryshme, por

kur e hap faqen e Universitetit të Prishtinës, se të këtyre tjerave s'po i hap, nuk ka asnjë projekt të hulumtimit shkencor.

Do të thotë edhe ato pak mjete e ato pak mjete për me ua shpjegua kolegëve të mi, për kërkime shkencore në Universitetin e Prishtinës edhe në Kosovë janë 0,1% të buxhetit shtetëror, 0,1% kaq jepen.

Nuk po flas për projekte shkencore se s'ka të tilla, fatkeqësisht nuk ka të tilla. Unë s'mund të flas për diçka që nuk ekziston, nuk mundem. Po si është gjendja? A ka synime për përmirësim? Jo, nuk ka synime për përmirësim.

Unë e shoh buxhetin e Kosovës për vitin 2019 edhe Ministrisë së Arsimit, janë ndarë për vitin 2019 73 milionë, për 2020 71 milionë edhe për vitin 2021, 71,7 - 71,9, a është ashtu zoti ministër?

Mirëpo, çka është interesante, për arsimin e lartë dhe shkencën ku futen edhe hulumtimet shkencore, në të vërtet kemi kështu: kemi 28 milionë, gjithçka që lidhet me arsimin e lartë, me hulumtimet shkencore, do të thotë për tri vjetët e ardhshme, pse për dy vjetët e ardhshme nuk ka asnjë ngritje.

Zoti ministër, nuk po ju bëj juve fajtor, sepse ju s'keni vendosur për këtë buxhet edhe s'keni vendosur për këtë gjendje. Ndoshta, mund të vendosi për disa gjëra pak më të vogla, por nuk e di a keni vullnetin, a s'e keni? Po problemi është pak më i madh. Problemi është aq më i madh për arsye se këtu dhjetë herë më së paku u përmend, thotë seancë të jashtëzakonshme për arsimin. Në këtë vit, ne i kemi pasur vetëm katër seanca të rregullta. Krejt të tjerat kanë qenë të jashtëzakonshme. Meqenëse nuk po organizohen seanca të rregullta, po organizohen seanca të jashtëzakonshme. Nuk organizohen seanca të zakonshme për shëndetësinë, për dështimet në shëndetësi, në arsim, në drejtësi, në ekonomi, prandaj kërkohen për shkelje, edhe ato kur bëhen, kur marrin karakterin kriminal, të organizohen seanca të jashtëzakonshme. Fatkeqësi është kjo. Mirëpo, është gjendja kështu.

Edhe, krejt për fund. Sot paradite i pash plot aty në atë lozhën aty njerëz që kishin ardhur për një amendament për Ligjin për sportin, për sponsorizimin. Për arsimin s'e shoh askënd, hiç askënd. Edhe ne si shoqëri çka po dëshmojmë, mos e merr veç ç[r vete zoti ministër, ti je pjesë e kreut, ne po dëshmojmë se jemi shoqëri që jemi të interesuar të investojmë dhe të sponsorizojmë asfaltin edhe muskujt, për tru nuk na e ndien hiç. Gjendja në sallë tash, edhe gjendja në lozhë në të vërtet tregon disponimin shoqëror sa jemi të interesuar për zhvillimin e mendjes edhe të trurit në këtë vend. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Tani fjalën e ka deputeti Daut Haradinaj.

**DAUT HARADINAJ:** Faleminderit, nënkryetar!

Unë nuk e pata në plan të flas, po meqenëse është debat, atëherë shumë shkurt, nëse e shohim me statistika përgjegjësinë e menaxhimit në arsim, prej pasluftës e sot, përgjegjësitë janë bukur të shpërndara, qoftë në nivelin nacional, qoftë edhe në nivelin komunal e tutje. Pra, kjo i bie që jo detyrimisht përgjegjësia shkon direkt te ministri, kur e dimë shumë mirë që arsimit në nivel komunale menaxhojnë komunat dhe në këtë rast i bie drejtpërdrejt, shumicës prej partive politike që janë këtu. Ne menaxhojmë edhe me komuna dhe bartim përgjegjësi. Po ashtu një pjesë e mirë e deputetëve kanë udhëhequr ose kanë menaxhuar, ose janë pjesë aktive e arsimit në Kosovë, qoftë në nivelin lokal, qoftë në nivelin e mesëm, apo edhe universitar.

Pra, shkurtimisht, mendoj që kjo seancë që debatohet pse jo, po disa deputetë nuk po e kuptojnë mirë çka nënkupton debat e interpelancë. Çka nënkupton p.sh. ndryshim-plotësim ligji, e çka nënkupton debat. Pra, nëse sot ne si deputetë nxjerrim konkluzë, nxjerrim përfundime, nxjerrim rekomandime, jam i bindur që edhe ministri këtu që është, po edhe ata zotërinjtë që menaxhojnë me arsimin, janë të gatshëm të implementojnë. Sepse në radhë të parë edhe këta janë prindër, edhe këta i kanë fëmijët e vet.

Nuk do të thotë që arsimit është shqetësim vetëm i një subjekti politik, ose vetëm i një klase. Po pajtohemi me të gjithë që gjendja nuk është mirë. E di që pas luftës d.m.th. e deri sot shumica e tendencave ka qenë në përmirësimin e kushteve në infrastrukturë, po fatbardhësisht një pjesë e madhe e tyre janë përfunduar. Fatkeqësisht një pjesë e shkollave tona jemi duke i detyruar t'i mbyllim në mungesë të fëmijëve dhe ju këtë e dini që është një shqetësim jo vetëm në një komunë, ose një tjetër, po është shqetësim i krejt shoqërisë në Kosovë.

Pra, tashti ministër mendoj që edhe thirrësit e këtij debati parlamentar, do të vijnë në përfundim, do të japin rekomandime, dhe ne do të japim kontributin tonë, që ju ato rekomandime t'i implementoni direkt në përmirësimin e cilësisë së arsimit. E vërteta është që nuk jemi të kënaqur kurrë. E vërteta është që duhet të ndërhyhet dhe përkrahja nuk do të mungojë. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Tani fjalën e ka deputetja Xhevahire Izma.

**XHEVAHIRE IZMAKU:** Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

I nderuar ministër i Arsimit,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë që jeni duke e përcjellë seancën,

Meqenëse erdha në fund dhe nuk kam arritur t'i përcjellë të gjitha debatet, ose asnjë debat, sepse kemi qenë së bashku me disa kolegë dhe një ekip intervistuese me marrëveshjen që e kemi me Ambasadën Britanike.

Unë në grupin parlamentar jam konsultuar me kolegët e mi deputetë dhe për afërsisht e di temat të cilat i kanë ngritur. Do të mundohem që të mos i përsëris.

Njëkohësisht, i nderuar ministër, unë do të dukem pak subjektive që në start, po megjithatë këtë do ta bëja edhe si pyetje parlamentare. Nuk mund të mos kalojë drejtpërdrejt në temë. D.m.th. e kemi parë javëve të fundit, që është ngjallur një debat edhe kemi pasur një huti me rastin e shkarkimit të drejtorit për integritet, zoti Ferid Idrizi, që shumica nga ne të cilët kemi bashkëpunuar me të, e dimë konkretisht kontributin që ka dhënë në projekte të ndryshme ndërkombëtare të cilat i janë ofruar Ministrisë. Me gjithë respektin për ju, e kam vlerësuar që nga fillimi komunikimin që keni pasur për secilën pyetje parlamentare. Ai vlerësim nuk ka humbur te unë, po megjithatë, çështja që ju në bazë të thirrjes në reforma, keni filluar ju apo kabineti juaj të bëjë pastrime me ndikime politike, po mendoj që te unë dhe te shumë njerëz që kanë vlerësuar punën tënde, ka krijuar një zhgënjim.

Pra, qysh në fillim, thash duket subjektive, mirëpo unë mendoj që është një urgjencë që të rishikohet edhe një herë vendimi juaj për suspendim, sepse kjo jo vetëm që krijon zhgënjim në mbarë komunitetin që është marrë me çështje të arsimit dhe e njohin zotin Idrizi, mirëpo ka edhe shumë projekte ndërkombëtare që e kanë adresën te zoti Ferid Idrizi dhe të cilat do të mund të kenë huti, sepse dihet që Ferid Idrizi i takon një subjekti tjetër politik dhe mund të ketë këtë ngjyrim ndoshta, edhe ju nuk e keni pasur këtë qëllim, mirëpo unë shpresoj që këtë gabim që e keni bërë, ju apo kabineti juaj ta përmirësojë.

Tash, më lejoni të kaloj edhe unë në temën e përgjithshme. Ndoshta edhe sikur të ishte çdo gjë në rregull në nivelin e arsimit në vendin tonë, po besoj që ka pasur hapësirë të zhvillojmë debate për ngritjen e kualitetit. E mendoj, mandatin e kaluar kam qenë anëtare e Komisionit për Arsim dhe së bashku me disa kolegë deputetë, kemi qenë në një vizitë në Finlandë ku bashkë me kolegët deputetë finlandezë kemi përcjellë për së afërmi një debat parlamentar lidhur me iniciimin e një ligji për arsimin e lartë. Pra, aty kemi parë që aq shumë ka ngjallur debate të mëdha në shoqëri dhe ka vazhduar që të jetë si temë pra lidhur me dëgjimet publike, jo si i bëjmë ne, mirëpo deri në shtatë vjet, mirëpo kur është krijuar në ligj, është bërë një ligj shumë i fortë, i cili sot dihet që Finlanda e ka sistemin pra më të zhvilluar të kualitetit të arsimit në Evropë së paku jam e sigurt që është kjo.

Po besoj që nuk mund të të fajësojmë për të gjitha këto, se shumë probleme edhe i keni gjetur, pra së bashku kemi qenë që kemi kontribuar në këtë mbarëvajtje. Shpeshherë me këto rezultatet e fundit të PISA-s jemi ndier të turpëruar. Mirëpo, megjithatë ka jashtëzakonisht vërejte që kabineti juaj e ka ndihmuar degradimin në një masë shumë të madhe, posaçërisht në politizim. Unë nuk paragjykoj që për të gjitha mund të jeni të informuar. D.m.th. shpeshherë besoj që kabineti juaj ua ka ndërprerë komunikimin me shumë linja të institucioneve të cilat merren me kualitetin dhe zhvillimin e arsimit në vendin tonë.



Po ashtu nuk mund të thirremi se ne kemi një formë të decentralizimit të arsimit në komuna, dhe tash t'i ngremë duart lart edhe të mos merremi me çështje që ndodhin edhe problemet që kanë komunat në fushën e arsimit. Në këtë drejtim, më lejoni të ftoj, meqenëse merrem me çështjet lokale një kohë të gjatë, që të shikoni dhe të vizitoni vetë disa komuna, sepse mund edhe t'ju keqinfomojnë, apo keni njerëz të gabuar në ata resorë.

Pra, krejt qëllimi im është, i nderuar ministër, që pritjet të cilat edhe unë i kam pasur sinqerisht nga ju, edhe plot njerëz si unë, që t'i ushtroni kapacitetet nëse keni ende fuqi që të ndërmerrni, mirëpo reformat të kenë kuptimin e plotë, jo të kenë kuptimin e reformave që të dënohen, të penalizohen njerëz të cilët nuk i takojnë subjekteve të cilat u përkasim.

Pra, mungesa e bashkëpunimit me institucionet që kanë një lidhshmëri, humbja e memories administrative ka për të ndikuar jashtëzakonisht keq. Kushdoqoftë, cilido qoftë ministër të kishte qenë, unë jashtëzakonisht jam e interesuar që memoria administrative mos të shkëputet, se kjo e pengon zhvillimin në çdo sektor, e jashtëzakonisht keq ndikon në arsim, sepse arsimit është një pemë e cila nuk kultivohet shumë lehtë. Pra na duhen shumë vite investime që të shohim diçka pozitive.

Konsideroj që kabineti juaj fillimisht duhet të marrë përgjegjësi, vërejtje të cilat sot kanë dalë nga Kuvendi, vërejtje nga komisioni funksional, të kërkojë sa më parë që të identifikohen problemet. Pra, edhe një herë po them, unë konsideroj shpeshherë ka ndodhur mungesa e komunikimit. Ka nevojë të mos luftohet për poenë politike, të merret komplet kjo si një agjendë me interes nacional. Çështja e arsimit në vend. Të dimë pra që arsimit nuk është fushë, e cila mund sot të ngrihet. Kam edhe shumë tjera, por po e shoh që edhe jeni lodhur. Unë ju falënderoj për vëmendjen edhe shpresoj që më keni kuptuar drejt, i nderuar ministër. Kaq!

KRYESUESI: Faleminderit! Ministri e ka kërkuar fjalën. Do t'i ketë dy minuta.

MINISTRI SHYQIRI BYTYQI: E nderuar deputete, së pari dua t'ju informoj që ne askënd s'e kemi shkarkuar.

Në momentin kur kemi marrë një rekomandim, pas raportit që e ka nxjerrë Komisioni Evropian për gjendjen jo të mirë funksionale të ministrisë, është miratuar rregulloja dhe përskrimi i vendeve të reja të punës nga Qeveria e Kosovës, dhe njëkohësisht edhe organogrami i ri i Ministrisë së Arsimit.

Kjo ka bërë që nga tetë departamente që i kemi pasur të jenë katër departamente. Sigurisht, se në këto katër departamente nuk mund të vendosen tetë drejtorë të cilët kanë qenë.

Ndërkaq, për personin që ju e apostrofuat, unë nuk do të flas shumë për një zyrtar i cili e thyen etikën edhe i cili bën edhe shpifje, informacione të pavërteta nëpër media të ndryshme. Me këtë do të merren organet kompetente.

Lidhur me çështjen e ikjes së përgjegjësisë apo pretendimeve se kabineti ynë po i ikë përgjegjësisë. Kjo nuk është e vërtetë. Unë e konsideroj se punën më të madhe që ne e kemi bërë në këtë periudhë ka qenë një bashkëpunim shumë i afërt me të gjitha komunitat.

Nuk e besoj që ka pasur ministër, i cili për një periudhë kaq të shkurtër që ka vizituar aq shumë shkolla dhe aq komuna për të cilat kemi diskutuar për secilën pikë. Kemi parë në shumë shkolla që na thonë se një ministër për herë të parë ka ardhur në mënyrë zyrtare të na vizitojë.

Kjo memorie e sistemit, besoj që jemi ata të cilët po tentojmë ta ruajmë, por sikur të ishte gjithçka e mirë nuk do të kishim folur sot këtu për problemet që i ka sistemi arsimor. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kush dëshiron replikë? Enver Hoti, replikë dy minuta.

ENVER HOTI: Faleminderit, kryesues!

E dëgjova me vëmendje zonjën Izmaku, e cila duke e përshkruar një komunikim, një ndërprerje të komunikimit mes ministrit edhe linjave, po edhe komunave të tjera, dhe me të vërtetë është interesant që të zërthehet kjo.

Por, nga po vijnë ato burime që e paska ndërprere komunikimin me ministrin? Kush janë ato linja? Kush i dirigjon? Kush i kontrollon apo i rekomandon që ta bojkotojnë ministrin? Kjo është shumë interesante. Ndoshta po na shfaqet ajo skena kur e kemi parë me kryetarin e Kuvendin, në bashkëpunim me SBASHK-un apo me kryetarin e SBASHK-ut, kur ka qenë Ligji për Pagat. Është shumë interesant kjo.

Mirë që në fund dikush të tregojë të vërtetën dhe gjendjen reale sesi minohet procesi brendapërbrenda për moses. Me të vërtetë kjo është interesant që të trajtohet, dhe e falënderoj shumë se na e dha një pasqyrim real për vështirësitë të cilat i hasë ministri brenda administratës së politizuar apo partizuar siç e tha kolegu më herët, zoti Sherifi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Xhevahire Izmaku, kundër-replikë!

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit për mundësinë, nënkryetar!

I nderuar koleg, Enver Hoti, ju e dini që unë jam anëtare e Komisionit për Administratë Publike dhe ne kemi raportet të rregullta me Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovë.

Në raportet të cilat i kemi marrë, adresohet vërejtjet të cilat i drejtohen direkt Ministrisë së Arsimit për çështje të konkurseve për drejtorë. Pra, një ndër këto është ky komunikim zyrtar, mirëpo të gjitha informatat sigurisht se merren në formë zyrtare.

Nëse ka mundësi, të lutem i nderuar, nënkryetar! Në momentin kur po flas një grup arsimtarësh më drejtohen që ta bëj një pyetje dhe po e shfrytëzoj rastin meqë ministri është këtu.

Kjo pyetje ka të bëjë lidhur me nostrifikimin e çështjes së temave të diplomave, pra për personat të cilët e kanë përfunduar shkollën e Lartë Pedagogjike dhe ministria i ka adresuar edhe për vazhdimin të mëtutjeshëm dhe pastaj ata nuk marrë nostrifikimin. Pra, aludojnë që është në mënyrë të selektuar kjo çështje. Kjo ishte pyetja, e cila më adresohet prej disa arsimtarëve. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Zoti ministër, nëse dëshironi të përgjigjeni i keni dy minuta.

**MINISTRI SHYQIRI BYTYQI:** Ky është po ashtu një problem i cili është trashëguar dhe nuk ka pasur zgjidhje deri më tani.

Ai komisioni për të cilin folëm më herët, që është duke u marrë me çështjet e kaluara do të dalë me rekomandim dhe do të jetë zgjidhje edhe për këta. Nuk ka selektim, po ka problem të pazgjidhur nga e kaluara.

**KRYESUESI:** Faleminderit! Të nderuar kolegë, nuk ka deputetë të tjerë të paraqitur për fjalë. Jemi në fund të këtij debati, kështu që unë ftoj për fjalën përfundimtare iniciuesin e kësaj çështjeje, deputetin Ismajl Kurteshi.

**ISMAJL KURTESHI:** Të nderuar deputetë,  
Së pari dëshiroj që t'ju falënderoj të gjithë juve që kontribuat shumë pasqyrimin e gjendje në arsim dhe ky ka qenë edhe qëllimi i thirrjes së kësaj seance. Seanca nuk është thirrur as për hatër të dikujt dhe as për inati të dikujt.

Unë mendoj që me këtë debat e që duhet të jetë vetëm një nismë e shumë debateve të tjera në fushën e arsimit, sepse një pikë e kemi pasur të përbashkët; asnjëri nga deputetët nuk ka konstatuar se gjenden në arsim e kemi të mirë.

Meqë gjendja në arsim nuk është e mirë, nevojitet që të debatohet dhe të gjendet një formë që këtë gjendje ta ndryshojmë për të mirë.

Jam i obliguar që ta shpjegoj se pse e kemi thirrë së bashku me Grupin Parlamentar të LDK-së, seancë të jashtëzakonshme dhe jo të rregullt. Ju lutem, së pari...Prisni Teutë, e pastaj merre fjalën nëse të vjen rendi. Pritni pak!

Së pari, në rezolutën që e ka aprovuar ky Kuvend para dy vitesh, ministri është i obliguar që të raportojë për gjendjen në arsim për çdo tre muaj. Për dy vite do duhej që së paku tetë raporte t'i kemi, mirëpo s'e kemi asnjë raport. Dhe, as nga ministri aktual e as nga ai që ka qenë para këtij. E dyta, më 12 shkurt, kemi kërkuar që si pikë e rendit të ditës në një seancë të rregullt të futet edhe çështja e debatit për arsim. Kjo kërkesë është bërë më 12 shkurt. Këtu e kemi Sekretarin, e ka marrë ftesën, kërkesën dhe asnjëherë nuk është realizuar.

Më 17 prill, pas dy muajsh, kemi kërkuar interpelancë, pra ta ftojme ministrin e Arsimit në interpelancë. Sigurisht, se nga 17 prilli e deri më sot kanë kaluar 10 javë dhe një gjë e tillë nuk është thirrur.

Meqë kryesia e Kuvendit e ka pamundësuar debatin në seanca të rregullta, kemi qenë të obliguar që ta ftojme një seancë të jashtëzakonshme, pasi që jemi në fundin e sesionit pranveror.

Dëshiroj të konstatoj në fund, se gjendja në arsim nuk është rezultat vetëm i Qeverisë aktuale, po është rezultat i të gjitha qeverive që nga paslufta.

Dy, Qeveria aktuale nuk dallon nga qeveritë tjera, as nuk ka punuar më mirë dhe as nuk ka punuar më keq. Gjendja vetëm sa po shkon duke u keqësuar, kështu që nuk ka asnjë arsye...Po e keni thënë edhe ju, po pajtohem me juve.

Unë mendoj që me këtë debat ne nuk e kemi zgjidhur problemin në arsim, por ne duhet të dalim me një propozim që ta fillojmë një debat të gjerë shoqëror me të cilin do të gjejmë zgjidhje për të dalë nga kjo situatë e vështirë në arsim.

Në fund, duke e pasur parasysh se arsimi nuk është problem i dy grupeve parlamentare së e kanë thirrur seancën, pra i Vetëvendosjes dhe LDK-së, propozoj që secili grup parlamentar ta propozojë nga një deputet. Të bëhemi të gjithë bashkë dhe pastaj bashkërisht t'i propozojmë pikat e një rezolute e cila do të votohet në Kuvendin e Republikës së Kosovës nëpërmjet së cilës do të veprohet në përmirësimin e gjendjes në arsim.

Dhe fare në fund, përveç që do ta votojmë rezolutën, në seancën e ardhshme do ta votojmë edhe propozimin e Grupit Parlamentar të LDK-së, në lidhje me komisionin hetimor të cilin edhe ne si grup parlamentar e përkrahim.

Tani i kam dy-tri kërkesa për ministrin. Së pari të mos bëhet votimi i teksteve aktuale deri në shqyrtim të ri. Kërkoj që ministri menjëherë të na dërgojë raportin ose siç e quajti ai informatën e zonjës Gagica, sepse ky është obligim ligjor.

Për shkak të parregullsive në fushën e arsimit dhe për shkak të skandaleve në MASHT, kërkoj dorëheqjen e ministrit aktual, me shpresën se situata do të ndryshonte edhe me këtë ndryshim. Po ashtu, kërkoj nga deputetët që ta respektojnë njëri-tjetrin dhe të mos ndërhyjnë ashtu siç po ndërhyjnë Teuta. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Të nderuar kolegë, kjo ishte fjala përfundimtare, por pati një propozim që grupet parlamentare ta caktojnë nga një deputet në një grup pune, i cili do të përpiqet që ta harmonizojë në tekst të rezolutës.

Kështu që, unë do t'ju drejtohem grupeve parlamentare veç e veç. Grupi Parlamentar i LDK-së, Armen Zemaj. Armend, emrin e përfaqësuesit të grupit parlamentar.

ARMEND ZEMAJ: Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, ne e propozojmë zonjën, Valentina Bunjaku për t'i harmonizuar rekomandimet e dala nga seanca plenare. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i PDK-së. Kush e do fjalën? Deputeti Hajdar Beqa.

HAJDAR BEQA: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, propozojmë Luljeta Veselaj-Gutaj, anëtare në komision dhe deputete.

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje, Albulena Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Lëvizje Vetëvendosje e propozon kryetarin e Komisionit për Arsim dhe deputetin tonë, Ismajl Kurteshi.

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i AAK-së. Kush e do fjalën? Teuta Haxhiu e keni fjalën. Regjia, Teuta Haxhiu.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit!

Fillimisht po e propozoj vetveten në këtë komision. Mirëpo, nuk ka ndodhur kurrë në një seancë as të zakonshme dhe as të jashtëzakonshme të mos ketë rezolutë.

Pra, krejt kanë dështuar këto dy grupe, pa na e sjellë një tekst, e ne pastaj do të mund të kontribuonin që ta pasurojmë rezolutën. Jo të maltretohemi dhe të themi se debatet nuk po i vendos kryesia.

Po këta, s'po vijnë kurrë që t'i kryejmë seancat e zakonshme, atëherë normal se nuk po vinë në rend të ditës. A është kështu nënkryetar apo jo, si pjesë e Kryesisë?

KRYESUESI: Faleminderit!

TEUTA HAXHIU: Pra, sinqerisht duhet të kemi tekst të rezolutës e pastaj të mblidhen grupet, dhe të pasurohen e të ndryshohen ato rezoluta, ato pika. Kjo është praktikë e Kuvendit të zakonshëm.

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i PSD-së, deputeti Visar Ymeri.

VISAR YMERY: Ne emër të Partisë Socialdemokrate do të jetë deputeti, Driton Çausi.

KRYESUESI: Faleminderit, Visar! Nga Lista serbe s'është askush. Nga Grupi Parlamentar Nisma Socialdemokrate, Bilall Sherifi.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, kryesues! Në emër të Nismës do të jetë deputetja Albulena Balaj-Halimaj.

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar 6+, s'ka përfaqësues.

Atëherë, këta janë emrat. Kjo seancë ndërpritet këtu dhe do të vazhdojë pasi të jetë gati teksti i harmonizuar. Për datën do të njoftoheni nga Administrata. Faleminderit!

*E përgatiti:  
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*